



**ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΟ ΤΙΡΑΝΩΝ
ΣΧΟΛΗ ΙΣΤΟΡΙΑΣ – ΦΙΛΟΛΟΓΙΑΣ
ΤΜΗΜΑ ΞΕΝΩΝ ΓΛΩΣΣΩΝ**

ΜΕΤΑΠΤΥΧΙΑΚΗ ΕΡΓΑΣΙΑ

**«Ο ΝΙΚΟΣ ΚΑΤΣΑΛΙΔΑΣ ΚΑΙ ΤΟ
ΛΟΓΟΤΕΧΝΙΚΟ ΤΟΥ ΕΡΓΟ»**

ΜΙΡΕΛΛΑ ΚΑΡΑΝΤΖΑ

**Επιβλέπων Καθηγητής
Καθηγητής ΙΜΕΡ ΤΣΙΡΑΚΟΥ**

ΤΙΡΑΝΑ, Σεπτέμβριος 2008

1. Hyrje
2. Shënim biografik.
3. Nëndarja e veprës letrare të Niko Kacalidhës.
 - 3.1 Veprat poetike në gjuhën shqipe.
 - 3.2 Periudha 1971-1990. Vëllimet poetike, tematika, ndikime. Karakteristika të përgjithshme.
 - 3.3 Periudha 1990-2008. Vëllimet poetike, tematika, ndikime. Karakteristika të përgjithshme.
 - 3.4 Veprat poetike në gjuhën greke.
 - 3.5 Periudha 1971-1990. Vëllimet poetike, tematika, ndikime. Karakteristika të përgjithshme.
 - 3.6 Periudha 1990-2008. Vëllimet poetike, tematika, ndikime. Karakteristika të përgjithshme.
 - 3.7 Proza në gjuhën greke. Tematika, ndikime. Karakteristika të përgjithshme.
4. Përkthymet në gjuhën shqipe dhe në atë greke.
5. Karakteristika të përgjithshme të poezisë së Niko Kacalidhës. Ndikime. Vendi i tij në letërsinë shqiptare dhe në atë greke.
 - 5.1 Karakteristika të përgjithshme.
 - 5.2 Ndikime.
 - 5.3 Tematika e Niko Kacalidhës.
 - 5.3.1 Tema e vendlindjes në poezinë e tij.
 - 5.3.2 Tema e natyrës.
 - 5.3.3 Muaji Prill në poezinë e Kacalidhës.
 - 5.4 Tema e detit.
 - 5.5 Tema e dashurisë.
 - 5.6 Tema e mërgimit.
 - 5.7 Tema e vdekjes.
 - 5.8 Tema e patriotizmit.
 - 5.9 N. Kacalidhas poet i miqësisë së popujve.
 - 5.10 Veçori të gjuhës.
 - 5.11 Stili i N. Kacalidhës. Mjetet shprehëse – teknika.
6. Kritika mbi veprën e N. Kacalidhës.
 - 6.1 Të tjerët për N. Kacalidhën.
7. Konkluzione.
8. Literatura.

1. HYRJE

Vepra poliedrike e Niko Kacalidhës, vlerësimi si duhet i rëndësishëm së saj, ka bërë të nevojshme ndërmarjen e studimeve mbi të.

Tema ka titullin: “Nikos Kacalidha dhe vepra e tij letrare”. Në këtë studim do të tentohet të interpretohet vepra e një krijuesi të spikatur, sidomos në fushën e poezisë. Do të rreket të zbulohen kontributet origjinale dhe specifike këtij krijuesi dygjuhësh (biling) që dëshmon veçori të gjuhëve e kulturave përkatëse.

Për studimin sa më të mirë të saj, tema është ndarë në disa kapituj të cilët marrin përsipër të paraqesin veprën e tij poetike në shqip dhe në greqisht, prozën e tij në greqisht si dhe përkthimet në shqip dhe në greqisht. Akoma jepen disa sugjerime mbi karakteristikat e veprave, ndikimet, stilin, vendin e N.Kacalidhës në letërsinë shqipe dhe në atë greke, si dhe disa mendime kritike mbi krijimtarinë e autorit.

Kapitulli i parafundit synon dhënien e disa konkluzioneve përfundimtare me qëllim që të arrihen objektivat dhe synimet e temës.

Për kryerjen e studimit janë shfrytëzuar vëllimet poetike, proza, përkthimet e autorit, esset e tij letrare, tekste e studime të ndryshme në fushën e letërsisë greke dhe shqiptare, botime në shtypin shqiptar, grek dhe në atë të Minoritetit Etnik Grek, diskutimet me autorin si dhe informacione të marra nga interneti.

Për këtë studim një kontribut mjaft të vlefshëm ka dhënë udhëheqësi shkencor i këtij punimi Prof. Dr. Ymer Çiraku i cili përmes dialogut krijues nuk pushoi të më inkurajojë dhe të më hapë horizonte të reja.

Një ndihmesë të madhe ka dhënë vetë autori, Niko Kacalidha me materialet e shumta që më disponoi, me bisedat mbi krijimtarinë e tij dhe me shqipërimin nga greqishtja të poezive që morrëm për shqyrtim. Inkurajuese ishin dhe konsultat e zhvilluara gjerësisht me kolegët e mi, pedagogët e Departamentit të Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek, të Universitetit të Gjirokastrës, si dhe bisedat me studjues të veprës së tij.

Të gjithë i falënderoj dhe u shpreh mirënjohjen time.

Autori

2. SHENIM BIOGRAFIK

Niko Kacalidha lindi në fshatin malor dhe piktoresk, Leshnicë e Sipërme të zonës së Theollogos të Sarandës më 25 Korrik 1949, në një familje me tradita. Është i biri i Grigor Kacalidhës, specialistit në folkloristikë, punëtorit të palodhur intelektual, mësuesit të gjuhës greke me kuptimin e plotë të fjalës, mendimtarit dhe kërkuesit të traditës popullore.

Babai i tij ka botuar artikuj me përmbajtje kryesisht folklorike si dhe një përmbledhje me këngë popullore të Minoritetit Etnik Grek.

Ambjenti familjar, ku u rrit dhe u zhvillua ndikoi shumë në veprën e tij. Gjyshi i tij Nikolla ishte i mërguar në Amerikë dhe poeti në rrëfimin e tij e quan gjysh – Odisse, kurse gjyshen – Ollga e quan Penelopë. Vetë poeti thotë : «Gjyshja ime, dijetarja, që dinte me qindra vargje përmendësh, më mesoi qysh femijë të degjoj 15-rrokëshin e saj dhe më detyronte të recitoja: «Moj Dropullite», «Ura e Artës», «Nënë moj, me të nentë bijtë».¹

Pasi mbaroi shkollën 7-vjeçare në vendlindjen e tij, vazhdoi Shkollën e Mesme të Përgjithshme në Berat. Atje u dallua për provat e para dhe përpjekjet e tij poetike dhe u caktua përgjegjës i rrethit letrar të shkollës. Ishte nxënës në gjimnaz kur shkrimtari i madh Ismail Kadare lexoi veprat e tij rinore. Mbaroi Shkollën e Mesme në Berat, por për shkak të “biografisë” nomenklatura e Sarandës nuk i dha të drejtën e studimeve të larta. Me ndërhyrjen e vetë I. Kadaresë, N. Kacalidha më 1967 u regjistrua në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Tiranës, jo si student i ardhur nga Saranda por nga qyteti i Beratit.

Mbaroi studimet e larta më 1971. Në vitin 1972 u emërua mësues i letërsisë në Shkollën e Mesme të Cerovicës në zonën e Theollogos të Sarandës, në fshatrat e vendlindjes së tij. Vazhdoi atje për një periudhë kohore dhjetëvjeçare (1972-1982), vite që ndikuan pozitivisht në veprën e tij.

“Dhjetë vjet u izolova – siç tregon vetë- në Krakurat e Theollogos”²

¹Revista, «Ταχυδρόμος», 04.02.2004, faqe 15

²Revista, «Ταχυδρόμος», 04.02.2004, faqe 15

Personalitetet e shquara letrare, I. Kadareja dhe D. Agolli e vizitonin shpesh atje lart dhe me interesin e tyre u transferua në Shkollën e Mesme të qytetit të Sarandës.

Kështu nga viti 1982 deri më 2001 e gjejmë profesor të letërsisë në Sarandë.

Që nga viti 1992 është përgjegjës letrar në gazetën për Minoritetin Etnik Grek “Λαϊκό Βήμα”, ku kontributi i tij është i madh.

Filloi angazhimin e tij poetik shumë herët, që kur ishte nxënës dhe vazhdoi si student me cikle poezish dhe me shumë botime në gazetatat e kohës: “Drita”, “Zëri i Rinisë”, “Nëntori” dhe “Studenti”.

Vëllimin e tij të parë poetik në gjuhën greke me titull (Θροίσματα και φυλλωσιές) “Fëshfërima dhe gjethnajë” poeti e shkruajti herët, më 1966, por ngeli i pabotuar në sirtaret e shtypshkronjës “Naim Frashëri” dhe tani gjendet dorëshkrim në arkivin e poetit.

Vëllimi i tij i parë poetik i botuar në gjuhën shqipe, “Fjalë të thëna në pranverë”, qarkulloi në vitin 1971 kur poeti ishte akoma student dhe u nderua me çmimin kombëtar.

Çmim kombëtar fitoi dhe më 1982 me vëllimin poetik “Shtëpitë tona në Jug” po në gjuhën shqipe. N.Kacalidha përdor gjuhën greke dhe atë shqipe me të njëjtën lehtësi dhe shkruan poezi cilësore në të dy gjuhët.

Pas viteve 1990 N.Kacalidha bëhet i njohur dhe në Greqi. Shumë personalitete të njohura greke e mirëpresin dhe e nderojnë: nobelisti i njohur Odiseas Elitis, Melina Merkuri, Taqis Varviciotis, poetët qipriot Kostas Montis dhe Qipros Krisanthis etj. Një ceremoni nderimi për poetin u bë në Selanik më 1994 me rastin e botimit të veprës “Vaji i malit të vrenjtur”. Po më 1994 në konkursin Panhelenik me tema të marra nga Epiri, vepra e tij “Asketi” fitoi çmimin e parë.

Në vitin 1995 Ministria e Kulturës së Qipros botoi veprën “Lemonj të hidhur”.

Në Sarandë dhe në Gjirokastër u nderua me madhësi nga intelektualët.

Më 2000 në Frankurt të Gjermanisë në Panairin Ndërkombëtar të Librit u nderua nga Shoqata e Shkrimtarëve të Greqisë.

Në vitin 2001 me veprën “Njëqind trëndafila” fitoi çmimin e parë ballkanik “Emos”.

Më 2001 Ministria e Kulturës së Shqipërisë e nderon me çmimin “Pena e argjendtë” për përkrahimin më të mirë të vitit, për veprën e nobelistit të madh grek O. Elitis “Aksion esti”.

Për kontributin e tij u nderua nga Presidenti i Republikës dhe Parlamenti shqiptar.

Është një nga themeluesit e organizatës politike të Minoritetit Etnik Grek “Omonia”.

Padiskutim është një zë autentik i poezisë moderne.

Kohët e fundit dha prova dhe në fushën e prozës me një roman dhe disa tregime e novela.

Shumë poezi të tij janë përfshirë në shumë antologji të botës dhe vetë është përkthyer në anglisht, frëngjisht, gjermanisht dhe italisht.

Gjatë viteve 2001-2002 ka qënë minister shteti pranë kryeministrit për të drejtat e njeriut.

Është i martuar me zonjën Dhespina Kacalidha nga fshati Shën Andrea dhe ka dy djem, Grigorin dhe Arin.

Gjatë periudhës kohore 2005-2008 është atashe kulturor me gradën këshilltar në Ambasadën Shqiptare në Athinë.

3. NENDARJA E VEPRES LETRARE TE NIKO KACALIDHES

Vepra e shumëanshme e N. Kacalidhës mund të ndahet në dy kategori, duke patur parasysh kriterin e formës gjuhësore:

1. **Vepra në gjuhën shqipe**, ku përfshihen të gjitha librat e tij në gjuhën shqipe, si dhe përkthimet në shqip të veprave të poetëve grekë dhe qipriotë.
2. **Vepra në gjuhën greke**, ku përfshihen vëllimet poetike, proza, artikuj, esse, studimet në gjuhën amtare si dhe përkthimet e tij nga shqipja në greqisht.

Për studimin sa më të mire të veprës së tij si në shqip dhe në greqisht, e ndajmë në dy periudha:

- a. **Periudha e pare 1971 – 1990**
- b. **Periudha e dytë 1990 – vazhdim**

3.1 VEPRA E NIKO KACALIDHËS NË GJUHËN SHQIPE

3.1.1 PERIUDHA 1971 – 1990. VËLLIMET POETIKE. TEMATIKA, NDIKIME, KARAKTERISTIKA.

3.1.2

Vëllimet poetike në gjuhën shqipe të kësaj periudhe kohore janë si më poshtë:

1. “Fjalë të thëna në pranverë”. 1971
2. “Flugeri” 1975
3. “Shtëpitë tona në Jug” 1982
4. “Anëdet” 1988

Vëllimi i tij i parë poetik u nderua me çmim kombëtar dhe shkaktoi komente të favorshme të specialistëve, si p.sh të Moikom Zeqos, për rrezatimin e hershëm poetik të poetit të ri. «Mbah mend botimin e cikleve të para poetike të Nikos. Qe i befasishëm dhe tejet i ngrohtë, i sinqertë, ndonëse pak i ndrojtur. Kjo ndrojtje e Nikos që e ka ndjekur atë edhe në krijimtarinë e mëpastajme ka qënë një nga misteret e brishta dhe jetëdhënëse të natyrës së tij lirike. Unë shkrova shkrimin e pare estetik për librin e pare poetik të Niko Kacalidhës, të quajtur “Fjalë të thëna në pranverë”». ³

Kurse F.Gërmeni do të theksojë: “N. Kacalidha, studenti me sy të shndritshme, që u fut në rrugën e artit me veprën “Fjalë të thëna në pranverë”, paralajmëronte ardhjen e një poezie të pjekur me vlera të dukshme artistike. Ishte një lirizëm i brezit të viteve ’70 që fshihte dëshirën të largonte nga kornizat dhe klisjet e regjimit duke shprehur kështu personalitetin e tij poetik. Mbeti ky prezantim i parë si gur themeli në poezinë e Kacalidhës”.

Niko Kacalidha i takon periudhës së tretë të pasluftës, brezit të viteve ’70. Veçoritë e përgjithshme të poezisë shqipe të këtij brezi i takojmë dhe te poezia e Kacalidhës. Veçoritë kryesore të këtij brezi janë përpjekjet ripërtëritëse të poetikës estetike dhe në mënyrë të veçantë të formës përta i përket vargut dhe veçanërisht një hapje tek vargu i lire, është një novatorizëm metaforik që ka të bëjë me botën e brëndshme dhe ndjeshmërinë e poetit, me figurat, me konceptin poetik për vetë botën.

³Moikom Zeqo, “Lirika e Niko Kacalidhës”, faqe 1 (nga arkivi I N.Kacalidhës)

⁴Gazeta “2000”, Prill 2000

Poetët e brezit të viteve ’70 sjellin një ripërtëritje autentike, duke dalë nga klisjet dhe kallëpet të brezit të pare dhe të dytë, në tematikën dhe në idetë, duke

mbajtur distancë nga paraqitja e realitetit të thatë të realizmit socialist dhe përpiqen të rikrijojnë një estetikë të re, të qëndrojnë larg nga retorizmi dhe tematika konkrete në poezi, duke shprehur kështu më shumë ndjenjat e tyre, botën e tyre të brendshme, estetikën drejt së bukurës, duke shprehur më shumë ndjenjat e tyre erotike dhe duke shfrytëzuar motivet e lashta, mitet, legjendat, natyrën, vendlindjen etj.

Poeti jeton në një periudhë të turbullt, ku ndjenja e mbytjes dhe e mërzitjes intelektuale rëndonte shpirtrat, sepse nuk ekzistonte shprehja e lirë dhe fjala poetike ishte e zbehtë. Flasim për një periudhë të errët dhe militariste ku poeti i izoluar mendohej të mbante brënda tij forca për sot dhe për nesër.

N.Ifandis shkruan: “Poezinë e asaj periudhe do ta karakterizojmë si një “poezi të heshtjes”, larg zërave kumbues, me tone të ulëta, ku lagështia gërryente ndjeshmërinë e tyre”.⁵

Disavantazhet, mangësitë që takojmë në poezinë shqipe të periudhës së tretë përsa i përket pompozitetit dhe prozaizmit, shfaqen dhe në poezinë e Kacalidhës. Kemi të bëjmë me një poezi politike të varur nga realizmi socialist. Një poezi hymnizuese ku shprehja është e qartë dhe e lehtëkuptueshme. Paraqitet një realitet tjetër nga ai që ishte në të vërtetë, një realitet absolut. Veprat flasin për varfërinë dhe mjerimin e kohës së kaluar që i bënte njerëzit të merrnin rrugën e mërgimit. Flasin për “jetën e bukur që solli Partia” dhe për atë “më të mirën që do të vijë me komunizmin”. U bëjnë jehonë përpjekjeve për emancipimin e gruas dhe pjesëmarrjes së saj në ndërtimin e socializmit. Tema të tjera që takojmë kanë të bëjnë me rezistencën e Shqipërisë socialiste kundër revizionizmit dhe imperializmit, luftën e klasave, vigjilencën e atdheut etj. Në vëllimet e fundit poetike të kësaj periudhe vërrejme Kacalidhën t’u shmanget këtyre motiveve dhe të bëjë një kthesë drejt poezisë erotike dhe poezisë së adhurimit të natyrës. Akoma krijon një poezi që bazohet tek motivet e vendlindjes, gjë që bëhet dhe në vazhdim lajtmotiv i gjithë poezisë së tij.

Shfaqet një ndjenjë e lehtë dhe e pastër erotike, e formuluar në vargje të bukura:

“Eja, e dashur, ç’ke një ngjyrë sonte
që i bëre të skuqen dhe yjet.?”

⁵Revista, «Περαιωτικά γράμματα», Shkurt 2006, faqe 594

Apo pse shaminë me flutura

Unë ta hoqa nga koka dhe era e lëkund

Të varur poshtë ullinjve?”⁶

Shumë vjersha, në të gjitha vëllimet poetike, flasin për miqësinë midis grekëve minoritarë dhe shqiptarëve, për luftërat e tyre të përbashkëta kundër armiqve dhe rrugën e tyre vëllazërore në ndërtimin e socializmit:

“Në kalldrëm ra bimbashi dhe nënat dropullite
në fushë i gjeti lajmi, të kërrusura pranë misrit.
Ç` mund t`i jepnin çetës atë mëngjes që agullinte?
Një kulaç hënor mund t`i piqte secila Çerçizit.

Burrat dropullitë çonin lajme nga shpella në shpellë
të ruanin Çerçizin që u vinte nga Gjirokastra.
Barrinjtë bënin gati një pike qumësht, një çikë dhallë.
Ndahej gllënka e ujit për vëllanë dhe zemra e pastër.”⁷

Tek natyra dhe tek vendlindja gjen poeti qetësinë shpirtërore, merr forca që të vazhdojë betejën e jetës. Sipër maleve kreshnike të vëndit të tij, të mbytura në diell dhe në bukuri gjen poeti frymëzimin e vërtetë. Të gjitha vëllimet e tij poetike, nga e para deri tek e fundit, janë të mbushura me nostalgji për vendlindjen e tij. Këto vjersha lirike , kushtuar Leshnicës janë provat më të rëndësishme të të gjitha vlerave poetike të asaj kohe:

“Këtu linda. Mes kopshteve ma lidhën kërthizën
dhe u vura shpatullat e mia druve,
dhe kërceva si ketër nga pema në pemë. Dhe jam
si në yje.
Po rrënjët i kam në tokë. Eshtë toka që të nxjerr
në qiell.”⁸

⁶N.Kacalidha, “Prill”, Anëdet, Tiranë 1989, faqe 34

⁷N.Kacalidha, “Mitera“, Anëdet, Tiranë 1989, faqe 52

⁸N.Kacalidha, “Kopshtet e Leshnicës, Anëdet, Tiranë 1989, faqe 14

Ketë vjershë bashkë me shumë të tjera si p.sh “Vendlindja në manjetofon”, “Kthimi në shtëpi”, “Tryeza e shtëpisë” dhe disa të tjera poeti i ripunon në gjuhën greke dhe i përfshin në vëllimet poetike të periudhës së dytë nga viti 1990 e në

vazhdim. Me tone adhuruese poeti do të përshkruajë natyrën magjepsëse. Si piktor na jep figurën e detit që shumë dashuroi dhe shumë himnizoi:

“Po ç` tju them? Deti tej e tej, madhështor,
me shkumë e me dritë.
Andej dhe ti sikur më dole dhe mbive, e dashur,
në këtë sezon vere,
dhe thashë: unë pashë se si linde nga shkuma e
e valëve e tëra si një Afërditë.”⁹

Në veprat e fundit fillon të përdorë më shumë mjete mitologjike. Kështu në vëllimin poetik “Anëdet” takojmë Afërditën, Odissenë, Posidonin etj., gjë që nuk e shohim në veprat e mëparshme. Por shfrytëzimi i mjeteve mitologjike është një nga karakteristikat kryesore të poezisë së tij.

Do të thotë S.Mato: “Që nga kontaktet e para me poezinë e tij, që nga vjershat e para vërejtja diçka interesante, që sot mund ta përmbledh me dy fjalë: “poezi jashtë realitetit””¹⁰.

⁹N.Kacalidha, “Prill”, Anëdet, Tiranë 1989, faqe 34

¹⁰ Gazeta «Ρωμοσύνη», 20. 07. 1999

3.1.3 PERIUDHA 1990 – 2008. VËLLIMET POETIKE. TEMATIKA, NDIKIME, KARAKTERISTIKA.

Vëllimet poetike në gjuhën shqipe të kësaj periudhe kohore janë si më poshtë:

1. Profecite e drureve, Dritero, 1996

2. Elikhiri i gurit, Toena, 2004

3. Pagezimi i zogjve, Onufri 2006

Pas vitit 1990 tematika e poezisë shqiptare dhe e asaj të Minoritetit Etnik Grek pasurohen, zgjerohen dhe marrin një karakter të ri si në brendi dhe në formë. Një botë të re shpirtërore përbëjnë tani burimet e frymëzimit dhe të tematikës. Poeti tani zhvillon më shumë anën e brëndshme shpirtërore të temës dhe shfaq një poezi të dimensioneve të tjera. Një mentalitet i ri i pasuruar me figura dhe simbole nga e kaluara historike dhe përvojat tiranike të epokës së diktaturës, përbëjnë një nga karakteristikat bazë njohëse të poezisë shqipe të brezit të viteve '90. Kështu, shumë nga poetët dhe prozatorët arritën një vazhdim ripërtëritës të fjalës së tyre, dhanë në fjalorin e tyre një kuptim semasiologjik të gjerë. U çliruan nga ideologjia, pikturuan me ngjyrat më të errëta barbarizmin dhe mjetet çnjerëzore të sistemit monist. Poetët i drejtohen kujtesës që të gjallërojnë tablotë e kaluara.

Dhe N.Kacalidha e ndjeu diktaturën si qytetar dhe intelektual i ndërgjegjshëm. Atmosfera e atyre viteve jepet me vargje të ashpra. Tani mund të themi se shfaqen mjetet bazë të fjalës së tij poetike. Adopton mjete të reja shprehëse. Ndryshimet e sistemit sjellin në poezinë e tij rivlerësimin e saj, treguan vlerat e saj të vërteta artistikë dhe estetike. Thotë S.Mato: “Erdhi koha që ata që ishin “jashtë realitetit” të zënë vëndin e nderit në poezinë e re që po lindte”¹¹

Veprat e tij të para janë shfaqje të dhimbjes së madhe. Zhvillimet e viteve të fundit, kontaktet me atdheun – mëmë, me letërsinë greke larg frikës që e torturonte për dekada të tëra do të tregojnë vlerat e vërteta të letërsisë, aspektin tjetër, që krijuesit e fshihnin. Poeti i vendosur në traditën ripërtëritëse poetike, e pasuron dhe e zgjeron. Largohet nga çdo lloj kategorizimi.

Ndërsa N.Ifantis nënvizon:«Poezia e tij, bashkë me befasinë që sjell rendi i ri i gjërave, u kthehet aspekteve intime, jo vetëm për të medituar, por kryesisht që të regjistrojë përshtypjen virgjërore, vështrimin virgjëror të botës».¹²

¹¹ Gazeta «Ρωμοσύνη», 20. 07. 1999

¹² Revista «Ηπειρωτικά Γράμματα», Shkurt 2006,faqe 597

1. PROFECITË E DRURËVE

U botua në serinë e poezisë shqipe “Lotët e qiririt”, nga shtëpia botuese “Dritëro” në Tiranë në vitin 1996. Prologun me titull “Metafora e drurit poetik” e bën shkrimtari i njohur shqiptar Dritëro Agolli.

Ky vëllim poetik është një paraqitje e plotë, e pasur dhe shumëngjyrëshe e poezisë së N.Kacalidhës, i cili ka bërë hapa të mëdha si në formë ashtu dhe në strukturën poetike. Që me vargjet e para që i pamë në kapitullin e mëparshëm, disa nga temat e tij u bënë si duket pak nga pak motivet mbi të cilat bazohet gjithë poetika e tij. Pranvera, Prilli shpërthyes me eksitim e natyrës, dashuria, malli për vendlindjen, këto siç duket janë vazhdimi fiziologjik dhe tek vëllimi poetik “Profecitë e drureve”.

Vepra përbëhet nga tre pjesë: pjesa e parë ka titullin “Ungjillëzimi i zogjve” dhe përbëhet nga 76 vjersha. E dyta ka titullin “Ky yll i mbrëmjes” dhe ka 67 vjersha. Pjesa e tretë dhe e fundit titullohet “Credo” dhe përbëhet vetëm nga 7 vjersha. Peisazhet, natyra janë të “pikturuara” në mënyrë piktoreske dhe janë të mbushura me dritë dhe me aromë lulesh:

«Jashtë në shkallët e mëngjesit,
kishin dale të më prisnin të çelura
bajamet.

Brenda, kishte çelur jasemini i ëndrrës
dhe unë vërshelleja nga malli
dhe ëndërroja se të nesërmen për mua
do të çelnin në brigje portokallet.»

(“Me doemos sivjet do të dilnim nga dimri”, faqe 19)

Poezia e tij, në shumicën e rasteve është adhuruese e natyrës. Hymnizon natyrën në të gjitha orët dhe në të gjitha stinët por më shumë hymnizon tonet e gëzuara pranverore. Gjejmë vjersha të plota që i janë kushtuar plotësisht natyrës. Shumica e poezive u janë kushtuar drureve. Dhe vetëm nga titulli i vëllimit dhe nga titujt e shumë vjershave mund ta konstatojmë këtë: “Druri i paqes”, “Ngarkuar me klorofilin e drurëve”, “Druri gjenealogjik”, “Druri i hënës”, “Druri i Dodonës”, “Aritmetika e drurëve”, “S’është fitomani kur flas me drurët”, “Druri i dashurisë”, “Drurët profetikë” etj. Pemët flasin, bëhen orakuj profecish si dushku në Dodonën e lashtë:

“Të kthehej andej nga erdhi, i thane falltarët
tempullit me pëshpërime gjethesh
të kthehet andej nga ershi, i thuaj,- i thanë
për mua veriut”

(“Druri i Dodonës”, faqe 143)

Pemët tek poezia e Kacalidhës s'kanë kohë të merren me gjëra të parëndësishme dhe me vogëlsira. Ato bashkëbisedojnë me poetin dhe kanë "profecitë" e tyre. Poeti si askush tjetër ka mundësinë t'i lexojë dhe t'i analizojë, të dëgjojë gjuhën e tyre uiniversale dhe përmes kësaj gjuhe të jetë në gjëndje të interpretojë mesazhin e madh të njerëzimit:

"Ngjitem mbi vijën e ujit dhe pushtoj një plep.
Plepi dridhet, rrenqethet fund e majë
dhe ja nis drithërimën tërë pyllit të plepave,
qe fëshfërijnë dhe diç duan të thonë të hutuar"

(“S’është fitomani kur flas me drurët”, faqe 161)

“Ç’ më vonove ti, zogu im i plagosur që më vijë
Nga pas degë pas dege. Unë
hyra vonë në qytet dhe të lashë në periferi.
Hajdeni, më shkarkoni klorofilin e drurëve”.

(“Ngarkuar me klorofilin e drurëve”, faqe, 111)

Shumë nga poezitë i janë kushtuar detit, motiv që do ta shohim dhe më vonë tek veprat e shkruara në greqisht, por më shumë tek vëllimi “Një mijë guacka deti”. Deti me guackat dhe shkumat e tij, me personazhet mitologjike është tek poezia e Kacalidhës herë i qetë dhe i pastër dhe herë i turbullt dhe i acaruar.

Thotë Novruz Shehu në një esse për këtë vëllim poetik: “...Një det i tërë në kitarën e Niko Kcalidhës. Një det i madh që mbart botën. Deti poetik i Niko Kacalidhës rreh brigjet e botës. Thuajse ecën në një balon fluturues mbi detin Jon. Atje bri Sarandës ku helenët dhe ilirët marrin pjesë në martesën e Helenës”¹³ \

¹³Gazeta “Drita”, 26 Maj 2002, faqe 5

“Fija e barit mbin midis dy buzëve të puthjes
të të dashurve dhe hutohan koralet dhe detet”.

(“Fija e barit”, faqe54)

“Ju, nuk e besoni që në breg të detit një mëngjes u shfaqën sirenat.

Me njëmijë ngjyra. Me njëmijë zëra.”.

(“Në breg të detit u shfaqën sirenat”. faqe 76)

“Unë jam paqësor si deti
Dhe i egër si deti”

(“Kredo”, faqe 183)

“Unë e kam detin në jastëk, dhe i besoj
magjisë së detit”.

(“Unë i besoj magjisë së detit”, faqe 117)

“Detin do ta kenë bërë poetët. Do të kenë
shkulur zemrën e tyre dhe do ta ke-
në bërë perlë në mes të guacave.
Dhe do ta kenë vënë mu në mes të bunacës”.

(“Detin do ta kenë bërë poetët”, faqe 69)

Një grup tjetër i tërë poezish bëjnë fjalë për zogjtë. Thamë më sipër se pjesa e parë e veprës ka titullin “Ungjillëzimi i zogjve”. Theksuam se N.Kacalidha është një adhurues i madh i natyrës dhe si i tillë nuk mund të mos u referohet zogjve. Duket se poeti i ka zili këta shpendë që nuk njohin kurrë kufij:

“Zogu i dritares sime vrapoi në dritaren e shtëpive
të ishujve përtej dhe u tha : “Mirëmëngjes!”.

Këndoi këndezi i shtëpisë së tyre dhe zgjoi fëmijën time
që flinte në djepin e bardhë të brigjeve të mia.”

(“Këngë ballkanase”, faqe 13)

“Unë atëherë e besova se në shpirtin e gurit
e në shpirtin e drurit,
në shpirtin e erës e në shpirtin e zogjve,
shpirtat e poetëve do të jenë futur patjetër”.

(“Shpirtat e poetëve”, faqe 11)

Të shumta janë dhe në këtë vëllim simbolet mitologjike: Odisheu, Penelopa dhe Itaka, perënditë e Olimpikut mbushin vargjet e Kacalidhës. Heronjtë e tij ose figurat mitologjike përdoren në shumicën e rasteve si terma poetike por edhe si pasurim dhe si ilustrim poetik. Mitologjia greke me simbolet e saj funksionojnë lirshëm në kufijtë e mesazheve poetike duke bërë lidhjen e kohërave, peripecive dhe motiveve të lashta me motivet e sotme moderne.

Shkruan D.Agolli:“Prandaj ai flet me statujat e perëndive të lashta me gjuhën e metaforës; flet me shpellat, me mermerin dhe me gjethin; flet me heronjtë e miteve si me fshatarët. Edhe me shenjtorët, që mbartin kryqin, flet si me nënën”¹⁴

Kthimi homerik i Odiseut tek Itaka, tek Penelopa besnike dhe djali i tij Telemaku, mërgimi për një jetë më të mirë, dhe ankthi i kthimit tek vendlindja, shfaqen në të gjitha veprat e N.Kacalidhës me nostalgjinë për fshatin e tij Leshnicë:

“Mposhte panikun Odise. Edhe pa dyll veshëve do
t’i kalojmë ngushticat.

Tymi i magjishëm i oxhakut të shtëpisë,
po bie erë Itake”.

(“Itaka e zemrës”, faqe 72)

Fshati i tij i dashur, pyjet, rrepet e lashta, gështenjat, plepat, zogjtë, borziloku, jasemini dhe lulet e tjera, lumi, gjyshja e tij e dashur Ollga dhe gjyshi i tij Nikolla, shtëpia atërore, nëna dhe babai i tij i mënçur, gruaja dhe fëmijë e tij, kujtimet feminare janë pjesë e pandarë e nostalgjisë së poetit. Ai mërgohet që të bëhet më i mençur, si Odiseu i Kavafit, por prapë kthehet tek Itaka e tij, në të dashurën Leshnicë, që t’i besojë sekretet e tij, të ndjehet krenar me historinë e vëndit të tij:

«Këtu Linda. Mes kopshteve ma lidhën kërthizën
dhe u vura shpatullat e mia drurëve,
dhe kërceva si ketër nga pema në pemë.
Dhe jam si në yje”.

(“Kopshtet e Leshnicës”, faqe 86)

Leshnica mund të themi se është një nga muzat e Kacalidhës:

¹⁴.N.Kacalidha,“Profecitë e drurëve”, Shtëpia Botuese “Dritëro”, Tiranë 1998, faqe 5

Peshën e kryqit dhe të Golgothasë mban çdo njeri mbi dhe. Këtu N.Kacalidha krahason veten e tij me Krishtin. Sakrifika shfaqet si shpëtim. Rruga e vështirë për tek kryqi, duke sjellë mesazhe dashurie për njeriun, ngelet një nga vlerat më të rëndësishme të N.Kacalidhës në këtë vëllim poetik. Në këtë vepër kemi një ndërthurje mjeshtërore të poezisë lirike me atë epike.

Thekson Loni Papa: «Vëllimi poetik «Profecitë e drurëve» i Niko Kacalidhës është ndoshta i vetmi në letërsinë tonë, ku esheja poetike ndërthuret me poezinë.

Brenda një «esseje», siç është edhe «Malet ballkanike» gurgullojnë shumë poezi dhe «profecia» e tyre shpesh bëhet gur dhe shpesh shndërrohet në vargje monumentale ose në kranare statujore».

Figurat që përdor poeti janë madhështore dhe të gjalla. Thotë Enver Kushi: “Poeti të çon në të gjitha stinët e vitit. Udhëton bashkë me të tek Prilli i bukur, kalon te Leshnica, rrëmben me duart e tua rufetë e jugut, përgjon erërat te dritaret...”¹⁵

Shumica e vargjeve janë shkruar në periudhën e botimit të veprës, por gjejmë dhe vargje që i përkasin fundit të dekadës së viteve '80, por edhe më parë. Sadik Bejko pohon: “Verbi i tij poetik tashmë mban dhe shijen e vrenjtjen e viteve 90 (Profecitë e druve), që e risollën, e çliruan, e çkyçën grykëderdhjen e tij të rëndë e të dënuar gjatë, e cila të përvidhet heshtur nën dhe’. Ai është tani bir i lirisë në një poezi të lirisë më të thellë të njeriut”.¹⁶

¹⁵Gazeta, « Λαϊκό Βήμα», 12 Maj 1998

¹⁶N.Kacalidha “Eliksiri i gurit”, Botimet “Toena”, Tiranë 2004 ,faqe8

2. ELIKSIRI I GURIT

Qarkulloi në vitin 2004 nga shtëpia botuese “Toena”, në serinë e poezisë së zgjedhur moderne shqiptare dhe përbëhet nga 330 faqe. Prologun me temë “Një poezi ballkanike, poezi e ngjyrave të forta mesdhetare” e ka bërë Sadik Bejko, ku me kritere letrare dhe estetike bën një analizë të thellë të vlerave, duke filluar nga vepra konkrete dhe duke aritur tek gjithë krijimin poetik të N.Kacalidhës. Sadik Bejko vlerëson Kacalidhën si një nga poetët më të rëndësishëm të kohës së tij.

Vepra është e ndarë në 6 pjesë. Pjesa e parë titullohet “Gjeneza” dhe përbëhet vetëm nga një poezi me titull “Metempsikozën duhet ta kenë shpikur poetët”. Kjo poezi gjëndet dhe tek vëllimi “Profecitë e drurëve” me titullin “Shpirtrat e poetëve”. Gjeneza është një fjalë që e përdor shpesh Kacalidha. Tek vjersha konkrete kemi të bëjmë me perceptimin e botës së poetit. Me figura surrealiste do të na bindë se metempsikoza është vepër e poetëve. Krijon një figurë, por tek këto që na thotë gjëndet dhe një e vërtetë shkencore, se në mitet ka ndërhyrë dhe diçka poetike:

«Unë atëherë e besova se në shpirtin e gurit e në
shpirtin e drurit,
në shpirtin e erës e në shpirtin e zogjve,
shpirtrat e poetëve do të jenë futur, patjetër.
Me siguri, metempsikozën duhet ta kenë
shpikur poetët».

(“Metempsikozën duhet ta kenë shpikur poetët”, faqe, 22)

Shkruan Dalan Shaplllo: «Kjo ndërhyrje dhe në mendimin pitagorik dhe në idenë e harmonisë së botës, ashtu siç e përdorte edhe Lasgushi. Dhe këtu besojmë se kemi të bëjmë me një humanizëm fiziologjik, njeriu kërkon të gjejë kudo veten e vet dhe dëshirat e tij intelektuale dhe ëndrrat. Dhe siç është e njohur krahasimi i një ndjenje e bën më konkret mendimin poetik, i jep diapazon dhe freski që të çon në kënaqësi estetike». ¹⁷ Theksuam më sipër se tek kjo poezi takojmë dhe mjete surrealiste, një ndjenje surrealiste që kalon nga bioma personale, përvoja dhe filozofia personale dhe përfundon tek poezia moderne.

¹⁷ “Poezia si triumf njerëzor – N.Kacalidha një nga poetët më të njohur të poezisë shqipe”, pjesë nga kritika e shkrimtarit të njohur, për vëllimin “Profecitë e drurëve, që u mbajt në Tiranë më 15.01.2000

Pjesa tjetër ka titullin “Profecitë e drurëve”. Përmban 88 nga 150 vjersha që i takuam në veprën e mëparshme.

Pjesa e tretë titullohet “Pagëzimi i zogjve” dhe ka 43 vjersha. Meqë kjo pjesë pasurohet dhe qarkullon më vonë në një vëllim më vete, do të bëjmë fjalë më poshtë. Pjesa e katërt ka titullin “Eliksiri i gurit”. Përbëhet nga 18 poezi. Poeti këtu ripunon temat që hasëm më lart në veprën e mëparshme. Poezia e parë ka të njëjtin titull (Eliksiri i gurit). Është nga veprat më të mira të poetit por edhe nga më të vështirat. Këtu vërejmë sesi poeti përdor kozmogjenezën si ide për prejardhjen e krijimtarisë. Shkëmbinjtë, gurët na flasin, na udhëtojnë me mjetet e tyre të pasura lirike në vënde të njohura. Poeti zbulon ankthin e tij ekzistencial por dhe të patriotëve të tij që jetojnë dhe munden me gurët. Personifikon shkëmbinjtë dhe bisedon me gjuhën e tyre të gurtë. Siç theksuam dhe më lart guri përbën një nga mjetet poetike të krijimtarisë së Kacalidhës. Por skemi të bëjmë me një gur të zakonshëm, pa funksion. Guri poetik i N.Kacalidhës ka prejardhjen e tek shtëpia e tij atërore, në fshatin Leshnicë, në vendlindjen e tij. Thotë S.Bejko: «Mali dhe guri janë në qendër të vlerave në një fantastikë të onirikës, në makthe nature, makthe të pandashme që zhbëjnë kozmogoninë e Kacalidhës, e zhbëjnë çdo ditë, çdo cast».¹⁸

Vetë poeti do thotë: “Personalisht besoj në estetikën që më pëshpëritën shkëmbinjtë, se poetika duhet të jetë zëri cilësor i vëndit të tij”.¹⁹

Elementi lirik zotëron i pasur dhe vetvetishëm. Poeti paralelizon veten e tij me një zog:

«Çlirohu mal nga bora e madhe. Se e mbaj unë, borsi i gurit, brengën e profecisë së fundit».

(“Eliksiri i gurit”, faqe232)

Prapë takojmë elemente të mitologjisë greke (Pana, Odisseu, Sirenat, Penelopi, Ariadhni, Orfea etj.), elemente biblike dhe kristjane, (Noe, Adam, Krishti, Golgotha etj.) por dhe elemente të traditës popullore (kali i Konstandinit) dhe motive moderne të mërgimit të cilat kombinohen në mënyrë harmonike brënda në poezi. Brënda këtyre pasqyrohet dhe historia e popullit të tij, e Minoritetit Etnik Grek me peripecitë tragjike që jetoi.

¹⁸N.Kacalidha “Eliksiri i gurit”, Botimet “Toena”, Tiranë 2004 ,faqe8

¹⁹ Gazeta “2000”, Prill 200

S.Bejko thekson:“Dikush mund të mendojë që kjo është qendresa e një etnie. Mire. Një tjetër mund ta marrë dhe si qëndresën tragjike të etnisë tjetër, të Shqipërisë që kaloi nëpër një shkretim apokaliptik të imponuar nga një ideologji totalitare. Kjo është brenda polisemisë kuptimore që e lejon leximi i kësaj poezie”.²⁰

“Sandalet engarkuara të dhimbjes, gjethe
hënore portokalli, nxirnin të vdekurit e detit.
Dhe priste kali Kostandinin, që ndizte qirinjtë
e fundit në varret e vëllezërve”.

(“Eliksiri i gurit”, faqe229)

Përsa i përket vargut mjeteve teknike që përdor poeti, S. Bejko thekson: “Në “Eliksirin e gurit” imitohet teknika e hajkut japonez, imitim i lirshëm, vetëm për nga fryma që çon në rrokjen e përjetësisë dhe freskisë befasuese të çastit, të çasteve që të rregjistruar njëra pas tjetrës, brenda logjikës së fragmentares, krijojnë afreskun e madh të poemës në një rrjedhë gati arkaike por të pashrterur për nga forca e gjallimi. Një frymemarrje e vjetër, por e sigurt e botës” .²¹

Pjesa e katërt ka titullin “Shtëpia e erërave”. Përban një poezi me të njëjtin titull por edhe 38 vjersha të tjera. Poezinë “Shtëpia e erërave” e shkruajti në Sarandë më 7.2.2003. Është një hymn i shtëpisë së tij atërore. Nga shtëpia fillojnë histori paralelle të prindërve, fëmijëve dhe të afërme. Një pohim që flet si për ndërtesën materiale të shtëpisë ashtu dhe për ndjenjat shpirtërore që zhvillohen poshtë çatisë. “Ndërkaq, midis ullinjve dhe humnerave, midis rrufeve dhe pulëbardhave, midis asparagut dhe ciklaminit, porsì një kërthizë të universit poetik të Kacalidhës, qëndron – dhe ma ha mëndja se, veçanarisht me këtë poet, nuk mund të ndodhte ndryshe – simboli më dominues i viseve tona ballkanike: «shtëpia»”.²²

Tradita, trashëgimia stërgjyshore, kultura popullore, vlera dhe ideale brumosen poshtë Tavolinës së Shenjtë. Poeti mund të iki, të mërgohet, shtëpia atërore ngelet gjithmonë atje, e rrënjosur në vendlindjen e tij me themele të forta:

²⁰N.Kacalidha “Eliksiri i gurit”, Botimet “Toena”, Tiranë 2004 ,faqe15

²¹N.Kacalidha “Eliksiri i gurit”, Botimet “Toena”, Tiranë 2004 ,faqe14

²²R.Çollaku,“Dy fjalë për poezinë e N. Kacalidhës”, nga arkivi i poetit

“Unë dhe shtëpia ngjitur kreshtave
vëllezër siamezë, në kurriz të njëri – tjetrit.
Në u djegtë njëri, ç’ drej do të mbetet;
Shtëpia stërgjishore e erërave, shtëpia e perëndive.
Të gjallët e të vdekurit hyjnë e dalin në spiritualizmin netëve.
Ca flenë e ca s’flenë. Rrinë me turne në dritare
Duke përgjuar erërat.
Mbi të pikon llambadari i artë nga bibilushi i hënës”.

(“Shtëpia e erërave”, faqe 265)

Poeti bëhet njësh me shtëpinë e tij dhe referimi i shtëpisë në vargjet e tij nuk mungon kurrë. Bashkë me shtëpinë gjenden dhe të gjitha elementet e tjera që e përbëjnë atë: Tavolina e Shenjtë, hijet e stërgjyshërve, zëri i gjyshe – Ollgës, pragu, kopshti, avlia me hardhinë etj. Shfaqet prapë Odisheu, figura e të cilit nuk mungon kurrë nga poetë si Kacalidha që kanë nostalgji për vendlindjen.

Në vjershat e tjera gjejmë motivet dhe elementet poetike që i kemi hasur në veprën e mëparshme por dhe do i takojmë dhe në veprat në greqisht. Disa nga vjershat e këtij vëllimi si p.sh “Thanë për pragnate të Shën Bartolomeut”, “Kulla e Babelit”, “Qeni i Itakës”, “Menopauza e gurit”, “Oshënari”, “Marina e brigjeve” etj., i takojmë dhe në gjuhën greke.

Vëllimi mbyllet me pjesën që titullohet “Zotat me bluxhins”. Përbëhet vetëm nga një poezi, “Zotat dalin nga tempulli”, ku poeti me vargje të lira do të na bindë se perënditë modernë që dalin nga tempujt janë poetët. Mendoj se do të bëjë një lidhje poezisë së parë me atë të fundit:

“Zotat që dalin nga tempulli me një bluxhins
a me një pale pantallona doku
duke treguar me gisht botën, janë poetët”.

(“Zotat dalin nga tempulli”, faqe 314)

3. PAGËZIMI I ZOGJVE

Është vëllimi i fundit poetik i N.Kacalidhës në gjuhën shqipe. Qarkulloi nga shtëpia botuese “Onufri” më 2006. Prologun e bën shkrimtari i madh me famë botërore Ismail Kadare. Si dhe në veprën “Eliksiri i gurit”, do takojmë kapituj që i kemi hasur dhe në veprat e mëparshme, por do gjejmë dhe poezi të reja që sjellin një frymë të re ripërtëritëse në poezinë e Kacalidhës.

Konkretisht vepra është e ndarë në katër kapituj:

Kapitulli i parë titullohet “Pagëzimi i zogjve” dhe përbëhet nga 59 vjersha nga të cilat 43 i takuam dhe në vëllimin e mëparshëm. Duke parë me kujdes vjershat e këtij kapitulli, shikojmë se poeti ripunon tre elementet bazë të poetikës së tij, zogjtë, drurin dhe gurin. Thekson S.Bejko: “Por do të vijë një Niko Kacalidha tjetër në “Pagëzimin e zogjve”. Tri mitet bazë të poezisë së tij: druri, zogjtë dhe guri vijnë në një përpunim të thellë të vargut dhe të gjithë strukturave poetike. Një dorë e sigurt, dorë mjeshtri. Një stuhi ngjyrash dhe imazhesh sureale që të pataksin”.²³

Kapitulli fillon me kompozimin e madh me të njëjtin titull “Pagëzimi i zogjve” dhe me nëntitull “Gravura e zogjve”. Përbëhet nga 45 poezi. Është një vepër e mbushur me shkëlqim dhe dritë nga njëra anë. Këtë përshtypje ta krijojnë ngjyrat e jaseminit, ciklaminit, limonjve, dallgët e detit dhe shumëllojshmëria e zogjve që parakalojnë para nesh. Nga ana tjetër kemi një ngjyrë gri, një errësirë duke krijuar kështu një antitezë, një kontrast ngjyrash. Por mbizotëron drita dhe shkëlqimi. Përgjithësisht në poezinë e Kacalidhës drita dhe errësira janë të pandara dhe zhvillohen nga vepra në vepër. Mbizotëron herë njëra herë tjetra. Vënd nderi në këtë kompozim kanë zogjtë. Poeti i di mirë, njeh karakteristikat dhe gjuhën e tyre:

«Zogjtë gëmushave bëjnë inventarin e zogjve.

Në foletë e diellit kllaçitin vezët e hënës.

Kërbishtorët e brishtë me kompleksin e shtagtimit:

1. Dallëndyshja mw rërën, gëlqeren dhe barin.
2. Borsi shkretan, zogu i borës, rojtari strikt i dimrit.
3. Dhe çafkëlori.
4. Bishtatundësi
5. Trumcaku.
6. Kryeartëza dhe
7. Zogu i barit

²³N.Kacalidha “Eliksiri i gurit”, Botimet “Toena”, Tiranë 2004 ,faqe8

8. E plotfuqishmja e lumenjve, mullenja e gëmushave ujore.
9. Çajmeja e bardhë.
10. Dhe shapka e marrëzisë që ruan drurët.
11. Pikthi atlet që gdhedh fyej nga vertebrat e drurëve.
12. Trishtili i trishtuar i oborrit mbështjellë me pelerinë murgu.
13. Pëllumbi ungjillor që endet nëpër koshte.
14. Dhe gushëkuqi.
15. Bilbili i frashërit, naiv i pagjumë.
16. Dhe gargulli.
17. Thëllëza.
18. Kanarina e brishtësisë.

Duke kllaçitur aktin e gjenezës, precizin inventar stinor të zogjve”.

(“Pagëzimi i zogjve” ,faqe 17)

Shkruan për këto krijesa krenare, që nuk ulin kokën dhe nuk lihen në prehërin e fatit. Deri në një shkallë ka ndikime nga tradita popullore. Njohim sa shpesh në këngën popullore zogjtë flasin dhe vajtojnë.

Si në një film kinematografik paraqiten para nesh, përmes poezisë së Kacalidhës, historia e dhimbshme e atdheut të tij. Poeti disa herë ndjen nevojën të ndeshet me këtë dhimbje duke na dhënë mesazhe optimiste.

Karakteri fetar dhe këtu ashtu si dhe në veprat e mëparshme është i dukshëm, një orientim ortodoks që përmbys hapësirën konvencionale. Këtë gjë në letërsinë greke e gjejmë tek shumë poetë si p.sh tek D. Sollomos, A. Kallvo, J. Seferi, etj, kurse tek poezia shqipe e gjejmë tek N. Frashëri dhe tek L. Poradeci: “Kjo larg e larg të çon te koncepti i Naim Frashërit që jo vetëm krijonte, por dhe bekonte, shenjtëronte. Kjo formalisht vërehet edhe në tituj të disa poezive: “Ungjilëzimi i zogjve”. “Pagëzimi i zogjve”. Naimi e Lazgushi flisnin për një fjalë të shenjtëruar. Urinë për shenjtëri dhe virgjëri në natyrën e bukur”.²⁴

Kurse për këtë vepër S. Brokaj thekson: “Marrim një nga mrekullitë e tij, mbase kryeveprën e tij, poemën “Pagëzimi i zogjve”. Ungjilëzues, pagëzues i zogjve, i këtyre gjallesave eterike, që i përkasin qiellit, që nuk njohin kufij dhe gjuhë tjetër veç cicërimës, që është kudo dhe kurdoherë e tyja. Kjo është poezi e madhe e tij, mbase dhe emblema e artit të tij – ai shenjtëron fluturaken në jetë, dhe njëkohësisht e përjetëson dhe e fikson në gjuhë, në fjalë atë.

²⁴N.Kacalidha “Eliksiri i gurit”, Botimet “Toena”, Tiranë 2004 ,faqe11

Ai është qiellor dhe aq tokësor si zogjtë, aq i brishtë në artin etij dhe aq i fortë si zogjtë – aq me flatra e aq me fyej të hollë si eshtrat e zogjve dhe kërcenjtë e barit, ai këndon të pakapshmen, qielloren e të magjeps si zogjtë që zbukurojnë jetën dhe tokën, pa kërkuar strehë, bukë, ujë, pa vënë ndonjë detyrim veç të këndojnë, të fluturojnë e të përtërihen pambarimisht. Ai na çon te kjo mrekulli e pafajësisë virgjërore që jeton me drurët, jeton përtej nesh dhe pavarësisht nga ne, mrekulli e lirisë, e qiellit, e natyrës; te jeta e zogjve përherë ashtu siç i ka krijuar krijuesi në ditën e pestë të gjenezës, një ditë para se të krijonte njeriun”.²⁵

Kapitulli i dytë titullohet “Eliksiri i gurit”. Përmban 22 poezi, të cilat i takuam në vëllimin e mëparshëm poetik.

Kapitulli i tretë ka titullin “Shtëpia e erërave”, ku mbizotëron motivi i shtëpisë atërore dhe i vendlindjes. Edhe ky kapitull përfshihet në vëllimin e mëparshëm, për të cilin folëm më lart.

Kapitulli i katërt dhe i fundit titullohet “Hiri i hidhërimit”. Përbëhet nga 59 poezi të cilat si kemi hasur më parë. Mund të themi se bëjnë pjesë në veprat jo dhe aq optimiste të poetit. Shkëlqimi dhe drita pak nga pak tërhiqen:

“Lëkura varur drurëve
flamur i zi i erës.

Pas tyre gjarpërinj me brirë të tmerrit”.

(“Lëkura e gjarpërit”, faqe 216)

Përban një pasuri figurash, një ndjenjë të gjallë të botës dhe një zë poetik autentik. Poeti na paraqitet prapë adhures i vendlindjes dhe i natyrës. Në shumë vjersha mbizotëron dhe motivi erotik:

“Drurët veshur me minifunde
mbledhur mbi gjurin e gjelbërimit,
nën to mbështetur merrej puthja”.

(“Minifundi i drurëve”, faqe 227)

Janë të dukshme novatorizmat morfologjike, liritë e vargut dhe guximi shprehës. Konkretisht të gjitha vjershat e kapitullit janë të përbëra nga tri vargje të lira.

²⁵N.Kacalidha “Eliksiri i gurit”, Botimet “Toena”, Tiranë 2004 ,faqe15-16

3.2 VEPRA E NIKO KACALIDHËS NË GJUHËN GREKE

3.2.1 PERIUDHA 1971 – 1990. VËLLIMET POETIKE. TEMATIKA, NDIKIME, KARAKTERISTIKA.

Vëllimet poetike në gjuhën greke të kësaj periudhe kohore janë si më poshtë:

1.« Η κοίτη του ποταμού μου » -1982 (Shtrati i lumit tim)

2.« Λιόφωτο λιανοτράγουδο » -1985 (Lirikë diellore)

3.« Ανταύγες » - 1989 (Refleksione)

Vëllimin e tij të parë poetik në gjuhën greke me titull (Θροίσματα και φυλλωσιές)“Fëshfërime dhe gjethnaje” poeti e shkruajti herët më 1966 , por ngeli i pabotuar në sirtaret e shtypshkronjës “Naim Frashëri” dhe tani gjendet dorëshkrim në arkivin e poetit.

Vëllimi i parë poetik i botuar në gjuhën e tij amtare qarkullon më 1982 dhe mban titullin “Shtrati i lumit tim”, por poezi të poetit në greqisht i gjejmë në gazetën e Minoritetit Etnik Grek «Λαϊκό Βήμα » që në vitin 1976.

Duhet të shohim N.Kacalidhën objektivisht brënda klimës së gjerë shoqërore dhe poetike të brezit '70. Poeti jeton në një epokë degradimi. Kemi të bëjmë me një poezi që reziston për një karakter autonom, duke vazhduar udhën e brezit të mëparshëm të Kadasesë, Arapit, Agollit etj, duke pasur ndërkohë një prirje rezistence dhe duke u përpjekur për elemente ripërtëritëse.

Disavantazhet, mangësitë që takojmë në poezinë shqipe të periudhës së tretë përsa i përket pompozitetit dhe prozaizmit, shfaqen dhe në poezinë e Kacalidhës. Kemi të bëjmë me një poezi politike të varur nga realizmi socialist.. Realizmi socialist dhe politika militariste heqin shumë elemente etnike nga letërsia. Në asnjë krijues të asaj periudhe, duke përfshirë dhe Kacalidhën nuk takojmë termat Greqi dhe grek. Kjo nuk do të thotë se mohuan origjinën e tyre greke, por duke jetuar në një sistem të tillë diktatorial nuk mund të bënin ndryshe. Në poezinë e Kacalidhës termi atdhe është jo konkret :

« Το νάσαι βράχος θε να πει

Να ζεις χιλιάδες χρόνια.

Βράχος κι εσύ πατρίδα μου,

Αγέρωχος, αιώνια !»

“Te jesh shkemb do te thote

te rrosh me mijra vjet.

Shkemb dhe ti atdheu im

i patundur, perjete!” (“Atdheu”, Shtrati i lumit tim, faqe.3)

Në poezinë e NikoKacalidhës termi atdhe është identik me vendlindjen e tij, Leshnicën, e cila bëhet simbol dhe i kushton shumë vjersha. Kështu në veprën “Refleksione” takojmë vjershat “Leshnicë”, “Skenografia e vëndit tim”, “Gur stralli” etj. Në veprën “Shtrati i lumit tim” takojmë vjershën “Dyfekët Lesiniciote” etj. Në vëllimin “Lirikë diellore”, në veprën me të njëjtin titull prapë vendlindja dhe dashuria për vëndin e tij janë lajtmotivet e poezisë së tij. Vendlindja pra është te Niko Kacalidha nga motivet më të rëndësishme, njëri nga akset e poezisë së tij.

Ndërprerja e çdo lloj lidhjeje me letërsinë e trungut kombëtar, padijenja për traditën letrare greke i bëri krijuesit minoritarë të merren me traditën popullore. Mirë që ekzistonin disa vepra të Ricosit, Varnalit, Livadhitit, Rita Bumit – Papa, të cilat pavarësisht ngarkesës së tyre ideologjike, ndihmuan shumë krijuesit minoritarë në fushën e gjuhës. Konkretisht te vepra “Lirikë diellore” të N.K shikojmë ndikim të dukshëm të 15-rrokëshit, të vargut të këngës popullore, por dhe të teknikës së vargut të Ricos.

Nga avantazhet e poezisë së tij të asaj periudhejanë frymëzimi krijues i bazuar në motivet e traditës popullore, shënjat e së cilës janë të dukshme akoma edhe sot. Në këtë fushë ndihmoi shumë gjyshja e poetit, por veçanërisht babai i tij specialist në folkloristikë. Huazon nga folklori elementë shprehëse dhe shkruan vargje duke imituar këngën popullore:

«Γιάννη μου, αν ήσουν στο χωριό, Γιάννη μου, Γιάννη μου

Το έρμιο το μαντήλι, Γιάννη μου, Γιαννάκη μου.

Μπορούσε να στο ξέπλενε, Γιάννη μου, Γιάννη μου

Και μια δροσοσταλίτσα, Γιάννη μου, ντέλη Γιάννη μου.

“Jani, po të ishe në atdhe, Jani im, Janaqi im,
shaminë tënde të shkretë, Jani im, Janaqi im,
do të ta lante në mengjes, Jani im, Janaqi im,
qoftë dhë një pikëz vese, Jani im, Janaqi im.

(Shamia jote Jani im), “Shtrati i lumit tim”, faqe 87)

Vihet re në veprat e fundit, një largim nga referimi i termave, simboleve dhe figurave të njohura historike të Shqipërisë dhe përqendrimi i vëmëndjes në simbole lokale.

Shfrytëzon kështu mite dhe tradita lokale, si psh ai i Monogjires te vjersha “«Δεκαπέντε μέρες νύφη, κυρ- Γιωργάκαινα», (“Pesëmbëdhjetë ditë nuse zonjë-Jorgjena”, “Refleksione”, faqe 49), ose atë të Skotinisë te vjersha «Η μαύρη νύχτα της Σκοτεινής» .(“Nata e zezë e Skotinisë”, “Shtrati i lumit tim”, faqe 49)

«Η Μονοβύζα έκαψε χωριά, πήρε σκλάβους.

Πήρε και τη Γιωργάκαινα, δεκαπέντε μέρες
νύφη, ζαλωμένη το προικιό.

Απ’ το θρύλο

Δεκαπέντε μέρες νύφη, ζαλωμένη το προικιό,
κυρ-Γιωργάκαινα καημένη, τα’ ήταν κείνο το κακό;

Πού ‘ν’ τα κάλλη, η ομορφιά σου, τα χρυσαφικά;
Ωχ, σε πήρε η Μονοβύζα πέρα στη Φραγκιά!

Δεκαπέντε μέρες νύφη, όμορφη, στα νιάτα σου.
Κοίτα πίσω την καπνούρα, σε φωνάζ’ ο άντρας σου.

Κοίτα πίσω την αντάρα και την καταχινιά,
Διαμαντόνυφη του Γιώργου, γύρνα τ’ είσαι ναι.

Τ’ ήταν κείνη η μαυρίλα, χαλασμός μες στο πουρνό;
Πήγες κι έμεινες στο θρύλο, ματωμένος ουρανός.

(“Monogjirja dogji fshatra, mori skllevër.
Mori dhe gruan e Jorgjit, pesëmbëdhjetë ditë
nuse, e ngarkuar me pajën e saj.

Nga legjenda

Pesëmbëdhjetë ditë nuse, ngarkuar me pajë,
Grua e gjorë e Jorgjit, ç’qe kjo gjëmë vallë?

Po ç’u bënë xhevahiret, po hiret ku vanë?
Të rëmbeu Monogjirja pa e ditur, larg.

Pesëmbëdhjetë ditë nuse, e bukur, e re.
Pa shiko prapa mes tymit, burri të thërret.

Pa shikoje prapa terrin, mjergullën dhe retë,
Nuse xhevahire e Jorgjit, kthehu sa më shpejt.

Ç' ishte ajo errësirë, ky mëngjes i shkretë?
Ike, qiell i përgjakur, mbete në legjendë.)

Poeti përpiqet të bëjë një kthesë përta i përket intimitetit të poezisë së asaj periudhe, në një epokë ku poezia ishte veçanërisht një poezi adhuruese.

Ndër disavantazhet e asaj poezie mund të përmendim gjuhën, që është e varfër. Akoma takojmë dhe disa fjalë shqipe dhe idiomatike. Thekson N.Ifantis:“Udha e tij poetike e asaj periudhe pasqyron udhën e jetës së mjerë të bashkëpatriotëve të tij. Është e lidhur me klimën dekadente, të vetmisë së hidhur, të pesimizmit të thellë, brenda një bote tërësisht të errët. Bota e tij është njeriu i përçarë i viteve të turbullta”.²⁶

²⁶Revista, «Ηπειρωτικά γράμματα», Shkurt 2006, faqe 596

3.2.2 PERIUDHA 1990 – 2008. VËLLIMET POETIKE.

TEMATIKA,NDIKIME, KARAKTERISTIKA.

Vëllimet poetike në gjuhën greke të kësaj periudhe kohore janë si më poshtë:

1. «Το μοιρολόι του βουρκωμένου βουνού», Θεσσαλονίκη 1994
“Vaji i malit të vrenjtur”, Selanik 1994
2. «Κι η Σφίγγα μίλησε», Θεσσαλονίκη, 1995
“Dhe Sfinksi foli” Selanik 1995
3. «Τα πικρολέμονα», Κύπρο, 1995
“Limonj të hidhur”, Qipro 1995
4. «Τα εκατό εκατόφυλλα της Πούλιας», Θεσσαλονίκη 1997
“Njëqind trëndafila” Selanik 1997
5. «Η αμβροσία των βράχων», Κέρκυρα, 1997
“Ambrozia e gurit”, Korfuz 1997
6. «Το δάκρυ του κυκλάμινου», Αθήνα, 1998
“Loti i ciklaminit”, Athinë 1998
7. «Η πύλη των βοριάδων», Θεσσαλονίκη, 1998
“Dera e murlanit” Selanik 1998
8. «Χίλια κοχύλια, Ιωάννινα, 1999
“Një mijë guacka deti”, Janinë 1999
9. «Η πρόρα των άστρων», Θεσσαλονίκη 2001
“Bashi i yjeve” Selanik 2001
10. «Η μοίρα του αμάραντου», Θεσσαλονίκη 2003
“Fati i amarandusit” Selanik 2003

1. «Το μοιρολόι του βουρκωμένου βουνού»
“Vaji i malit të vrenjtur”,

Bëhet fjalë për një kompozim poetik të përbërë nga 105 vargje 15–rrokëshe jambe me rimë. U kompozua nga poeti më 30.12.1990-10.01.1991, gjatë periudhës së ikjes së madhe. Vetë poeti bën dhe prologun e veprës që u botua në Selanik më 1994. Tregon në prozë dhe njëkohësisht ndjen dhëmbje për orët dramatike që kalon vendi: “Vendi kalonte netë tragjike. Jetonim mallkimin e kombit tonë. Ishin netët e frikshme me errësirën e dendur të Dhjetorit të 1990 që pikonin gjak. Pak më parë dëgjoheshin mitralozat e ushtarëve që çanin qiejt dhe kërcisnin dhëmbët e urejtjes së policëve që zvaritnin djemtët tanë nëpër fusha. Vendi kalonte si në Paraqitjen e Dytë rrëmujën e Apokalipsit. Hidheshin poshtë ratikolat e diktaturës që dukeshin si fantazmat e tmerrit dhe gjakosnin vendin. Dy hapa më tej atdheut tim, fshatit tim, Leshnicës, dy hapa më sipër ndaheshin dy shtete”.²⁷

Binte një sistem autoritar, diktatorial, tiranik e çnjerëzor. Mijëra njerëz duke kërkuar një jetë më të mirë linin atdheun e tyre dhe merrnin rrugën e mërgimit. Është një vaj lëndimi dhe dhimbjeje “ashtu siç e dëgjova nga një nënë e shpupuritur një mëngjes të atij dimri të akullt”.²⁸

Një vajtim tronditës ku përmes zhvillimit të tij dramatik na tregon me realizëm tragjedinë e ikjes së madhe. Nën at shamizeza u luten fëmijëve të tyre të kthehen prapë:

" Πού πας, που πας, λεβέντη μου, στη νύχτα του χειμώνα;
Πάνω είναι μαύρος ουρανός και κάτω είν' άσπρα χιόνια.

Βογκάει ο τόπος μας βαθιά και λέει: "Γιε μου, γύρα!"
Κι η μαυρομαντιλούσα εγώ, σε καρτερώ στη θύρα."

(“Ku shkon, ku shkon djaloshi im, në këtë natë të shkretë?
Poshtë e ka shtruar borë e bardhë, në qiell nxijnë retë.

²⁷N.Kacalidha, «Το μοιρολόι του βουρκωμένου βουνού», Selanik 1994,faqe 6

²⁸N.Kacalidha, «Το μοιρολόι του βουρκωμένου βουνού», Selanik 1994,faqe 3

Trojet rënkojnë në thellësi dhe thonë: “Kthehu bir!”
Dhe lidhur me shaminë e zezë, unë te pres në derë”)

Përshpirten gjyshërit pleq të vdekur, hidhen në mesnatë, hapin varret dhe lusin fëmijët e tyre:

" Παιδιά, μη μας αφήνετε στη μοναξιά, στα πλάγια,
να γίνουμε βρικόλακες, να βγαίνομε τα βράδια.

Μη κόβετε τις ρίζες σας, χτυπήστε το κεφάλι.
Αυτό θα ` ναι ξεριζωμός, θα ` ναι κι οργή μεγάλη."

("Ο djema, mos na lini këtu në pllajat vetmitare,
të shndrohemi lugeter, të dalim dhe nga varret.

Mos i këpusni rrënjët, djema bjerini kokës.
Se do të jetë shkatërrim, edhe mallkim i kohes.")

Në mënyrë elegjake na flet poeti dhe për ata që lanë kockat e tyre në malet
mbushur me dëborë, atë dimër të akullt:

"Κι η μαύρη χλαίνη των βουνών το μαύρισε το χιόνι.
Ποιος δεν παγώνει σήμερα, ποτές του δεν παγώνει.

Μα νάτος. Κάποιος πάγωσε. Και κάποιος άλλος. Νάτος.
Σαν μπρούτζινα αγάλματα απ` την κορφή ως τον πάτο."

(Guna e zezë e maleve e paska nxirë borën.
Kush do shpetojë sot s' ngrin në ditët dimërore.

Po ja dikush paska ngrirë, ka ngrirë dhe një tjetër.
Si statuja bronxore këtu do mbeten gjithë jetën.")

Figurat natyrore kapin dimensione tragjike vetmie. Sipër qielli i errët dhe
poshtë monotonia e dëborës që intensifikon kështu më shumë ngricjen shpirtërore dhe
frikën e vetmisë. Vajton vendi, bisedojnë malet, erërat, ujqërit dhe shpendët
grabitqarë, pemët dhe kafshët që i lanë vetëm. Zogjtë nuk cicërojnë më dhe dielli
bëhet akull:

"Γύρνα σου λέει ο τόπος σου, φαραγγια, ρούγες, ράχη.
Έλα σου λέει η πατρώα γη, τι μ` άφησες μονάχη;"

"Τι ξέρεις γεροπλάτανε; πες τα κοφτά, σταράτα.
"Τι ξέρω που να ξεραθώ, τουτ` είναι μαύρη στράτα."

"Κι όλες τις κλάρες η ρόδια κατέβασε στο θρήνο.

Τι να σου πω; σαν να μου λέει, κοντά σου εγώ θα μείνω"

"Και χλιμιντρίζουν τα` άλογα. Κι η προβατίνα μόνη,
σάστισε. Και τα` αρνάκι της αγλείφει εκεί στο χιόνι".

"Και στις αυλής την παρθενιά το πατημένο χιόνι.
Στην άκρη της κληματαριάς μοιρολογάει το τσόνι."

(Κtheu, vendlindja thërret, kodrat, udhët, humnerat.
Eja, të thotë vendi i shkretë, këtu më le me erërat.

“Ç’ na thuaj ti o rrap plak, tregona qartë e prerë.
“Ç’ farë mund të them edhe unë në këtë udhë të mjerë”.

Degët e saj përkul përdhe shega duke vajtuar.
Ç’ farë të them, sikur thotë, prej teje s’ jam larguar.

Dhe hingellijnë kuajt. Dhe delja paska ngrirë.
Dhe në vetmi mes borërave qengjin duke lëpirë.

Dhe borë e virgjër në obor e shkelur këtë dimër.
Edhe në cep të pjergullës zogu me ligjerime.”)

Të gjitha çastet emocionale, kuptimet njerëzore i shfrytëzon poeti që tu dërgojë një mesazh gjithë atyreve që morrën rrugën e mërgimit për një jetë më të mirë, të qendrojnë me dinjitet në dheun e tyre. Duke e lexuar të krijohet përshtypja se lexon një këngë popullore. Poeti përdor shumë elemente të huazuara nga vajet popullore dhe inkuadrimi i tyre në këtë poezi, lidhja e tyre organike, tregojnë zotësinë sintetike të krijuesit të tyre. 15-rrokëshi në duart e krijuesve të paaftë bëhet monoton dhe i lodhshëm, Kacalidha si një poet me tërë kuptimin e fjalës i jep thellësi dhe muzikalitet.

Evangelia Papakristu-Panu thekson për këtë kompozim: “Duke e lexuar dikush pyet veten, çfarë kanë më shumë lirikat e të pahuarit Ricos në “Epitafin” e tij. Dhimbja e zemrës njerëzore është e njëjtë, ndryshon vetëm në volum dhe në kohëzgjatje. Është e thellë dhe tragjike në të gjithë botën. Dhe kur është dhe dhimbje e zemrës amtare atëhere është dhimbje e padurueshme!!!”²⁹

Kurse poeti qipriot Q. Krisanthis thotë: “Vaji i malit të vrenjtur” na këndon dhimbjen në formën e dyvargëshit popullor në mënyrë simbolike... Eshtë e vërtetë që këto dyvargësia të lëndojnë zemrën. Në fund të fundit në qoftë se do dikush të këndojë dhimbjen e tij, atëhere zgjedh formën poetike që kombinohet me pulset e tij personale”.³⁰

Jorgos Vrelis shkruan: ““Vaji i malit të vrenjtur” është zëri i guximshëm i poetit autokton N. Kacalidhës... Vargje tërë gjallëri, me një dëndësi lakonike”.³¹

²⁹ Revista “Σύνδεσμος”. Shtator 1994, faqe 8

³⁰N.Kacalidha, «Η αμβροσία των βράχων», Athinë 1997, faqe 175

³¹Gazeta, «Πρωινά νέα», 20 Korrik 1995

2. «Κι η Σφίγγα μίλησε»

“Dhe Sfinks i foli”

Në “Vaji i malit të vrenjtur” flasin malet, pemët, nënat shamizeza dhe gjyshërit e vdekur. Në vëllimin “Dhe Sfinks i foli”, flet vetë poeti. Vëllimi poetik qarkulloi më 1995 në Selanik nga shtypshkronja “Migdhonia” dhe përbëhet nga 159 faqe. Në 72 vjersha poeti bëhet greku diakronik duke dhënë dëshminë e tij që nga eposet

homerike. Leonidha me Termopilet, Odisheu më Penelopën dhe Nafsikan, “Antigonet”, Ekavi me Helenën, Herkuli, Oqeanidet, Akili etj. referohen mbrenda në vepër.

Sfinks, që në kohërat e vështira të izolimit nuk mund të fliste, tani shpërthen, lë fantazinë në mënyrë të lirshme dhe shikon gjërat nga një tjetër këndvështrim. Më parë ishte i detyruar të jetonte në një ambjent shtypës, nën një sistem barbar, që mbyste mendimin e lirë. Tani hedh poshtë prangat dhe thyen zinxhirat e skllavërisë. Poeti tani është i lirë por i lodhur dhe zhgënjyes. Enigmat që për shumë vjet eshqetësonin vazhdojnë akoma ta mendojnë:

«Σαν μια Σφίγγα στέκομαι στη μάντρα του πρω-
γιού και των ανέμων.

Σαν μια Σφίγγα στέκομαι στην άκρη του δρόμου
και στον ίσκιο των δέντρων.

Σαν μια Σφίγγα στέκομαι και μαρμαρώνω τους
Οδοιπόρους.

Και κανένας δεν μπόρεσε να μου λύσει τα αινίγ-
ματά μου»

(Si një Sfinks qëndroj në oborin e mëngjesit
dhe të erërave.

Si një Sfinks qëndroj ndanë rrugës,
në hijen e drurëve.

Si një Sfinks qëndroj dhe ngurosh kalimtarët.

Dhe askush nuk m’i zgjidh enigmat e mia.)

(“Enigmat e Sfinksit „faqe 101)

Poema e tij “Asketi”, që morri çmimin e parë në një konkurs Panhelenik, është shembull i kërkimeve të tij shpirtërore. Është kompozuar në vargje 12-rrokëshe me rimë dhe është një vazhdim i “Vajit të malit të vrenjtur”. Është në vetën e parë dhe na emocionon me tonet e tij lirike.

Tema e mërgimit referohet dhe në poezi të tjera. Lotët shteruan dhe nënat e rudhosura në vetminë e tyre vajtojnë për shpresat e humbura dhe presin me mall fëmijët e tyre që të risjellin gëzimin:

Βρύσες μουρμουρούν στη μοναξιά τους για το δά-

κρυ τ` Απρίλη. Κι οι γριές που θρηγούν στο βα-
ρελοστάσι για την κλεισμένη πόρτα τους.

Αυτές κι εγώ που θα` μια πάντα εδώ πάνω και θα φω-
νάζω : «ουντέρα» στις αντάρες και στη λυκουνιά»

(Gurrat gurgullojnë në vetmi për lotin

e prillit. Dhe plakat që vajtojnë pranë

vendit të bucelës për derën e mbyllur.

Ato dhe unë që do të jem përherë këtu lart

dhe do t'u ulerijë mjergullave dhe ujqërve.) (“Shkatërimi” faqe 59)

Zëri i poetit është dramatik kur i thëret bashkëatdhetarit të vet: “Odisse kthehu në shtëpi!”. Më figura të përditshme i lutet popullit të tij të qendrojë në trojet e veta. Sipër Kullës Babel kërkon të gjejë zotin dhe thëret: “Zoti im ku je?”. Një prototip të veçantë ka poezia e tij “Muret u çanë dhe nuk ngjiten më”. Është e kompozuar në 11-rrokëshe dyvargjëshe dhe na tregon në mënyrë dramatike agoninë e poetit për fatin e patriotëve të tij. Në një tjetër vjershë me titull “Qëndrimi i Sisifit”, poeti do të lirojë heroin mitologjik nga ngarkesa e tij, dhe të mbajë ai në shpatulla shkëmbin e madh. Paraqitet lirik te vjersha “Lule e helmuar”, i butë dhe optimist në “Do të gjallëroj shtëpinë time”.

Elegjak dhe vajtimtar në poemen e tij “Bibla e të vrarëve”. Si shkak merr vdekjen e padrejtë të 5 të rinjve nga fshati Aliko (12 Dhjetor 1990) dhe deponimin dëshmues të një nëne: “ I vranë. I zvaritën të gjakosur pas traktorëve. Në pafundësinë e fushës. Deri sa u ngelën kafkat. I kaluan të zhveshur në mes të pazarit. I goditën. I pështynë. I shtynë. Të lidhur këmbë e duar. Për tek Hadi. I pashë të gjitha me sytë e mi, o djali im. O bobo ç`më panë sytë në telat e kufirit atë dimër të ashpër”.³²

³²N.Kacalidha, «Κι Σφίγγα μίλησε...», Selanik 1995, faqe 55

Poeti s'mund të mbajë pikëllimin e thellë që ndjen. Vaji merr dimensione dramatike duke na kujtuar kështu tragjedinë e lashtë greke. Vdekja kalon nga “krakurat”, ecën sipër maleve, gremis dyert dhe dritaret dhe zaptton trimat:

« Ο θάνατος πόδεσε τις αρβύλες του κι όπου πατά-

ει, πηδούν τα συντριβάνια του αίματος των

παιδιών μας.»

(Vdekja veshi këpucët e saj

dhe kudo ku shkel kërcëjnë

shatërvanet e gjakut të djemve) (faqe 129)

N. Ifandis për këtë poemë thekson: “Kompozimi poetik “Bibla e të vrarëve”, është “sinaksari” i martirëve dhe poeti “i ngarkuar me peshën e kryqit të vëndit të tij”³³.

³³ Gazeta “2000”, Prill 2000

3. «Τα μικρολέμονα» “Limonj të hidhur”

Lidhjet e poetit me Qipron, që u zhvilluan me vizitat e tij në ishullin e Afërditës, gjetën shprehje në vëllimin e tij poetik “Limonj të hidhur”. U botua nga Shërbimet Kulturore të Ministrisë së Kulturës së Qipros më 1995. Përbëhet nga 51 vjersha, 50 nga të cilat i janë kushtuar Qipros. Prologun e bën vetë poeti ku përmes një gjuhe poetike na jep të gjallë figurën e Qipros:

“Çdo hap dhe një muze. Çdo plis dhe një histori. Çdo gur dhe një mit. Dhe toka e mbjellë me kocka. Kallogjerët të varur në hunj”.³⁴ Poeti me vargjet e tij na flet për

përvojën traumatike të ishullit, për hidhërimet dhe gëzimet e saj. Tematika e tij është e njohur. Shpreh me tone filozofike lidhjet e tij me Qipron. Rrëfime, falënderime, protesta dhe një det i tërë ndjenjash dalin nga vjershat e tij. E lidh poetin një dashuri që ka si burim frymëzimi disa herë mitet dhe traditat dhe disa herë historinë shumëdallgëshe të Qipros. Na flet për vuajtjet e ishullit, shpresat për liri dhe për karakterin e tij kombëtar dhe fetar. Vëllimi fillon me vjershën “Tryeza e mikpritjes” duke theksuar kështu pritjen e ngrohtë që i rezervuan banorët e ishullit:

"Κι είπαν οι Θεοί:

- "Πού να στρώσομε το τραπέζι της φιλοξενίας;"
- "Στην Κύπρο, είπ' ο Δίας."

(Dhe thanë perënditë:

-Ku ta shtrojmë tryezën e bujarisë?

-Në Qipro, tha Zeusi.) (faqe 15)

Poeti ndjeu tmerin e pushtimit. Vëren me lëndim Nikosinë, kryeqytetin e vetëm në Evropë që është i ndarë. E shikon dhe pyet veten:

"Τη μαύρη γραμμή, πώς και την είπαν πράσινη
αφού χωρίζει στη μέση μια καρδιά που στάζει αίμα
κι ο τόπος ζαλίζεται σαν από επιληψία;" (faqe 38)

(Ketë vijë të zezë pse e kanë quajtur të blertë
ndersa ndan në mes nje zemer te pergjakur
dhe vendit i erren syte si prej epilepsise?)

³⁴N.Kacalidha, «Το καράβι της Κύπρου με τα πικρολέμονα», Nikosia 1995,faqe11

Famagusta është vend që plagos poetin:

"Όλη τη νύχτα οι γυναίκες στον ύπνο στα όνειρά τους τρέχουν σαν υπνοβάτες
να κοιμηθούν στην Αμμόχωστο. Να περιποιηθούν τις στέγες.
Να μη σαπίσουν οι κολώνες". (faqe 36)

(Gjithë natën gratë, përgjumësh ëndrrave rendin si somnambul, të flenë në Famaguste.
Të meremetojnë çatitë. Të mos kalben kollonat e shtëpive.)

Njerëzit atje jetojnë me shpresën e rikthimit në trojet e tyre autoktone. Janë të sigurt që një ditë do kthehen në shtëpitë e tyre. Prandaj poeti u thotë:

"Φυλάξτε το κλειδί να μη σκουριάσει στο νοτιομένο μας νοτιά,
γιατί θα χρειαστεί μετά βροχής ν' ανοίξουν οι πύλες της Αμμοχώστου,
να ξανανθίσουν τα γιασεμιά στις αυλές...". (faqe 37)

(Ruani çelsin mos ndryshket në jugën e vesuar
se duhet pas shiut të hapen dyert e Famagustes,
të riçelen jasminet oboreve)

Dy poezi u janë kushtuar poetëve qipriotë K.Mondi dhe Q. Krisanthi dhe kanë si aks të përbashkët poezinë dhe krijimtarinë artistike. Në vepër do të gjejmë dhe poemën e madhe «Εκτακτο γράμμα στη μητέρα», “Letër urgjente nënës”. Është i vetmi kompozim që nuk i referohet Qipros. Është një letër që dërgon poeti Greqisë. Shkruan me guxim e fëmijës që i drejtohet nënës së tij. Pasqyron të gjitha çastet tragjike që kaloi Minoriteti Etnik.Grek në kohën e diktaturës, por edhe gjëndjen pas viteve 1990. Në këtë poemë flet me gojën e N.Kacalidhës gjithë Minoriteti, thotë vuajtjet dhe brengat e saj. Njerëzit e tij edhe pse të haruar dhe të lënduar përballuan çdo gjë me trimëri dhe kurrë nuk u përulën. Poeti në emër të bashkëatdhetarëve të tij kërkon nga Greqia mbështetje morale por edhe atë që si nënë është e detyruar të bëjë për fëmijët e saj.

Poeti i madh qipriot Qipros Krisanthis, i cili dhe është përkthyer në shqip nga N.K thotë për vëllimin poetik: “ Poezitë e vëllimit “Limonj të hidhur”, kthehen në kujtesën tonë me ndjeshmërinë dhe aftësinë e vëzhgimit të Kacalidhës. “Letër urgjente nënës” që të kujton frymën e K.Montit, dhe përbëhet nga 25 pjesë , të cilat të ofrojnë emocione të pazakonshme”.³⁵

³⁵ N.Kacalidha “Eliksiri i gurit”, Botimet “Toena”, Tiranë 2004 ,faqe32

4. «Τα εκατό εκατόφυλλα της Πούλιας» “Njëqind trëndafila”

Dashuria është një nga ndjenjat më fisnike të njeriut dhe është një burim i pashtërshëm frymëzimi për të gjithë poetët që nga lashtësia deri sot. Ky vëllim poetik i N.Kacalidhës botohet më 1997 nga Qendra Ndërballkanike të Librit. Ka nëntitullin: “Rrëfim erotik”. Kjo vepër i kushtohet gruas së tij Dhespina (Pula) (Plejadë). Përban 113 poezi, të periudhës së mëparshme (1978-1989) por edhe më të reja. Prologun me temë “Unë nuk u bëra ëgërsirë” e bën vetë poeti.

Ky vëllim poetik tregon se N.Kacalidha nuk është vetëm poeti nostalgjik i vendlindjes së tij, adhuresi i madh i natyrës, por edhe një poet erotik me ndjeshmëri të theksuar.

Këtu dashuria merr dimensione të rëndësishme dhe krijon në jetën e përditshme një vend magjie. Në shumë vjersha është me të vërtetë mahnitëse paraqitja e natyrës. Mbizotërojnë referimet mbi bimët, kafshët, insektet dhe lulet. Të gjitha lëvizin, bërtasin dhe janë tërë jetë:

«Τριανταφυλλένια, καλονιά,
στον κόρφο σου ο ήλιος ζει.
Τρελάθηκαν τα γιασεμιά
και η μεγάλη βλάστηση,
αγαπημένα και χρυσή».

(E hijshme, trëndafilja ime
me diellin thellë në gji.

Ti e ke çmendur gjalberimin

ti i ke çmendur jasemitë,

e dashura, e arta ime.) (“Të thashë një herë, të thashë dy” faqe 23)

Në vjershën e mësipërme por edhe në shumë të tjera, si psh. tek «Μου λένε έχει εμπόδια η αγάπη», “Më thonë se ka pengesa dashuria”, shikojmë ndikimin te poeti të këngës popullore erotike:

«Βουλιούμαι μια, αγάπη μου, να` ρθω γοργά σε σένα.

Μου λεν: στο δρόμο έχει πολλά ποτάμια αφρισμένα». (faqe 33)

(Sa herë unë nisem për tek ty e shtrenjta zemra ime.

Thonë se paska shumë lumenj dhe zënë rrugën time.)

Thotë N. Tenda: «Vargun popullor epirot grek zgjedh Niko Kacalidha për të shprehur «vullnetin». Dëshira erotike është e pashtërshme por gjithmonë e modernizuar. Por dëshira e traditës së sunduar nga burrat».³⁶

Poeti e shfaq veten e tij si Avgjerino (Yll i Mëngjesit) dhe të dashurën e tij si Pula (Plejadë):

«Θα φέγγω σαν Αυγερινός,/

φέγγε μου εσύ σαν Πούλια».(faqe45)

(Më ndrit ti si yll mbrëmje.

Të ndrit unë si yll mëngjesi.)

Tek dashuria buzët ngjajnë si dy gjysmëhëna që bashkëplotësojnë përceptimin e ekzistencës:

«Δυο μισοφέγγαρα τα χείλη/

κι εσύ θαλασσινό κοχύλι.

Και το φιλί σου ένα φεγγάρι/
να κρύβεται στον καβαλάρη».(faqe 59)

(Dy gjysmëhena buzët e tua
dhe ti je nje guackë deti.

Porsi një hënë puthja jote
e fshehur pas çatisë sonte.)

Dashuria bashkon të gjithë elementet e natyrës, në një harmoni të paparë, duke materializuar bashkimin zanafill të njeriut me natyrën:

«Γυμνή και Εύα, που ροβολούσες στο σούρουπο
απ' τα δρομάκια του παραδείσου».(faqe 114)

(“Eva lakuqiqe që zbriste nga buzëmbremja
përmes shtigjeve të parajsës.)

³⁶Νίκος Τέντας, « Ο Ελληνικός λόγος του Νίκου Κατσαλίδα στην βαλκανική ποίηση».(nga arkivi i N.Kacalidhës)

Gjejmë tërthorazi pohime që i pëkasin historisë së njerëzve të parë. Përdor poeti simbole të marra nga Bibla dhe mitologjia e lashtë greke. Referime të këtij lloji në figura antike ose emra e pasurojnë procedimin njohës me kujtimet mitologjike dhe letrare që ngrenë kuptimet e erosit dhe të gëzimit.

Në aspektin e gjuhës ashtu si dhe në vëllimet e mëparshme kombinon tradicionalen me modernen. Shumë here sjell dhe novatorizma:

«Κι έστρωσα το προσκέφαλο να κοιμηθεί/
η αηδόνα, η τρελαηδόνα».(faqe 119)

(Dhe shtrova nënkresën që të flerë
bilbili i marrosur).

Të nënvizojmë se këto poezi nuk ngacmojnë vetëm problemin e dashurisë. Si pretekst elementin erotik poeti shtron dhe shumë çështje ekzistenciale, na shfaq përmes dashurisë një realitet tjetër. Do thotë Spiro Kristo për këtë vëllim poetik:

«Besnik i synimeve krijuese gjuha e Niko Kacalidhës është gjuha e apokalipsit që synon ekzistencën dhe lidhjen erotike misterioze të tyre. I ndërgjegjeshëm për mundësitë poetike të një gjuhe, që lumturisht është për të gjuhë amtare, me mbi 25 shekuj kultivimi poetik, e di mirë se për mbi çdo konceptim ka moralin e saj, kontribuon me moralin e vet në universin etnik poetik».³⁷

³⁷Gazeta, «Ρωμοσύνη», 20 Korrik 1999

5. «Η αμβροσία των βράχων» “Ambrozia e gurit”

U botua Nëntorin e vitit 1997 në Korfuz. Përbëhet nga 190 faqe. Në vend të prologot ka një dedikim kushtuar poetit Nobelist Odissea Eliti: “Le të jetë për Odissenë, që sapo i pëshpërita “Ambrozinë e gurit”, më shtrëngoi ngrohtësisht në krahët e tij”.

Vëllimi është i ndarë në 4 pjesë:

1. Ο Ακάθιστος Ύμνος των βράχων. (Μονόφυλλο)
Hymni Akathist i shkëmbinjve (Njëfletësh)
2. Η Αγία Γραφή της γιαγιάς Όλγας μου. (Δίφυλλο)
Shkrimi i Shenjtë i gjyshe Ollgës time (Dyfletësh)
3. Όρθρος των βράχων. (Τρίφυλλο)
Orthri i Shkëmbinjve (Trifletësh)
4. Ο Γολγοθάς των βράχων. (Τετράφυλλο)

Golgota e shkëmbinjve. (Katërfletësh)

Kryeson një "pasazh gur varri i shkëmbinjve" ku shkëmbinjte paraqiten "të hareshëm, qe ecin në rrugen e zotit, të bukur si perendia, zotërues, qe lindin perenditë" (faqe 11).

Në vazhdim në poezinë "Αρχιαναστεναριό" (Psherëtima), poeti "i hedhur në grushtet e gjyshe-Shtugar, shijon etjen dhe urinë, përpin dhimbjen dhe gjallërohet nga drita qe vjen nga eshtrat e stërgjyshërve dhe "çan erresirën e vargut shkëmbor, të gozhduar në krakura".(faqe 12)

Gjithë përmbledhja është e ndikuar nga himnologjia bizantine. Pjesa e parë na kujton "Hymnin Akathist". Por ndërsa në të kemi të bëjmë me Pershendetjet ndaj Shën Marisë, këtu kemi Përshendetjet ndaj shkëmbinjve. Ndërsa atje kemi Himne tek Shën Maria, këtu kemi Himne ndaj shkëmbinjve.

"Χαίρε, αμνού και ποιμένου Μήτηρ' χαίρε, αυλή λογικών προβάτων." (Ακάθιστος Ύμνος. Στάση Δεύτερη)

" Χαίρε το καράβι των βουνών και των βράχων η πρύμνη." (f. 32)

“Përshëndetje anije e maleve dhe pupa e shkëmbinjve”)

Përfshin në total 39 përshendetje, 39 "Gëzohu" tek objektet shpirtërore dhe jo shpirtërore të vendlindjes së dashur të poetit dhe të gjithë territorit adhures. Përsonifikon shkëmbinjte, u jep frymë dhe bashkëbisedon me gjuhën e tyre të gurtë.

Duke lexuar vargjet shohim përshendetjet herë si himne jete dhe vdekjeje dhe herë si vaje:

"Χαίρε ευλογημένη γη των θεών και χαίρε Περσεφόνη της βλάστησης."

"Χαίρε ο μαύρος θάνατος του νιογέννητου, πάνω στην αντάρα του Χαλασμού." (faqe 25)

“Përshëndetje tokë e bekuar e perëndive dhe gëzohu Persefoni e bimësisë”

“Përshëndetje o vdekje e zezë e të porsalindurit, sipër mjergullës së Shkatërimit”)

" Χαίρε...οι φονεμένοι βράχοι που βγάζουν βοή πρωτάκουστη." (f.46)

“Përshëndetje... o shkëmbinj gjakësorë që nxirni gjëmim të padëgjuar.”)

Vëren dhe meditton Niko Kacalidha mbi shkëmbinjte, në foletë e shqiponjave, hulumton Shtugaren dhe Gurin e Kuq, malet e Dropullit. Këtu kishin fronin e tyre perenditë. Të shënojmë akoma se mbi modelin e Përshendetjeve bizantine Odhisneas Elitis ka kompozuar mjaft vargje të poemës " Aksion Esti" (në kapitullin "To δοξαστικόν"):

"Χαίρε με τα λυτά μαλλιά η χρυσίζοντας τον άνεμο.

Χαίρε με την ωραία λαλιά η δαμάζοντας το δαίμονα.

Χαίρε που καταρτίζεις τα Μηναία των Κήπων.
Χαίρε που αρμόζεις τη ζώνη του Οφιούχου.
Χαίρε η ακριβοσπάθιστη και σεμνή
Χαίρεη προφητικά και δαιδαλική.

(Përshëndetje flokëlëshuarës që erën praron
Përshëndetje zëbukurës që nënshtron demonin

Përshëndetje që përpilon festat Mujore të Kopshteve
Përshëndetje që harmoniyon brezin e Gjarpërushës

Përshëndetje shpatpërsosures dhe dedalikes
Përshëndetje modestes dhe profetikes.)³⁸

³⁸Odiseas Elitis,Poezi,Onufri,Tiranë 2001, faqe 152-153

Kapitulli i dytë "Shkrimi i Shënjtë e gjyshe-Ollgës time", (Dyfletësh) ndahet në 11 pjesë. Është Ungjilli i gjyshe së tij të ditur. Kryeson "Shkrimi i Shënjtë i gjyshe-Ollgës time për ditën e parë të botës pas kataklizmes":

"Η πρώτη μέρα της δημιουργίας του κόσμου, παιδί μου, ήταν όταν το περιστέρι πήρε με το ράμφος την κλάρα της ελιάς από τον καβαλάρη του σπιτιού μας και την πήγε του Νώε για δείγμα, στην Κιβωτό του, πράσινο σήμα της αρχής του κόσμου".(faqe 74)

("Dita e parë e gjenezës së botës, bir, ishte kur pëllumbi mori në sqep degën e ullirit nga kulmi i shtëpisë sonë dhe ia çoi Noes në barkë, shënja e parë e gjelbërimit të botës")

Këtu poeti me një serë figurash letrare të goditura, metaforash dhe alegorish, me mendime herë të hidhura dhe herë vajtuese dhe herë optimiste dhe shpresëdhënëse lufton me fatin e shkruar. Parashtroj një fragment:

"Τότε ήταν που τρυπούσαμε τη σπονδυλική των
δέντρων, να στάξει λίγο αίμα για τα καντήλια μας.

Τότε ήταν που στη μαυρίλα των σταυρωμένων βράχων
διαπερνούσ` η ανταύγεια της γύμνιας του "

(Atëhere zhbironim palcën e drurëve
te pikonte pak gjak për bishtukun tonë.

Atëhere në terrin e shkëmbijve të kryqëzuar
depërtonin refleksionet e lakuriqësisë sonë”)
“Επί ξύλου κρεμάμενου”.

(I kryqëzuari mbi kryq faqe 85))

Kapitulli mbyllet me "Tri britma të tmerrshme në shkëmbinj", "Britmen e parë të trimërisë" të heroit vendas Dhimitri Çavo, "Vajtimin e madh" të kallogresë dropullite dhe "Britmen e tretë për nënën" atdheun kombëtar të poetit.

Kapitulli i tretë "Orthri i shkëmbinjve", përbëhet nga dhjetë poezi. Këtu kemi të bëjmë me një "fjalor" të vogël të përberë nga fjalë të dashura që i gjejmë të shpërndara në të gjitha përmbledhjet e tij:

"Αμβροσία των βράχων
Αγάπη του Απρίλη
Άρης αγαπησιάρης
Αύρα αυτονομίας
Άγγελος ακρίτας" (faqe 122)

(Ambrozia e shkëmbijve
Dashuria e prillit
Ari dashuruar
Puhizë lirie
Engjëlli i kufijve)

Në këtë kapitull jehojnë këmbanat e lutjeve të mengjezit dhe të mbremjes mbi shkëmbinj të shekullorë.

Kapitulli i fundit "Gollgothaja e shkëmbinjve" (Katër fletësh) përfshin 23 poezi në të cilat poeti na zbulon agoninë e tij ekzistencialiste por edhe të bashkëkombasve të tij që jetojnë dhe luftojnë me shkëmbinj të dhe me murlanin e veriut.

Këtu përfshin edhe poemën e tij të madhe "Ky është gjaku im". Përbëhet nga 16 pjesë. Poeti e shkroi në Mars 1997 dhe në formë alegorike dhe metaforike na paraqet ngjarjet e dhimshme të asaj epoke.

Duke e lexuar e ndjen se ndodhesh në një natë biblike, plot me bubullima, gjak, ikje, dhunë dhe revoltë. Kudo erresirë, asgjekundi dritë. Shumë i goditur simbolizmi

me "ulkonjën". E drejtë vërejtha e Jorgo Çatit (edhe ky letrar) në një letër të hapur për poetin se "të kujton ulkonjen e Ismail Kadaresë që ulërinte në shpellën e saj":

"Ξεσχίζει η νύχτα την ελιά του Νώε, λεχώνα λύκαινα, στις ριπές της αποκάλυψης".
(faqe 153)

(Shqyente nata ullirin e Noes, ulkonjë lehone, breshërive apokaliptike)

Rishfaqen nënat shamizeza, motiv i njohur edhe nga përmbledhjet poetike të mëparshme:

"Μουγκρίζ` η νύχτα της κατάπληξης.

Κι οι μαυρομαντιλούσες μας μανάδες

πλένουν μ` αγιονέρι και βασιλικό τους σκοτωμένους".(faqe 157)

(Rënkon nata e ankthit

dhe nënat tona shamizeza

me ujë të bekuar dhe borzilok lajnë të vrarët)

Tani poeti e prezanton veten e vet si Samuel mbi kështjellën e Kugjit:

"Και πίσω, εγώ ο Σαμουήλ, έμεινα εδώ στο Κούγγι.

Φωτιά να βάλω στο μπαρούτι να ραγίς` ο κόσμος".(faqe 162)

(Dhe mbeta vetëm si Samuili, këtu në Kungj.

T'i vë zjarr barotit për shpërthimin e botës)

Tek "Ambrozia e shkembinjve" poeti është njohësi i shquar i mitologjisë, i asaj panhelenike dhe vendase, njeriu i mbrujtur fetarisht dhe i përgatitur nga ana filologjike dhe letrare. Këtu lutja e mengjezit, shënjtërimi, lutja e mbremjes. Këtu edhe Golgotha. Dhe vëren saktësisht Jorgos Vrelis në gazetën "Πρωινά νέα":

"(N.Kacalidha) I krahason vargjet si lutje mengjezi me ritëm përballë figurës së shkembinjve dhe rrezëthemeleve të tyre. E gjallë dhe krijuese fantazia rrenjose në hapësirën e disponimit mistikopatik. Vetja e tij në një prezantim shqyrtimi koshjent dhe subkoshjent në një stil rrëfyes".³⁹

Ndërsa filologu Nikos Ifantis do të theksojë: "Shkembinjte i flasin pavdekesisë së heshtur, zbulohen dhe na flasin me frymë çliruese, me elementet e pasur lirikë të tyre, në vende intime"⁴⁰.

³⁹Gazeta, "Πρωινά νέα" 3 Shtator 1998

⁴⁰Revista, «Ηπειρωτικά γράμματα», Shkurt 2006, faqe 594

6. «Το δάκρυ του κυκλάμινου» “Loti i ciklaminit”

Është një botim i gazetës "Ο παλμός της Λεσινίτσας". ("Pulsi i Leshnicës"). Qarkulloi në vitin 1998. Përbëhet nga 118 faqe të ndara në 4 kapituj. Prologun e bën filologu, patrioti i tij Nikos Ifandis. Pjesa e parë mban titullin "Μικρή μου ιδιαίτερη πατρίδα"(Atdheu im i vogël dhe i veçantë). Është një dedikim dyfaqësh kushtuar atdheut të tij, në prozë. Fjala e tij është e ngarkuar emocionalisht, kthen në lëvdatë çdo gjë që lidhet me vendlindjen e tij. Atje u lind dhe u rrit, mbrojtës dhe këngëtar i saj:

"Στη Λάκα γεννήθηκα κι εγώ και το κυκλάμινο.

Στη Λάκα της Λεσινίτσας.

Άστε με να χαθώ στο δάκρυ του κυκλάμινου".(faqe 12)

(Llaka është vendlindja ime dhe vendlindja

e ciklaminit, Llaka e Leshnicës.

Lërmëni të humbas në lotin e ciklaminit)

“Loti i ciklaminit është pjesa e dytë. Përbëhet nga 34 vjersha. Vendlindja përbën për Kacalidhën njërin nga akset bazë të poezisë së tij.

Këtu me një shprehje epigramatike, me elemente të thjeshta shprehjeje, na jep mendimet e tij përrsa i përket figures së fshatit të tij, bukurive natyrore dhe peisazhit leshniciot:

"Εδώ, τα περιβόλια στις στροφές της ψηλοράχης
σε βγάζουν στα παραθύρια του Γαλαξία.

Εδώ, μπορείς να ριχτείς από δέντρο σε δέντρο,
Απλώς συνηθισμένα, ν' ανάψεις τους αστερισμούς.
Και να κλαδέψεις". ("Κήποι της Λεσινίτσας")

(Këtu kopshtet në kthesat e kulmeve
të nxjerrin në dritaret e Kashtës së Kumtrit.

Këtu, mund të kërcesh nga pema në pemë,
thjesht, natyrshëm për te ndezur asteriset.
Dhe të krasitësh.) ("Kopshtet e Leshnicës" faqe 16)

Shumë poezi i takojnë periudhës së mëparshme dhe janë shkruar nga viti 1984 deri në vitin 1989. Disa prej tyre i gjejmë dhe në vëllimin poetik "Anëdet" që qarkulloi në gjuhën shqipe më 1983.

Mbizotërues është simbolizmi për nostalgjinë "kthehem në vendlindje" në ekuilibër me atë çka përfaqëson tradita për poetin:

"Γύρισα στη γενέτειρα. Και που να το `ξερε τ`αηδόني,
ο παλιός μου φίλος, ο τραγουδιστής της άνοιξης,
πως ψεξ, όλη την νύχτα, εγώ δεν είχα κλείσει μάτι
και το πρωί η μητέρα μου, άθιχτο βρήκε το κρεβάτι".(faqe 22)

(U ktheva në vendlindje. Dhe ku ta dinte bilbili,
miku im i vjetër, këngëtari i pranverës,
se mbremë unë, gjithë natën s' mbylla sytë
dhe në të gdhirë, nëna, paprekur ma gjeti krevatin.)

Ideja bazë së cilës poeti i mëshon përmes vjershave të tij është nevoja e kthimit tek tradita. Gjëndet në shumë poezi mjete shprehëse të huazuara nga kënga popullore. E vëmë re këtë tek poezitë "Kërcimtarët" dhe "Sheshi i valleve" ("Χορευτάδες" dhe "Χοροστάσι"), ku gjallërimi i traditës dhe përhapja e saj bëhet përmes paraqitjes së valltarëve.

Poezia “Tryeza e shenjtë” është nga më të bukurat e vëllimit poetik. Kështu nënkupton folenë e tij tradicionale, identitetin e tij të besës, vazhdimin e brezave. Është një ëndër, një befasi e kujtesës, një optazi:

"Εδώ η Άγια Τράπεζα, προσκυνητάρι
της σιωπής και της βροντής των σταυρωμένων.
Εδώ κούμπισαν οι γονείς σφίγγοντας τα μελίγρια
του αντίδωρου".(faqe 34)

(Këtu Tryeza e Shenjtë, falltore e heshtjes
dhe e bubullimës së të kryqezuarve.
Këtu u mbeshtetën prindërit tanë
duke shtrënguar tëmthat naforës.).

Shumë rëndësi i jepet dhe mikpritjes, një karakteristikë bazë të popullit të tij. Duket qartë tek vjershat ("Μια χούφτα σπίτια" dhe "Πόμολο της πόρτας"),“Një grusht shtëpish” (faqe 20) dhe “Doreza e derës”(faqe57):

"Πέρασε να σε φιλοξενήσουμε τις νύχτες στη
σειρά από σπίτι σε σπίτι κι αν τυχών
μεθύσεις, κανενός δεν το λέμε."

(Kalo këtej të të bujtim netëve
me radhë nëpër shtëpitë tona
dhe në u dehsh askujt s’ ja themi.) (faqe 20)

Pjesa e tretë e vëllimit titullohet “Zërat e vendlindjes sime”. Përbëhet nga 24 pjesë dhe është kompozuar në periudhën e diktaturës komuniste. Filloi ta shkruante në Leshnicë në vitin 1979 dhe e mbaroi më 1989 në Sarandë. Është një poemë e bukur, plot lirizëm, figuracione dhe simbole.

E theksuar është një ndjenjë nostalgjie dhe kthimi tek trashëgimia e historisë dhe tek tradita popullore. Kemi të bëjmë me vargje patriotike të mbushura me nostalgji, me kujtime të fëmijërisë dhe të adoleshencës, eksperiencë fshatare plot me dashuri për vendlindjen. Këtu flasin të gjitha, të gjallë e të vdekur, qëniet frymore dhe jo frymore në një lidhje organike të pandarë. Të gjitha bërtasin për atdheun e vogël të poetit që në sytë e tij merr përmasa shumë të mëdha.

Zërat e vendlindjes janë gurët, zogjtë, amarandusi dhe ciklamini, gjyshja e tij dhe plakati e tjera të fshatit, babai i tij mendimtar që mbledh fjalë të urta popullore:

"Πρωγιά και βράδια ο μπαμπάς, πάνω στα ημερήσια.
Και πάνω στο τραπέζι του "Ιλιάδα" και "Οδύσσεια".

Στην τσάντα του αν θα` ψαχνες, χαρτιά και κιμωλίες,
Θρύλους και λιανοτράγουδα, μολύβια, παροιμίες".(faqe 44)

(Mëngjeseve dhe mbrëmjeve babai mbi ditare.
Me Iliaden në tryezë, Odisenë pranë dritares.

Çanta e tij mbushur plot me shkumësa e letra,
me këngë edhe lapësa, proverba dhe legjenda.)

Origjinën e tij poeti nuk e tellalis si një ndjenjë të një detyrimi të thjeshtë:

"Το χόμα της καταγωγής στο κόρφο μου κρατούσα.
Μ` έτρωγε ο σπάρτος μέσα μου κι όλο το κόρφο ξιούσα.

"Θα μάθεις μου` λεγ` η γιαγιά, ας τρώει δεν πειράζει.
Ποιος δεν ξεχνάει το χόμα του, πότε του δε γεράζει".(faqe 52)

(Një grusht dhe brënda në gji e ruaja unë biri.
Dhe nga gjineshtra kruhesha, sepse më hante gjiri.

"Pa ke për të mësuar bir, pa hiç, mos ki gajle.
Vendin kush nuk e harron nuk do të plaket fare.)

Adhurimi i atdheut përhapet dhe merr përmasa të mëdha. Bëhet e paaritshme. Vendlindja e magjeps poetin. Ai bëhet një me vendin e tij. Me zemër të pastër shikon dritën natyrore dhe mbinatyrore të shndrisë nëpër shkëmbinjte, në tempujt dhe në kishat e vjetra. Përmes vargjeve të tij na sjell gëzimet dhe vuajtjet e vëndit të tij.

Pjesa e fundit e vëllimit ka titullin "Baladë e përzishme". Është një poemë kushtuar humbjes së gjyshes së tij të dashur. Edhe ajo përbëhet nga 24 pjesë dhe është e kompozuar në vargje lirike të lira. E shkruajti në Maj 1993.

Një poemë me strukturë poetike të rrallë ku mbizotërues është një ton emocional dhe një ndjenjë filozofike. E dukshme është dhe një notë nostalgjike që lidhet me largimin e figures së dashur. Me pretextin e vdekjes së gjyshes bëhet një

kalim i shkurtër i gjithë jetës së saj. Në formën e përjetimit arrin deri në vitet lumturuese të moshës fëminore.

Tregimi përshkohet nga një bosht intelektual bazë dhe nga boshte të tjera që pleksen dhe krijojnë në këtë mënyrë polisemantikën e mesazhit poetik duke i dhënë lexuesit mundesinë e leximit të shumëthjeshte dhe në shumë nivele të poezisë.

Nuk do të jetë më ajo që i tregonte si përrallë të vjetrat, që i thoshte historinë e jetës së saj dhe bashkë me të dhe historinë e popullit të tij. Ishte ajo që i mësoi poetit legjendat, mitet dhe profecitë e Shën Kozmait. Ishte ajo që e mbulonte netët e ftohta, që i bënte kafen dhe e nxirte deri tek kthesa e rrugës kur kishte udhëtime të gjata. Vargje zie të mbushura me nostalgji dhe dashuri:

"Τώρα η γιαγιά -Όλγα έδωσε τέρμα στους μύθους και
στ' Άγιο- Κοσμά τις προφητείες.
Κι άξαφνα ένα πρωί μας έκαμε πιο φτωχούς και μας
Στένεψ' η κορφή με τ' άδειο στρώμα.

Kai maúrise to kóutssouro sto tζάκι μας".

(Tani gjyshja Ollga mbaroi mitet
dhe profecive të Shen Kozmait.

Dhe befasisht një mëngjes na iku
dhe ngushtoi shtrojen në krye të vatrës.

Dhe u nxi trungu në oxhakun tonë.) (faqe 102)

Poeti vë në dukje virtytet e gjyshes së vdekur. E fantazon si ëngjëll që kalon netëve nga shtëpia e tij sepse:

"Τέτοιες γιαγιές σαν νύφες στολισμένες, ψέματα,
ψέματα δεν πάνε στα κοιμητήρια.

Τέτοιες γιαγιές, σας λέω, δεν είναι για κοιμητήρια.

Τέτοιες γιαγιές σαν νύφες στολισμένες, είναι για τις βιτρίνες".

(Gjyshe të tilla si nuse të stolisura,
s' është e vërtetë, nuk janë për në varreza.

Gjyshe të tilla, pra, s' janë për në varreza.

Gjyshe të tilla si nuse të stolisura janë për vitrina.) (Faqe 116)

Në qendër gjëndet figura e gjyshes së tij, por në të vërtetë poeti na zbulon shpirtin dhe mendimet e tij. Mjetet shprehëse më të shpeshta që përdor poeti janë metaforat, krahasimet, antitezat e shumta si dhe funksionimi simbolik i gjuhës.

Jorgos Vrelis thekson për këtë vëllim poetik:

" Dëshira e tij e zjarrte dhe mendimi i tij vigjilent dhe funksional, në altarin e dhimbjeve të tij. Atje flasin të gjitha, qeniet frymore dhe jo frymore, të gjitha në një unitet organik, të gjitha për atdheun e tij të vogël, Leshnicen, të cilën e lartëson me vargje poetike dhe me kenge»⁴¹.

⁴¹Gazeta, «Πρωινά νέα», 3 Shtator 1998

7. «Η πύλη των βοριάδων»

“Dera e murlanit”

Qarkulloi në vitin 1998 nga shtëpia botuese “Qiriaqidhis” dhe përbëhet nga 96 faqe. Në qendër të veprës gjëndet shtëpia atësore e poetit. Është e mbushur me metafora, simbole, forma epike, krahasime dhe personifikime. Mbrenda shtëpisë së tij fillojnë histori paralele të prindërve, fëmijëve dhe të afërme. Atje gjënden kujtime të vogëlisë, fëmijërisë, rinisë. Atje e kanë folenë gëzimet dhe haretë, hallet dhe vuajtjet: «Σπίτι των ποιητών και των Θεών και των βουνών και των ανέμων. Σπίτι μου! Πατρικό μου σπίτι, μαζί σου είν' όλοι οι ζωντανοί κι είν' όλοι οι πεθαμένοι». (faqe 4)

(Shtëpia e poetëve, e perëndive, e maleve, e erërave. Shtëpia ime! Shtëpia ime atërore, pranë teje janë të vdekurit, pranë teje dhe të gjallët.)

Metrika, stili është i njëjtë me ato të vëllimeve të mëparshme. Rikthehet tek motivet dhe tematikat e njëjta. Disa vargje kanë një ngjyrim metafizik:

«Γυμνοί στη ζωή και το θάνατο, γυμνοί και στη θυσία
Γυμνοί κι επί ποδός βαδίζουμε για την αθανασία». (faqe 9)

(Lakuriq të gjallë, lakuriq të vdekur, lakuriq në flijime.

Lakuriq dhe në këmbë, duke ecur drejt pavdekësisë).

Do të thotë tek vjersha “pema e dhimbjes”:

«Θέλω να την πετάξω απόψε αυτή την ανθοδέσμη
και να σας πω ότι ο τόπος δεν είναι ρόδινος.

Κι απ' το μεράκι πάνω στην ελιά εδάκρυσ' ένα αστέρι.
Δεν ήταν δάκρυ, μάνα μου, ήτανε αίμα π' όσταξε
Πάνω στα χιόνια κι έγινε δέντρο πόνου».

(Dua ta flak sonte këtë buqetë
dhe t'ju them se s' qenka shesh me lule.
Dhe nga meraku lotoi ylli mbi ullirin.
Nuk ishte lot, moj nënë, gjaku pikonte
mbi dëborë dhe u bë druri i dhimbjes.)(faqe 48)
I pranishëm është dhe këtu elementi dhe besimi fetar:
“Cilën ditë do më çojnë në Golgota dhe në Ngjalljen?”, ose:
“E ndizja qiririn dhe kandilin në eikonostas”. (faqe 53)
Tek ky vëllim i këndon dhe dashurisë më shumë se tek vëllimet e tij të tjera:
«Ποια η καμάρα της αγάπης; Ποια η πηγή του φιλιού;
Ποια η βρύση της γλύκας; Αφίλητο κορίτσι των βουνών μου».

(Cila qe dhoma e dashurisë? Cila gurra e puthjes?
Cili burimi i ëmbëlsisë? Çupe e paputhur e maleve.) (faqe 58)
Mban lidhje të forta me traditën, futet thellë në rrënjët e vendit të tij. Na lutet që ta
besojmë se çdo gjë që na thotë është e vërtetë:

«Πιστέψτε τον ποιητή, δεν σας γελάει ο ποιητής.
Βάλτε το χέρι στην καρδιά του και θα τρομάξετε
απ' τους σπασμωδικούς χτύπους».(faqe 24)

(Besojeni poetin, nuk ju genjen poeti.
Vini dorën në zemrën e tij dhe do të tmeroheni
nga rrahjet e çuditshme.) (“Besojeni poetin”)
Mbizotërues është një romantizëm i mbushur me humanitet. Na paraqitet bukolist dhe
adhurues i natyrës. Tek vjersha “Sonte zoti im është Pana” do na shfaqë mendimet dhe
botën e tij të mbrëndshme:

«Απόψε λατρεύω τις κλάρες που χειροκροτούν στον αγέρα
και λεν τη μονωδία της πίστης μου.
Απόψε, λατρεύω τα ουρλιαχτά της θύελλας και της βροντής.
Απόψε, σηκώνω μπαϊράκι παλικάριάς στα ψηλαλώνια

της αστραπής των δέντρων.

Απόψε , κι ο Πάνας έβαλε το κλαρίνο στ' αυτί μου
και βάρωσε μοιρολόι ηπειρωτικό». (faqe 32)

(Sonte adhuroj degët që duartrokasin erës
duke treguar monodinë e besimit tim.

Sonte, adhuroj ulërimat e detit dhe bubullimes.

Sonte ngrita flamurin e trimërisë në lemejtë
e vetëtimës së drurëve.

Sonte dhe Pana nguli klarinetën në veshin tim
dhe një vaji epirot ia nisi.)

N. Tentas thekson: «Duke patur për hajmali kujtesën trajton durimin e skajshëm njerëzor me fjalë të përrallshme. Vaji epirotas shpreh bioma kolektive me simbole greke në një prizëm diakronik ballkanik»⁴².

Jorgos Vrelis do të shkruajë për këte vellim: «Lëviz midis hiperbolave, të meditimit filozofik dhe realitetit, me fantazinë flatrahapur drejt qe idealeve dhe idoleve. Psikika dhe ndjeshmëria ecin bashkë. Strofat nga të cilat vjelim fryte pedagogjike dhe didaktike do ti karakterizonim se petale lulesh aromatike të shpirtit dhe të zemrës».⁴³

⁴²Νίκος Τέντας, « Ο Ελληνικός λόγος του Νίκου Κατσαλίδα στην βαλκανική ποίηση».(nga arkivi i N.Kacalidhës)

⁴³Gazeta, «Πρωινά νέα»,3 Shtator 1998

8. «Χίλια κοχύλια» “Një mijë guacka deti”

Deti u bë prozë me penën e prozatorëve, por edhe këngë në sajë të ndjeshmerisë së poetit. Pafundësia e tij të emocionon dhe të ndjell. O botua nga Enti Kombëtar i Pritjes dhe i Rehabilitimit të Grekëve Homogjenë në shkurt 1999.

Përmban 134 faqe. Librin e prologon vetë poeti.

Kopertina dhe pikturat-pejsazhe deti janë të piktorit të njohur Jorgos Mitsis.

Përzgjedhjen e teksteve e ka bërë Nikos Ifantis.

Përmban gjashtë unitete:

1.Unë jam pulëbardha e veriut.

2.Tatuazhi i Poseidonit.

3.Statuja të shkëmbinjve

4.Batica.

5.Vetëvrasja e detit.

6.Shërbesa në kepin e Shegës

Në këtë vëllim tematika e tij është deti.

Kontaktet e poetit të lartësive me detin fillojnë në kohën që poeti ishte profesor i letërsisë në qytetin bregdetar të Sarandës. Kundron detin dhe mbetet i mahnitur nga bëmat dhe bukuritë e tij. Deti i shtruar dhe me ngjyrën blu të thellë e josh poetin.

Vëllimi është plot me pejsazhe të bukura detare që deklarojnë në këtë mënyrë disponimin psikik të poetit. Hymnizon detin, këtë perëndi të patretshme, peshkon të fshehtat e tij, bashkëbisedon me të. E prezanton veten herë si «pulëbardhë të veriut»(faqe 19) dhe herë si Odisse. Nga simbolika e detit vijnë simbolet mitologjike që lidhen me detin: Poseidoni, Aferdita, Odiseu, Sirenat etj.

I pelqen të opërojë me antitezat:

«Εγώ είμαι ειρηνόφιλος σαν θάλασσα/
και θηριώδες σαν τη θάλασσα».(faqe 35)

(Unë jam paqësor si deti
dhe i egër si deti).

Deti e mbush poetin me romantizëm. Siç e kemi theksuar edhe më lart Niko Kacalidha është natyrë romantike. Mesazhet që ai na përcjell nëpërmjet «deponimeve» të tij poetike janë të shumta dhe shpresëdhënëse. Leviz i motivuar në hullinë e një shpirti panteist dhe mbrujt çdo gjë që leviz në orbitën e tij me agoninë e vet në menyrë që të qartësohet në thellësinë substancës së mendimit. Shpesh herë toni i tij merr përmasa individuale. Ketë gjë e shohim konkretisht në një poezi që ia kushton të birit.

Vëllimi mbyllet me një poezi të shkruar, siç thotë vetë poeti, me 1972, në një periudhë që sistemi komunist kishte ndaluar përdorimin e emrave orthodhoksë. Mban titullin «Credo». Ketë poezi e gjejmë edhe në botimin e shkruar në gjuhën shqipe «Profecite e druve». Është botuar bashkë me një cikël poetik në gazetën “Zeri i Rinisë” me 1972.

Jorgos Vrelis do të shkruajë për këtë vëllim:

« Poezia e N.Kacalidhës është substanciale, e ngopur, me mesazhe deti dritëlënëse. Në aksionin e vet poetik vihet re një prirje epike, burrërore dhe parashtrimi të besueshëm. I thekson strofat me elegancë dhe bëhet fjalë për strofa – këngë, pasi poeti i njeh mirë sekretet e metaforës gjuhësore poetike. Poezia e tij është shumë njerëzore, poezi ekzaltuese, lartësuese dhe fluturuese, me një theks të vetin, në një klimë të veten gjurmimi dhe parashtrimi shprehës»⁴⁴

⁴⁴ Revista, «Η έρευνα», 20 Nëntor 2000

9. Η ΠΡΩΠΑ ΤΩΝ ΑΣΤΡΩΝ “BASHI I YJEVE”

Përbëhet nga 128 faqe. U botua me 2000 nga Botimet Ιανός (Ianos) në Selanik. Është një fragment i ngjeshur përjetimesh dhe kujtimesh personale. Sintezën shumëplanesh të këtij vëllimi e përshkon një hymn thellësisht i ndjeshëm për gjërat konkrete dhe abstrakte duke mbuluar një spektër të gjerë të dimensionit shumëplanesh social të vendit të vet. Në krye të vëllimit radhitet nga poeti poezia «Damari i Apokalipsit». Poeti shkruan:

“Një damar i Apokalipsit në shpellën tonë hyjnore të Leshnicës shpërtheu. Dhe i sherruam të gjitha plagët tona me burime ujrash të kristalta dhe me garza të deborës së pastër të një murlani. Me pëllumba të ullirit dhe zë pavdekësisë. Dhe këtu nëse ndodh që të humbas në manastirin tim verior, unë mermer kam për të gdhirë.” (faqe 3)

Vijojnë poezi të shkruara me dorën e tij, të ndara në dy unitete: «Bashi i Yjeve» dhe «Mbremja e Lulenatës».

Poeti kur izolohet në «manastirin» e vet si heremit, çmitizon ngjarje dhe «marton» ëndrrat me realitetin. Niset nga përjetimi individual dhe i pjesshëm, nga shtëpia e vet dhe nga fshati i harruar, për të levizur në fusha më të gjëra dhe më aktive duke shprehur me emocion të veçantë dhimbjen personale dhe duke përjetuar edhe dhimbjen e bashkëkohësve.

Nikos Ifantis beson se në këtë vëllim N. Kacalidha: «Rreket të çlirohet nga pesha e së kaluarës që e stërmundon, të zbulojë forma të reja shprehëse, të distancohet nga idealizmat dhe paragjykimet, të hapër rrugë të reja dhe të ecë në një sektor optik të ndryshëm, të çliruar dhe të paangazhuar. Theksimi i se kaluarës dhe i së sotmes me përqsasjen e saj në kohë dhe në terren, me zhytjen e tij në kujtime, në korelacione mendimi dhe fantazie, ndriçojnë dhe përkufizojnë kronologjikisht kontributin e ri poetik»⁴⁵

«Κανένας δε μας άκουγε. Και τρώγαμε τα σκώτια μας.

Κανένας δεν μας άκουγε. Και σχίζανε κι οι πέτρες μας». (faqe 14)

(Askush nuk na dëgjonte. Dhe brenim mëlçinë tonë.

Askush nuk na dëgjonte. Dhe kriste guri ynë.)

⁴⁵Νίκος Υφαντής, «Προλογος για το έργο: «Η πρόρα των άστρων», (nga arkivi i N.Kacalidhës)

Gjurmimi historisë, pozicioni i poetit dhe destinacioni i tij në ambjentin social përbëjnë unitetin tematik të vëllimit. Miti antik, perenditë greke janë mjetet shpjeguese për të kuptuar brendinë e poezisë së Kacalidhës.

Zeusi, Kronos, Sizifi, Babilona, Pirgu i Babelit, Dionisi, Herakliti janë figurat mitike me të cilat rindeshemi në këtë vëllim, brenda të cilit dallohet edhe ndjenja fetare:

«Κι η Παναγιά η Παρθένα που παγώνει. Και σφίγγει τον Ιησού στην αγκαλιά των γιασεμιών, στον κόρφο της υπομονής». («Στα ερημοκλήσια οι ασκητές», (Asketet në kishat heremite) faqe 16)

(Dhe Shën Mëria e virgjër e mbërdhirë.

Duke shtrënguar Krishtin në prehërin e jaseminit dhe në gjirin e durimit.)

Krishti, shënjtoret, Shën Maria, martirë dhe asketë në kishat e braktisura, gjenden kudo, «dhe vetëm shënjtit tek ndezin kandilen në shalën e Yjesisë» (faqe 17). Elementet romantikë i ndeshim të shpërndara në të gjithë vëllimin. Poeti prezantohet plot ndjeshmëri:

«Τη νύχτα του Αυγερινού, τι μο` παθες κυκλάμινο;
Δροσοσταλιά. Και πέρασε. Τι με κοιτάζεις κλάμενο;»
(Νύχτα του Αυγερινού, (Nata e Yllit të Mëngjesit) faqe 38)

(Mes netëve të yjeve, ç'fare pate ciklamin?

Vesë ishte edhe shkoi, lotuar pse vështron?

Në këtë vëllim Kacalidha është një natyralist autentik:

«Να πας εκεί να κοιμηθείς κι εσύ. Να τρελαθείς στα στρώματα της λυγαριάς. Στην αγκαλιά των βοτσάλων σαν λαγαρίζουν τα νερά!» («Ν' ακούς μπαλτάδες στο βοριά!» faqe 30)

(Atje të shkosh të flësh. Të çmëndesh shtrojeve të shelgjeve. Në prehërin e guackave, në refleksionet e ujrave.)

Poeti në këtë vëllim shpreh me të gjithë forcën e artit dashurinë e vet për rrënjët e origjinës. Leshnicës se vet të dashur i kushton shumë poezi. Nëpërmjet tyre u rikthehet motiveve të njohura të cilat i kemi ndeshur në vëllime të kaluara, siç është ai i çrrenjosjes dhe i mërgimit, i braktisjes së vendlindjes etj.

Një nga poezitë më emocionuese është «Dhe ra mortja»:

«... Κι έπεσε το θανατικό στην κάψω Λεσινίτσα
Και τα νερά αντίστροφα συμμάζευαν οι βρύσες.
Μαυρολογούν οι ρούγες της, μουντές, χορταριασμένες.
Καμπουριασμένες οι γριές, τρεμουλιαστές αντάρες.
Με το ραβδί της προσμονής, στις ράχες ριζωμένες.» (faqe 47)

(...Dhe mortja ra në Leshnicën time të shkretë.

Dhe ujrat mblidhnin përsëri nga udha burimet.

Udhët ligjërojne, të shkreta, barmbuluar.

10. Η ΜΟΙΠΑ ΤΟΥ ΑΜΑΡΑΝΤΟΥ “FATI I AMARANDUSIT”

Eshte nje antologji e zgjedhur e poezise se Niko Kacalidhes. U botua nga shtepia botuese “Ianos” te Selanikut me sponsorizimin fisnik te Ministrise se Arsimit dhe te Kulturës se Qipros. Kopertinën e librit e punoi i biri, Aris Kacalidhas.

Në këtë antologji bashkon të gjitha poezitë e të gjitha vëllimeve të kaluara që zënë 365 faqe. Eshtë një pasqyrim sinoptik e veprës së tij, një botim i plotë i përbërë nga 14 unitete me nëntitujt:

1. Η πλώρα των άστρων (Bashi i Yjeve)
2. Η νυχτωδία του νυχτολούλουδου (Mbremja e lulenatës)
3. Το μοιρολόι του βουρκαωμένου βουνού. (Vaji i malit te vrejtur)
4. Τα λιόκλαδα του Κλήδονα (Degët e ullirit të Klidhonit)
5. ... Τα πικρολέμονα (Limonet e hidhur)
6. Το δάκρυ του κυκλάμινου. (Loti i ciklaminit)
7. Η αμβροσία των βράχων (Ambrozia e gurit)
8. Η Αγία γραφή της γιαγιά-Όλγας μου. (Shkrimi i shenjte i gjyshe-Ollges time)
9. Χίλια κοχύλια (Njëmijë guacka)
10. Η σφίγγα μίλησε. (Dhe Sfinksi foli)
11. Η φόρμιγγα του φεγγαριού. (Forminga e hënës)
12. Ο τρούλος του κόσμου. (Harku i botës)
13. Τα εκατό εκατόφυλλα της Πούλιας. (Njëqint trëndafilat)
14. Επί της Επικράτειας. (Poezi gjatë kohës që ishte ministër)

Bën një shkurtim të brendisë me përzgjedhje. Që nga vëllimi i tij i parë poetik deri në të fundit shënon një angazhim permanent me çështjet intelektuale të kohës.

Me këtë botim Niko Kacalidha fuqizon prezencën e vet poetike duke kërkuar një dëshmim objektiv të kontributit të vet. Titulli i paraqitet lexuesit në mënyrë të drejtpërdrejtë. Do që të flasë për një periudhë kohore konkrete, të kaluarën e afërt dhe të tashmen. Ka aftësinë e përjetimit të epokës së vet, ta shprehë me fjalë dhe të shprehet nëpërmjet saj.

Përderisa u jemi referuar analitikisht në vëllimet e kaluara, për vëllimet që perfshihen këtu nuk do të ndalemi gjatë. Ndërkohë, duhet thënë se këtu ndeshim edhe

poezi të cilat nuk i kemi ndashur më parë. Janë shkruar kur poeti ishte emëruar Minister Shteti më 2001. Duke i studjuar me vëmëndje këto poezi lexuesi do të dallojë një nostalgji të theksuar për atdheun e tij të veçantë:

«Μου` παν πως τώρα στένεψαν στη Λεσινίτσα τα δρομάκια.

Και τα κυκλάμινα σκεπάσαν οι τσουκνίδες.

Μου` πανε πως λιγότερο νερό πηγάζει απ` τις βρύσες.

Κι η μυτωσιά βαδίζει στα περβόλια μοναχή της». (faqe 350)

(Më thanë se u zunë udhët e Leshnicës.

Dhe hithrat kanë mbuluar ciklaminet.

Më thanë se u pakësua uji në burime.

Dhe bari në kopshte ecën me vetminë e tij.)

Anna Dereka në artikullin e saj me titull “Kanavaca që qëndis kujtime „ thekson: «Fati i Amaranusit (Lules se Pavdekshme)» është një libër me poezi brënda të cilit jeta bombardohet në mënyre ciklike, jetën siç na e bënë, jeta që u mbush me frikë dhe vetmi, një jetë që nuk ka veç gra të veshura me të zeza dhe njerëz të marrë që ëndërrojnë një jetë tjetër. Një jetë e mbushur plot fantazma, e një botë tjetër që do të vijë nesër, pasneser, e një bote të cilën e jetuam veç kur ishim femije».⁴⁶

Jorgos Vrelis do të shkruajë për përmbledhjen: «I pashtershëm në vjelje, mbrujtje, lirizëm, romantizëm, nostalgji, vërshim realist, tone të tendosura ndjeshmërie, bashkësi e zbukuruar me mbrujtje gjuhësore, me theks shkëlqimtar dhe shprehje gufuese. Na formulon endoskopinë, adhurimin e natyrës, kujtime dhe nostalgji, motive familjare, prirje elegjake, kërkime ekzaltuese dhe metafizike. Në vendlindjen e tij në Leshnicë ribëhet fëmijë, me entuziazëm dhe shkëlqim, me synime dhe ëndrra, nën ritme muzikore. Bashkon kryesisht fantazinë me realitetin në një varg solid».⁴⁷

⁴⁶Revista, «Νέοι αγώνες της Ηπείρου», 8 Qershor 2004

⁴⁷Gazeta, «Πρωινά Νέα», 22 Janar 2004

3.2.3 VEPRAT NË PROZË TË NIKO KACALIDHËS

1. Το άροτρο του φεγγαριού.

Parmënda e Hënës

«Parmënda e Hënës» është një roman modern i Kacalidhës. U botua në maj 2004 dhe u ribotua në qershor të të njëjtit vit nga botimet «Ψυχογιός» dhe përbëhet nga 295 faqe.

Me këtë roman Niko Kacalidha, i pajisur denjësisht me mjetet e një shkrimtari modern u përpoq të lëvizë akrobatikisht në një mënyrë të re shprehëse.

Romani përshkruan një histori homerike të epokës moderne me sfond një qytet fantastik, në një limit kohe që lidh në unitet të djeshmën me të sotmen. Një Odisse moderne shprehet jo në formën e eposit por si një roman modern mbresëlenës. Odisseu i kohëve moderne largohet nga atdheu i tij, duke i lënë të afërmit e tij pas telave me gjëmba, me shpresën që dikur të rrëzohen muret e ndarjes, të ndalohet dhuna, të rifitojnë përsëri zërin e tyre malet e braktisura. U end për kaq vite Odisseu i arratisur, larg dheut të vendlindjes, pa shumë vende dhe njerëz të ndryshëm, dëgjoi shumë gjëra dhe bisedoi me shumë njerëz. Por mëndja e tij nuk u shkul nga atdheu i vet. Nga shtëpia atërore. Nga Penelopa dhe Telemaku. Njerëzit janë ndarë nga ata që janë përtej dhe këtej kufirit. Gratë të përzhitura nga vdekja e konsiderojnë natyrale ta quajnë njëra-tjetrën «moj e zezë», «e shkreta Leni», «e zeza Vasillo». Ekzistojnë edhe amerikankat, të ndara për së gjalli që presin paratë e hidhura të mërgimit për të ndërtuar shtëpitë e tyre, për të martuar fëmijët e tyre. Gratë e pritjes së pambarimtë që vyshken së prituri. Gra që u rezistojnë fort vuajtjeve të jetës, gra lapidare, gra modele, nën emra mbresëlenëse si Qirana.

Penelopa hedh mbi shpinë djalin e vetëm të vrarë për ta varrosur në varrin bosh e të pambuluar të të atit. Vdekja është prezente kudo. Vdekja u bën zbritje çmimit të sapovdekurve që janë aq shumë dhe që nuk disponojnë as paranë e nevojshme për ti çuar matanë, në bregun tjetër. Vdekje e pangopur por edhe shpirtdhembur.

Odisseu, i stërmunduar arrin në shtëpinë atërore që «nga një fije varrej nga buza e greminës».

«Shtyva porten e ballkonit. Llozet e ndryshkura mjaullinë si macet. E tunda përsëri. Ulëriu. U hap. U përkula. E putha. E riputha. Mbaja kangjellat. Mbajta frymën. U futa brenda ...». Protagonistët e Odissesë fitojnë karakteristika të reja dhe simbolika të reja, mendimet dhe veprimet e tyre mbartin tragjizmin e heronjve homerikë sinonime.

Kthimi i Odiseut sinjalizon kohët e reja që pritet të vijnë në këto dherra që i plugon parmenda e hënës në formën e një kryqi madhështor që i përmbys të gjitha. Fundi i tij shumë optimist dhe shpresëdhënës.

Nëpërmjet ecurisë dhe meditimit të vizitorit shekullor prezantohet jeta me të gjithë madhështinë dhe antitezat e saj, shprehet zemërata dhe dashuria.

Lumenjtë, shkëmbinjtë dhe malet marrin jetë, shndërrohen në simbole, duke e kthyer historinë në mit dhe mitin në histori. Niko Kacalidha si poet që është i ofron veprës së vet frymë poetike. Të gjitha temat që i ndeshëm në poezitë e tij i ndeshim edhe këtu. Bile do të ndeshim edhe vargje të plota, si në rastin e vargjeve nga vepra poetike «Vaji i malit të vrejtur».

Gjuha e romanit e përkryer, e ngarkuar me idiomat leshiniciote. (psh fjala «μότρημα» (motërzë) dhe të tjera që i takojmë me bollëk në këtë veprë:

«Τι λες μω` ‘Ολγα μου; Για μένα τα` φερες; Νηστική θα μείνεις εσύ σήμερα; Εσύ θα τσαπίσεις. Να σε έχει καλά ο Θεός, μωρή μότρημα!».

«Ç’thua moj Ollgë? Për mua i solle? Pa ngrënë do të mbetesh ti sot? To do të lërosh. Të të ketë shëndosh zoti, moj motërzë!»

« Τα` φερα για σένα, Λένη. Κι αν δεν σ` έβρισκα θα σο` κρενα. Να` μαστε καλά μωρέ μότρημα...»).

«I solla për ty, Leni. Dhe nëse nuk do të të gjeja do të të thërisja. Të jemi mirë, moj motërzë ...»).

Thekson Mina Leka: «Ky roman, pra, i strukturuar mbi një formë të re ku plekset fjala poetike me atë prozaike, ëndrra me realitetin, historia me mitin, është edhe një arritje tjetër e letërsisë sonë, një prezantim tjetër në rrethet me të gjera të lexuesve të Greqisë të aftësive tona krijuese».⁴⁸

⁴⁸Gazeta, «Λαϊκό Βήμα» 15 Dhjetor 2004

2. Νύχτας ανομήματα Mëkatet e natës

Niko Kacalidha, përveç veprës së vet poetike dhe romanit «Parmënda e Hënës» iu kushtua dhe tregimit. Kohët e fundit punoi mbi përmbledhjen me tregime «Mëkatet e natës» që u vu në qarkullim nga shtëpia botuese «Kédpoç» më 2006. Përbëhet nga 375 faqe.

Janë histori të fitimtarëve dhe humbësve mëndjelehtë dhe të marrë në betejën e jetës, të njerëzve që dyluftojnë me përbindëshat e jetës dhe që bashkëbisedojnë me përbindëshat e natyrës. Bëhet fjalë për tregime poetike të gdhëndura në stilin e realizmit magjik. Një mozaik njerëzish dhe ngjarjesh me sfond malet e rënda të atdheut të vet. Tregime të kujtesës personale dhe kolektive në kryqëzimet e mitit me historinë. Pejzazhe nga një realitet i ashpër dhe paralelisht ëndërrimtarë që e stamposin në thelb fatin e një vendi. Motivet bazë edhe këtu nuk ndryshojnë. Të vdekurit dhe të gjallët, ëndërrat, mitet e antikitetit dhe simbolet autentike vazhdojnë ta frymëzojnë.

4. PËRKTHIMET E NIKO KACALIDHËS NË GJUHËN SHQIPE DHE GREKE

Njerëzit e letrave të Minoritetit Etnik Grek përveç poezisë dhe prozës janë marrë edhe me përkthime. Dhe Niko Kacalidha është një përkthyes i spikatur në të dy gjuhët, në greqisht dhe në shqip. Kjo parashtesë e shkurtër nuk synon të vlersojë përkthimet e Niko Kacalidhës, të cilat zënë me të drejtë një vend kreu në letrat shqipe, por të na jap dhe dimensionin tjetër të krijuesit.

Gjuha e tij amtare është greqishtja, të cilën e zotëron shkëlqyeshëm edhe pse nuk ka bërë studime speciale. Niko Kacalidha ka mbaruar studimet e larta në gjuhën shqipe, të cilën e njeh shkëlqyeshëm.

Në shqip përkthen O. Elitisin, T. Varvitsiotin, Gatsion, Egonopullon, Ritson, si edhe poetët qipriotë K. Montis, K. Krisanthi, S. Llazaru Maleski, R. Ioanidhu Stavru.

(Odiseas Elitis “Poezi” Onufri 2001

Kostas Mondis “Buzëmbërmbja e vrarë”, Mësonjëtorja, 2003

Taqis Varviciotis “Heshtja e hënës” Mësonjëtorja, 2003

Jorgos Moleskis “Sterna e dashurisë”, Neraida, 2003

Rula Ioanidhu-Stavru “Kordele të verdha” Neraida, 2003

Jorgos Samarxidhis “Nimfa”, Toena, 2003

Sofoklis Llazaru “Orë zemërimi”, Neraida, 2004

Petros Stranis “Të (shpër)ndara”, Toena, 2004

Jorgji Aleksi “Logjika e shqisë së gjashtë”, Neraida, 2004)

Qipros Krisanthis “Jasemini”, Neraida, 2006

Janis Kondos “Atleti i absurdit”, Toena, 2006

Dionisis Kapsalis “Topografite” Toena, 2006

Haris Vlavianos “Pas fundit të bukurisë”, Toena, 2006

Janis Kondos “Eshtrat”, Ombra GVG, 2007

Dhimitris Nollas “Xhama të errët”, Toena, 2007

Tios Patrikios “Stacione të ndërmjeme”, Toena, 2007

Mihalis Ganas “Shiu i zbathur”, Toena, 2008)

Me përkthimet në shqip hapet një rrugë e re komunikimi. Veprat japin një panoramë të fjalës greke dhe qipriote dhe hapin rrugën e komunikimit midis popujve.

Me përkthimin e «Αξιον Εστι»(Aksion Esti) të Elitis më 2001 i jepet medalja «Penda e Argjendte» nga Ministria e Kulturës e Shqipërisë për përkthimin më të mirë të vitit. Komisioni gjykoj se N. Kacalidha ia doli mbanë të zbulojë një gjuhë poetike që i përshtatet plotësisht perceptimeve mendore dhe simbolikës ëndërrimtare të Elitisit dhe e plotëson tekstin me elemente që kontribuojnë në kuptimin e tij.

Niko Kacalidha e njeh mirë edhe Greqinë edhe Qipron, psikosintezën e vetë poetëve të tyre, sepse me një pjesë të tyre ka folur dhe ka hulumtuar mbi botën e tyre të brëndshme. Shoqërimi i tij me poetë të vjetër dhe të rinj që i përkthen funksionon në favor të zgjerimit të kërkimeve dhe sprovave të tij poetike. Bëhet fjalë për përkthime që i përmbushin synimet e poetit.

Në veprën e tij të pasur përkthyesë, shfaqet ndjeshmëria e pamohueshme, njohja e thellë e shqipes dhe një aftësi e madhe në përdorimin e saj. Ka përkthyer në greqisht vepra poetike të mjaft poetëve shqiptarë: Kadare Agolli, Arapi, Qirjazi, Zeqo, Bllaci, Haliti, Bejko, Spahiu, Lako, Londo, Papeleka, Pojanaku, Isaku, Ahmeti. Leshanaku, Acka, Mërkuri, Jani, Kallupi etj.

Nga vërejtjet e tij mbi përkthimet konkludohet se Kacalidha e përballon përkthimi si fushë të dialogut letrar, si rezervuar të modeleve estetike. Nuk angazhohet me origjinalin. Në sajë të intelektit gjuhësor është në gjëndje të riprodhojë dhe të përkthejë me besueshmëri absolute intelektuale. Ndërhyrjet e tij, përpunimi i lirë i origjinalit përbëjnë përzgjedhje koshjente.

5. KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME TË POEZISË SË NIKO KACALIDHËS. NDIKIMET. TEMATIKA. GJUHA DHE STILI.

5.1. Karakteristika të poezisë së tij

Poezia është një befasi e mendimit që presupozon ekzistencën e shumë faktorëve.

Është krijimtari që buron nga optika origjinale me të cilën poeti sheh botën dhe shpjegon gjërat rreth saj. Bëhet fjalë për një botë krejtësisht të ndryshme që kemi fatin ta shohim nën optikën e poetit dhe të bëhemi kungues të krijimtarisë së vet shpirtërore.

Për të qënë dikush një poet i mirë nuk mjafton këndvështrimi original i botës, as përzgjedhja tematike, në qoftë se nuk shoqërohet me mjeshtërinë e fjalës, të forcës së fjalës me të cilën do të operojë, do të falë ngjyra, do të krijojë dhe në fund të fundit do të ekspozojë shpirtin e poetit.

Niko Kacalidha është pa dyshim një poet modern i shquar. Kontributi i tij është i madh në poezi, në përkthim, në prozë, në esse, në kritikën letrare dhe veçohet si një nga poligrafët më të mëdhenj letrarë. Poezitë e tij janë tërheqëse, emocionuese. Fjala e tij poetike e zhyt lexuesin në çdo nocion dhe vlerë me të cilat operon poeti, ndërkohë hap horizonte dhe shtigje për të kërkuar bukurinë e shpirtit të vet. Shkrimtar me disponim të thellë lirik dhe me zë poetik tronditës karakterizohet nga një frymëzim original që buron, pikë së pari, nga një dashuri e pakufi për vendlindjen e tij.

Niko Kacalidha e pasuron krijimin kulturor me vepra të rëndësishme të cilat përmbledhin kujtime, bioma dhe vlera të vetë Minoritetit Etnik Grek, por edhe të vetë Shqipërisë. Përpiqet të dëshmojë etnicitetin e vet, të pëcjellë simbolikën greke jo vetëm në veprat që janë shkruar në greqisht, por edhe në ato që janë shkruar në shqip. Vetë poeti për këtë thekson: «U linda grek ashtu siç kemi lindur të gjithë, nga një racë homerike dhe jam krenar për identitetin tim».⁴⁹

Kërkon t'i përqaset të vërtetës së botës dhe tronditet realisht nga pikpyetjet e mëdha ekzistencialiste. Ekzistencialist në palcë, mediton mbi misterin e madh të jetës dhe të vdekjes.

⁴⁹ Gazeta. «2000», Prill 2000

Ekzistencialist në palcë, mediton mbi misterin e madh të jetës dhe të vdekjes. Tek Niko Kacalidha përplasja tragjike e njeriut me fatin e vet është nga elementet bazë të përpunimit emocional të mitit.

«Në kanavacën e vet Kacalidha qëndis kujtime të hidhura, përvoja të dhimbshme për të arritur në të njëjtat konkluzione. Këtu largimi bëhet emëruesi i përbashkët i një agonie ekzistencialiste që synon në kryqëzimin dhe në ringjalljen e të

kryqëzuarit madhor të epokës tonë, të Njeriut».⁵⁰Nëpërmjet veprave të tij shpjegon fenomenet e jetës: vendlindjen, virtytet e njerëzve të thjeshtë, natyrën, dashurinë, bukurinë që jetohet nga brënda dhe shpesh herë në subkoshjencë nga një popull që është bartës i një tradite krijuese historike.

Niko Kacalidha i takon brezit të Tretë të Pasluftës së poetëve shqiptarë dhe minoritarë grekë që u afirmuan në poezi si novatore për sa i përket konceptimit astetik dhe mjeteve shprehëse, duke shkruar një poezi metaforike që pasurohet herë pas here, duke u çliruar dhe shpleksur nga kallëpet e pasqyrimit të realitetit të realizmit socialist.

Pas viteve 1990 poezia shqiptare si edhe poezia e Minoritetit Etnik Grek pasurohet, zgjerohet dhe fiton një karakter të ri si në formë dhe në përmbajtje. Një botë e pasur, e rinuar, e ndjeshme dhe përgjithësisht më intelektuale përbëjnë tani burimet e frymëzimit dhe të tematikës së saj. Poeti tashmë lëvron anën më të thellë, atë të brëndshme të temës, prezanton një dimension tjetër. Një mentalitet i ri, i pasuruar me figura dhe simbole nga e kaluara historike dhe përvojat tiranike të epokës së vet, përbën një nga karakteristikat më pikante të poezisë së brezit të viteve '90. Shumë poetë dhe prozatorë shënuan rinovimin e fjalës së tyre, i dhanë leksikut të tyre një përmbajtje të gjerë semantologjike.

Ata u çliruan nga ideologjia, pikturuan me ngjyra poetike barbarizmin dhe karakterin çnjerëzor të sistemit monist. Vepra e Kacalidhës përshkohet nga dy karakteristika të cilat i pamë në të gjitha pëmbledhjet e veta poetike, në greqisht dhe në shqip: nga njëra anë kemi tonet e errëta që prodhojnë një fjalë vërshuese dhe kjo dallohet më shumë në sintezat e tij poetike (poemat) ky mbizoteron ngarkesa emocionale.

⁵⁰Revista, «Νέοι αγώνες της Ηπείρου», 8 Qershor 2004

Karakteristika tjetër është e kundërt me të parën: drita shkelqimtare, ngjyrat e forta. Mund të themi pa mëdyshje se tek Niko Kacalidha kemi shpërthime lirike me nota epike. Dhe kemi të bëjmë me poezi që flasin për atdheun e vet, natyrën, detin, dashurinë. S.Bejko në prologun e “Eliksirit të gurit”, me temë “Një poezi ballkanike, poezi e ngrave të forta mesdhetare” pohon:

“Si në një vepër muzikore dy temat e tij, e vrenjtura dhe e ndritshmja, nuk janë të ndara, ato orkestrohen dhe zhvillohen nga libri në libër, mbizotëron diku njëra më shumë, diku tjetra. Në temën e së vrenjturës vërehet atmosfera malore e vjeshtës, e

dimrit, e borës dhe e zogut të borës, borsit, e gurit e shkëmbinjve në mjegulla, e drurëve të tillë si lisat, panja, thana, bliri, pjergulla, ulliri”.⁵¹

Drita simbolizon atë që gjendet përtej konceptimit tonë të zakonshëm dhe ka forcën të na tërheqë. Errësira –mungesa e dritës në poezinë e tij është një pjesë e përvojës së N. Kacalidhës për dritën. Ashtu si drita e errët është e domosdoshme që të dallohet e bardha edhe errësira është e domosdoshme për të plotësuar apokalipsin e dritës. Errësira përfaqëson të panjohurën. Shkakton ndjenjë të fortë frike duke përbërë kështu një shpjegim metafizik të jetës. Jeta është plot kundërshti dhe poeti i rikthehet të bardhës dhe të zezës pa u ndalur definitivisht asgjëkundi.

Poeti pohon N.Ifantis: «Lëviz rreth dy boshteve: Ekstazes që prek dehjen dhe dhimbjen, me motiv të perbashket lidhës kujtimet nostalgjike. Mban një qëndrim të ndjeshëm ndaj botës dhe lëviz në terrenin e emocioneve. Bota e tij është një botë midis realitetit dhe ëndrrës, me nota të hidhura nga shija e thartë e realitetit».⁵²

Në poezinë e tij dallojmë edhe karakterin dramatik. Kjo është e dukshme në poemat e tij të mëdha por edhe në disa poezi më të shkurtëra. Ky dramacitet qëndron në dialogimin me veten e vet. Duhet theksuar se një pjesë e madhe e poezisë së tij dallohet për këtë karakteristikë dhe për këtë veçori. Adhurimi i antikitetit dhe dinjiteti antik janë edhe këto karakteristikë të poezisë që i shtojnë asaj karakter edhe epik edhe lirik. Poeti është adhurues i miteve sepse mbi mitet kanë qëndruar të parët e tij. E merr mitin në duart e veta dhe e rimbrujt sipas nevojave të tij.

⁵¹N.Kacalidha “Eliksiri i gurit”, Botimet “Toena”, Tiranë 2004 ,faqe11

⁵²Revista, «Ηπειρωτικά γράμματα», Shkurt 2006, faqe 600

5.2. Ndikimet

Mitologjia greke si një ndër thesaret e çmuara të universit kulturor botëror gjëndet kudo në veprën poetike të Niko Kacalidhës. Mesazhe antike të kthyer në simbole, alegoritë dhe metaforat i japin dimensione ekumenike poezive të tij. Ato përzihen me fenomenet e njeriut modern, me përjetimet e vet poetit, me simbolet e prekshme të realitetit. Niko Kacalidha marton mitet antike dhe biblike me realitetin ku jeton.

Heronjtë e tij ose figurat mitologjike, zakonisht përdoren si përkufizime poetike por edhe si pasurim dhe zbukurim poetik. Perënditë e Olimpikut dhe simbolet

antike mitike të fantazisë greke qarkullojnë në të gjithë poezinë e tij duke krijuar befasira idesh dhe figurash. E njëjta gjë ndodh me ikonat, motivet dhe variantet biblike. Simbole të Dhjatës së Vjetër dhe të Re, si Adami, Eva, Noe me kataklizmën, Krishti, Shën Maria, Shënjtore dhe Dëshmitarë të Shenjtë mbushin të gjitha përmbledhjet e tij poetike: «Gjithmonë me shoqërojnë Krishti, Odiseu dhe Homeri si anetarë nderi të pemës tonë gjenealogjike. Që nga fantazia ime adoloshente u rrënjos brenda shpirtit tim besimi se jam përqaftuar edhe me Krishtin, edhe me Odisenë, edhe me Homerin. I pari më pëshpëriti në vesh: «Të duash bashkënjëriun tënd që është i denjë i bukurisë së tij». I dyti më tha: «Njeriu lind për udhëtime. Kudo që do të shkojë, në Skilla dhe Haribdat, të mos harrojë Itakën». Dhe plaku i ashpër dhe i butë - baba Homeri: «Të durosh. Të lerosh dhe te kërruses mbi magjine poetike».⁵³

Mitet e ndryshme shpesh herë përdoren si lënd e parë ose edhe si simbole për të konturuar poeti poezitë e tij moderne.

Thotë S. Bejko: “Poezia e tij ka një arsenal të tërë termash nga mitologjia e lashtë dhe nga teologjia bizantine: si altar, absiolë, ungjill, koncil etj”.⁵⁴

Mbi Kacalidhën ushtron ndikim të madh pasuria e këngës popullore dhe e traditës vëndase. Duke qënë njohës i mirë i historisë së vendit të vet, i miteve dhe i legjendave e shfrytëzon efektshëm këtë pasuri në krijimtarinë e vet duke iu ofruar lexuesve edhe mundësinë e kontaktit me traditën.

⁵³Revista, «Ταχυδρόμος», 4 Shkurt 2004, faqe 15

⁵⁴N.Kacalidha “Eliksiri i gurit”, Botimet “Toena”, Tiranë 2004 ,faqe17

I bollshëm është edhe elementi folklorik. Përshkrimet dhe ndjenjat e tij përbëjnë pasqyrime autentike të jetës dhe të mentalitetit të njerëzve të atdheut të vet.Një nga legjendat kryesore të vendit të tij është ajo e Monovizës që solli shkatërrimin.

Këtë legjendë poeti e përdor për të dëshmuar shkretimin e sotëm të atdheut të vet.

N. Ifantis në një artikull për poetin thekson: «Mësuesi i tij i madh, kënga popullore, bashkë me Elitisin Sollomon, Seferin, Kristalin».⁵⁵ Vetë Kacalidha

këmbëngul se është i çliruar nga shkolla dhe teknika: «Sepse poeti nuk pranon të kopjojë modelet e të tjerëve, as të Zotit vet». ⁵⁶

Por siç thotë edhe J. Seferis nuk ekziston virgjëri në art. Kështu, është i dukshëm në vepër ndikimi i disa poetëve. Referimet e tij shumëformëshe dhe me ngjyra surrealistë. Do të thonim se përdor një simbolikë ku elementi surrealist depërton me elegancë dhe bukuri. S. Bejko në studimin e tij me temë “Një poezi ballkanike, poezi e ngyrave të forta mesdhetare” thekson:

“Surrealistët i besuan automatizimit të gjuhës, shpërthimit të përroit ekstazik të gjuhës, shkuan gati drejt një patologjie të së përfytyrueshmes, në deformimin e imazheve. Te Kacalidha, edhe se punohet me këtë teknikë ah –u i mahnitjes nga krijimi spontan i imazheve në lojën e fantazisë ruan tejdukshmërinë, sido që edhe ky poet luan rëndshëm me derdhjen e bujshme të imagjinativës”. ⁵⁷

Ndërsa Nase Jani do të theksojë: “Po si u shfaq poet Kacalidha. U shfaq dhe mbeti i shfaqur kryesisht : poet surrealist (me realen jetësore), poet i metaforës. Në ngjasim me të “Mëdhënjtë” përfaqësues të asj rryme: Andrea Breton(1896-1966), Jean (Hans) Arp (1887-1966), Paul Elyard (1895-1952),Antonin Artaud(1896-1948), Robert Desnos (1900-1945), Louis Aragon (1897-1982),Tristan Tzara (1896-1963), Bemamin Peret (1899-1959), e deri te Eliot, Paund, Elitis që ndjehet më pranë...”⁵⁸

⁵⁵Revista, «Ηπειρωτικά γράμματα», Shkurt 2006, faqe 610

⁵⁶Revista, «Ταχυδρόμος», 4 Shkurt 2004, faqe 15

⁵⁷N.Kacalidha “Eliksiri i gurit”, Botimet “Toena”, Tiranë 2004 ,faqe13

⁵⁸N. Jani, “Poeti Niko Kacalidha” (nga arkivi i poetit)

Por Niko Kacalidha posedon talentin për të përsorur linjën moderne poetike të pasuruar me një meditim të thellë dhe intonacione lirike, por pa arritur në hiperbolizime dhe në identifikimin me çdo lloj rryme ose prirje. Ka stil të pastër personal.

Njeh poezinë shqipe, studjoi, por edhe ushtroi profesionin e mësuesit të letërsisë. Është njohës i mirë i De Rades, Frashërit, Migjenit, Poradecit, Kadaresë, Agollit, Arapit etj. Është gjithashtu njohës i mirë edhe i poezisë greke dhe tregon se e ka studjuar në themel mitologjinë antike greke, Homerin, Solomosin, Kallvon,

Kristalin, Kavafin, Seferin, Ricom, Gacon, Egonopullon etj. Vetë Kacalidha deklarohet adhures i madh i poezisë së Elitistit.

«Në poezinë e N. Kacalidhës e gjejmë veten pranë e pranë, si miq të mirë ballkanasit e mëdhenj, shqiptarë edhe grekë, si Homeri, Onufri, David Selenica, Kazanxaki, De Rada, Seferi, Vangjush Mio, Poradeci, Elitis». ⁵⁹

Sulejman Mato do të thotë për këtë temë: «N. Kacalidha ka diçka nga Homeri i lashtë, ashtu siç ka diçka nga Ricos dhe Elitis i kohëve tona, por brenda saj poezia ka diçka të veçantë edhe nga i madhi De Rada». ⁶⁰

Ndërsa Nikos Ifantis do të shkruajë: «I pozicionuar midis idealizmit dhe i adhuresit antik, përmbledh rezerva shpirtërore dhe intelektuale nga njohja e tij me shkrimtarët e lashtë dhe me tekstet biblike, nga komunikimi i tij me veprat e Elitistit, Seferit, Kariotakit, Kafavit, Pallamas, Kallvos». ⁶¹

Fluturak Gjermani thekson: «Mund ta krahasosh me Fatos Arapin ose me Ali Podrimjen në letërsinë shqipe dhe këtë do ta kuptosh menjëherë nga lidhja me befasinë dhe spontanitetin e poezisë». ⁶²

Mojkom Zeqo, një nga kritikët e parë të veprës së tij do të thotë: “Në lirikën e Kacalidhës ndihet një vesk i ndritshëm deradian, erërat e Joniti i firqëllojnë, i bëjnë të dridhshme pishat e qiparisat e fshatit Leshnicë”. ⁶³

⁵⁹ Gazeta «2000», prill 2000

⁶⁰ Gazeta «Ρωμοσύνη», 20 korrik 1999

⁶¹ Revista, «Ηπειρωτικά γράμματα», Shkurt 2006, faqe 611

⁶² Nga diskutimi letrar për veprën e N. Kacalidhës «Profecitë e druve», Tirane 15 Janar 2000

⁶³ Moikom Zeqo, “Lirika e Niko Kacalidhës”(nga arkivi i N.Kacalidhës)

Nuk duhet të injorojmë ndikimet e shkrimtarëve dhe të poetëve të cilët Niko Kacalidha i njohu dhe i përktheu, grekë, qipriotë dhe shqiptarë. Duke qënë i ndikuar prej tyre, por edhe nga prirjet e kohës në letërsi ia arrin që të asimilojë elementet e dobishëm dhe të heterogjene, tua përshtasë nevojave të veta në mënyrë të tillë që të përvijojë stilin e vet individual.

5.3. Tematika

Temat e tij janë ato të veprimtarisë së përditshme dhe protagonistët janë tokësorë dhe popullorë dhe mbartin traditat shekullore. Si rregull, i gjen gjithmonë në përjetimet personale, por kjo nuk do të thotë se blindohet rreth vetes, se shpreh vetëm precedentin individual. Poezia e tij zgjerohet nga njëra përmbledhje në tjetrën përderisa pranon dhe përpunon figura dhe ndijime nga bota e jashtme (vendlindja, natyra, rrethi social, jeta politike etj.).

Në fizionominë dhe në tematikën e vet poetike padyshim kanë ndikuar rrethi fizik dhe social, studimet e tij, karjera e tij si pedagog i shkolles së mesme si edhe

karjera e tij politike dhe diplomatike. E ndihmoi shumë edhe ambjenti familjar, gjyshja e tij, babai i tij, edhe ai mesues dhe folklorist i njohur siç e kemi theksuar. Të gjitha këto ndikuan në mbrujtjen e personalitetit të tij si edhe në përvijimin e teorisë së tij për jetën dhe për botën. Vetë poeti ka krijuar gjithësinë e vet të fantazisë që përbëhet nga bota e epërme, nga bota e perëndive, nga bota e të gjallëve me dijetarët, asketët, botën e thjeshtë dhe botën e përtejme të të vdekurve.

N. Ifantis shkruan: «I këndon dashurisë, mallit, vajton për dhimbjet familjare dhe racore, për ndarjet për së gjalli, për mërgimin, për rininë e humbur, për braktisjen e fshatrave dhe çrrënjosjen e pamëshirshme. Është nostalgjik dhe kujton me hidhërim gjithçka që humbi dhe flet për avlemendin dhe qëndisimat, duke shprehur me bollëk ato gjëra që trondisin».⁶⁴

5.3.1 Tema e vendlindjes në poezinë e vet

Pasionant me vendlindjen e vet, Leshnicën, e hymnizon, e lartëson, e merakoset për fatin e saj dhe shpreh dashurinë e painteres për të. Një nga dimensionet e poezisë së tij është vendlindja që luan rol bazë dhe organik. Frymëzimi i tij është Leshnica. Thotë Vangjel Zafirati: «Në qoftë se nga poezia e Nikos do të tentosh të heqësh vendlindjen, nuk do të ekzistojë më poezia».⁶⁵

⁶⁴Revista, «*Ηπειρωτικά γράμματα*», Shkurt 2006, faqe 611

⁶⁵Gazeta «*Λαϊκό Βήμα*», 11 Dhjetor 2003

Vendlindja luan rol vendimtar në formimin e poetit. Nuk është vend dashurie dhe vend adhurimi. Është qendra e botës. I fal poetit motivet poetike. Nuk ka përmbledhje poetike ku të mos i jetë referuar tokës së vendlindjes. Bile, siç e theksuam vendlindjes së vet i kushton edhe një përmbledhje të plotë poetike, atë me titull «*Loti i Ciklaminit*».

Sipas Niko Kacalidhës në qoftë se ndonjë e keqe do ti ndodhë Leshnicës, atëhere mandate të zeza do të kemi për botën. Kujtime dhe përjetime fëminore, kujtime dhe përvoja na çojnë në epoka më të lashta dhe krijojnë emocion estetik me dashurinë e tij të pazakontë për vendlindjen. Nikos Kacalidhas mund të themi se është një adhurues pasionant i atdheut dhe një hymnizues i vendit të tij.

Vetë Kacalidha thotë: «Dhe ishte Leshnica. Dhe kudo që vajta dhe u ktheva, fëmije plangprishës, në tokën time u riktheva. Në vendlindjen time poetike, të mbjellë me një qiell yjesh. Me pemët e mija profetike që më folën mes heshtjes së tyre më singerisht se edhe vetë njerezit. Një botë te tërë me dhuruan këtu. Vendlindja, Itaka e zemrës time ishte për mua gjithmonë kërthiza e botës time poetike»⁶⁶

Atje stërgjyshërit janë male dhe rrepe. Fenomenet modern të botës së re poeti i shpjegon me moralin dhe zakonet e traditës.

Duke lexuar kujdesshëm poezitë e tij do të takosh të gjitha toponimet e atdheut të vet që nga Shën Nikolla dhe Shën Thanasi, Shën Ilian, Halikariane, Katarahia, Guven. Dhafnopotamon etj.

V. Zafiratis thekson: «Në qoftë se ndonjë botanolog do të përshkruante bimët dhe më gjersisht gjithë gjelbërimin e egër të Theologos nuk besojmë se do të kishte radhitur më shumë lloje se Niko Kacalidha në poezinë e vet. Me ndryshimin që botanisti përshkruan karakteristikat botanike të bimëve, ndërsa poeti «shpirtin» e bimëve. Bimë që zbukurojnë vendin ku i vënë vajzat për stoli, që i pijnë për tu shëruar, që dashurohen, që flasin, sikur bisedojnë me Zotin vet».⁶⁷

Vend të veçante në temën e vendlindjes zë shtëpia. Brënda nga shtëpia e tij nisin histori paralele prindërisht, fëmijësh, të afërmish. Një pohim që flet si për ndërtimin material të shtëpisë ashtu edhe për interesat psikoemocionale që mbarsen në tavolinën e shenjtë.

⁶⁶ Gazeta «2000», Prill 2000

⁶⁷ Gazeta «Λαϊκό Βήμα», 11 Dhjetor 2003

Vendlindja ndikon në poezinë e Niko Kacalidhës me mitet dhe me legjendat e saj, materialin folklorik dhe traditën kristiane. Mitet dhe legjendat e ndryshme vlejné shpesh herë si material i parë ose edhe si simbole.

Poeti, njohës i mirë i historisë së vendit të vet, e shfrytëzon mirë këtë pasuri të tij duke u ofruar lexuesve edhe mundësinë e kontaktit me traditën. Dritero Agolli shkroi në një poezi të veten se po transportonte një plis dheu nga vendlindja e tij, Devolli, për ta çuar në Tiranë, në zyrat e Lidhjes së Shkrimtarëve, ndërsa Niko Kacalidha mbart tre gure stëralli:

«Οι τρεις μικρές καρδιές, οι χάριτες, οι κόρες του βοριά,
οι στουρναρόπετρες μου, περπάτησαν κι ήρθαν μακριά απ' τη Λεσινίτσα και
μπουμπούκισαν τις νύχτες μου».

(Tre zemra mitake, tre cupa te veriut, tre gurestralli, duke ecur erdhen nga larg nga Leshnica dhe buluan netet e mia.)⁶⁸

Janis Baskozos do të thotë: “Gjithkund sundonte kryemotivi i vendlindjes. Isha i bindur se vendlindja ishte faktori determinant i poezisë së tij. Gjithçka kalonte nëpërmjet vendlindjes. Që nga dashuria e parë dhe mosha e pjekurisë, deri në dashurinë për vendlindjen, në mallin, nostalgjinë, në jetën dhe meditimet për jetën, te nëna, te shkretimi, te harresa. Tani që e kam rilexuar disa herë poezinë e tij, e di mirë se vendlindja është treva poetike brenda së cilës si brenda një mitre lind dhe burrohët poezia e N.Kacalidhës”⁶⁹.

Sadik Bejko për temën e vendlindjes do të theksojë: “Poezia e N.Kacalidhës edhe në klimën, në ngjyrë, në toponiminë e saj është e vëlosur nga ajo që është vendlindja e tij. Leshnica, Saranda, bregdeti. Aty në Leshnicë lind dhe vdes Krishti sipas Ungillit të babait, të gjyshit, aty ndodhin gjithë mrekullitë e gjithë hatatë e mëdha biblike të botës. Edhe gjeneza:

Pasi mbaroi gjithçka, tani duhej kërthiza

Dhe lidhja duhej bërë në gjenezë,

me një fije gjineshtre nga Leshnica”⁷⁰

⁶⁸N.Kacalidha, «Η πρόρα των άστρων», Athinë 2001

⁶⁹Gazeta «Λαϊκό Βήμα», 11 Dhjetor 2003

⁷⁰N.Kacalidha “Eliksiri i gurit”, Botimet “Toena”, Tiranë 2004, faqe 17

5.3.2 Tema e natyrës në poezinë e tij

Natyra me të gjithë elementet e saj luan rol kryesor në poezinë e tij. Disponimi natyralist përbën një nga karakteristikat kryesore të poezisë së Niko Kacalidhës, të ndërthurura me epokat dhe me vende konkrete. Një shikim i shpejtë mbi titujt përmbledhjesh dhe poezish e dëshmon këtë. Hymnizon natyrën në të gjitha orët dhe epokat, por më shumë tonet e gëzueshme pranverore.

Ndeshim poezi që janë autentikisht dhe ekskluzivisht natyraliste. Ekzistojnë edhe poezi ku elementi natyralist përbën thjesht ambjentin, kuadrin ku vendosen disponime të tjera qendrore.

Vend të veçantë zënë zogjtë, pemët dhe guri. Shkëmbinjtë, lartësitë, pemët, zogjtë, bimët përbëjnë skenografinë e poezive. Simbolika e zogut e shumanshme. Fluturim drejt lirisë. Zogu në veprën e tij zë vend kryesor. Sidomos në përmbledhjet e fundit referimet për zogjtë fluturues shumëfishohen.

Pemët tek N. Kacalidha nuk kanë kohë të merren me gjëra të parëndesishme dhe me vogëlsira. Ato bashkëbisedojnë me poetin. Kanë «profecitë» e tyre. Poeti si askush tjetër mund ti lexojë, ti kuptojë, të lexojë gjuhën e tyre ekumenike dhe nga kjo gjuhë të kuptojë mesazhin e madh të njerëzimit.

Shkëmbinjtë, gurët e Niko Kacalidhës na flasin, na udhëtojnë me elementet e pasur lirikë në vënde intime. Poeti zbulon agoninë e vet ekzistencialiste, por edhe të bashkëfshatarëve të tij që luftojnë me shkëmbinjtë. Personifikon shkëmbinjtë, flet në gjuhën e tyre të gurtë. Përveç kësaj guri, siç edhe e kemi theksuar, është një nga elementet poetike të krijimtarisë së Niko Kacalidhës. Por nuk kemi të bëjmë me një gur të zakonshëm, pa funksion. Vetë poeti thotë: «Personalisht besoj në estetikën që më pëshpëritën shkëmbinjtë, se poeti duhet të jetë zëri poetik i vendit të vet».⁷¹

⁷¹Revista «Ταχυδρόμος», 4 Shkurt 2004, faqe14

5.3.3 Muaji Prill në poezinë e Niko Kacalidhës

Duke lexuar poezitë e Niko Kacalidhës, që nga përmbledhja e tij e parë dhe derin në atë të fundit, konstatohet se i referohet shpesh herë muajit Prill. Është muaji i triumfit të pranverës me të gjitha fuqitë e veta, është muaji i dashur i poetit. Në qoftë se do të vinim re me kujdes Letërsinë e Re Greke, shumë poetë i referohen këtij muaji, si psh., Solomos tek «Të Lirët e Rrethuar»:

«Ἐστησε ὁ Ἐρωτας χορό με το ξανθό Ἀπρίλη,
κ' φύσης ἤβρε την καλή και τη γλυκιά της ώρα».

«Dhe zuri vallen dashuria me prillin biond

Dhe natyra gjet orë të mirë, gjeti një orë të ëmbël» .

Por edhe te Kariotakis, Siqelianso, Elitis do të gjejmë referime tek prilli. Bile Elitis ka edhe një përmbledhje poetike me titull «Kalendar i një prilli të padukshëm» (1984), ku prilli është vërtet i padukshëm. Kacalidha e ndjen Pranverën si triumfin e jetës. Thotë në poezinë «Prilli im»:

«Απρίλη μου, Απρίλη μου όταν πατώ τη γη μου,
σε νιώθω τόσο ελαφρύ κι ας είσαι φουντωμένος».

(Prilli im, prilli im,
kur shkoj mbi këtë dhe
të ndjej kaq të lehtë
packa se ke shpërthyer)⁷²

Në një poezi tjetër shkruan:

«Άρπαζε ο Χάρος τον Απρίλη απ' τα μαλλιά
να μην ακούγαμε κελαϊδισμα αηδονιών
(E zuri vdekja prej flokësh prillin
të mos dëgjonim ligjërimet e bilbilave)⁷³

Këtu kemi të bëjmë me ekzistencën e dy motiveve të Pranverës, domethënë të rilindjes dhe të vdekjes, përmasën tragjike që përmban triumfi i Pranverës.

⁷²N. Kacalidha, «Ανταύγιες», Tiranë 1989, faqe 36

⁷³N. Kacalidha, «Η πλώρα των άστρων», Athinë 2001, faqe 25

5.3.4. Tema e detit

Të gjitha vëllimet e tij janë të mbushura me figura të bukura detare duke deklaruar në këtë mënyrë disponimin e theksuar psikik të poetit. Hymnizon detin, këtë perendi të patretur dhe peshkon të fshehtat e tij. Bashkëbisedon me të. E prezanton veten herë si «pulebardhë të Veriut» (faqe 19 «Njëmijë guacka») dhe herë si Odise. Simbolet mitologjike që kanë të bëjnë me detin janë të bollshme: Poseidoni, Aferdita, Odiseu, Sirenat etj. Deti i frymëzon romantizmin. Sepse, siç e kemi theksuar Kacalidha është natyrë romantike.

5.3.5. Tema e erosit dhe e dashurisë

Një tjetër temë që haset dendur në poezinë e Niko Kacalidhës është ajo e dashurisë dhe e erotit, ndër ndjenjat më fisnike të njeriut.

Vëllimet e tij poetike tregojnë se Kacalidha nuk është vetëm poeti nostalgjik i vendlindjes së vet, natyralisti dhe skepticisti i theksuar, por edhe një njeri erotik dhe me ndjeshmeri origjinale. Në poezinë e tij dashuria merr dimensione të rendësishme dhe krijon brenda jetës së përditshme një hapësirë të pacënuar magjie dhe originaliteti. Bile theksuam se ekziston një përmbledhje poetike e plotë e karakterit erotik në greqisht. («Njëqint trendafilat»

Nevoja e dashurisë është dominuese për poetin, sepse në brendësi të subkoshiences ekziston një dhimbje e thellë për njeriun. Njeriu në poezinë e vet lufton për të shpëtuar mesazhin e dashurisë, mishëron cilësi perëndish dhe përpiqet të zbulojë vlerat, siç janë natyra, bukuria, atdheu etj., me temat e dashurisë dhe të erotit poeti jeton dhe gjallëron traditën dhe legjendat.

5.3.6. Tema e mërgimit

E ndeshim në poema më të medha (si «Vaji i malit të vrenjtur»), por edhe në poezi me pak vargje.

Poeti është dëshmitar okular i çrrenjosjes masive që u realizua në fillim të viteve 90' dhe na prezanton me ngjyrat më të errëta klimën e asaj epoke. Prandaj dëshmia e tij për këtë braktisje është shokuese, na e përshkruan me hollësi rrënjëqethëse që shndërrohen në britmë të përgjakur. Motivet e mërgimit janë: emigracioni, nostalgjia për atdheun dhe për mesazhet që përcjell poeti për largimin nga rrënjët dhe kthimin në vendlindje. Me vargje të thjeshta dhe të përkujdesura i këndon mërgimit dhe dhe mallit të atdheut të tij të veçantë dhe atyre syve të shënjtë të nënës shamizezë që e sheh vetëm në rrugët memece dhe të zbrazura të atdheut të saj.

5.3.7. Tema e vdekjes

Shumë poezive u jepet forma e Vdekjes. Në të vertetë tema nuk ka të bëjë me vdekjen, por me marrëdhëniet e të gjallëve me të vdekurit. Në fakt përserit konceptimin e përgjithshëm të popullit për ekzistencën e tmerrshme të botës së përtejme. Në këto poezi poeti huazon shpesh figura dhe menyra shprehjeje nga kënga popullore.⁷³

Vdekja shaqet në atdheun e tij, ecën mbi majëmalet, kalon lumenj dhe përrënj, kapërcen shtëpi dhe rrëmben trimat që humbasin përjetë.

«Ο θάνατος πόδεσε τις αρβύλες κι όπου πατάει
πηδούν τα σιντριβάνια του αίματος των παιδιών μας». («Dhe Sfinksi foli»)

(Vdekja veshi këpucët e saj dhe ngado që shkel
shpërthejnë shatërvanet e fjakut të djemve tanë).

Nëna të veshura në të zeza, fytyra tragjike të tragjedisë antike vajtojnë për largimin e bijve të tyre, ndërsa stergjyshërit kërcëjnë natën nga varret dhe u luten bijve të tyre të mos largohen duke i lënë ata në vetmi.

5.3.8. Tema e patriotizmit

Ekzistojnë shumë poezi (më shumë në përmbledhjet në gjuhën greke) që kanë karakter patriotik. Ato pasqyrojnë përpjekjet, trimerinë dhe luftën e Minoritetit Etnik Grek në Shqipëri në çastet e mëdha dhe historike. Fitore, humbje, triumfe, dafina, skllavëri, të gjitha përshkruhen me vargje të shkelqyera.

Atdhedashuria e poetit, ndjeshmëria e tij e madhe kur bëhet fjalë për nderin dhe për lavdinë e komunitetit të vet dhe e ardhmja optimiste janë mishëruar në shumë vargje.

⁷³ E shikojmë këtë më shumë në vëllimet poetike «Dhe Sfinksi foli» dhe tek “Ambrozia e shkëmbinjve”, faqe 40 dhe 70 përkatësisht.

Vetë poeti pohon: «Unë dhe brezi im, besoj se bëmë pa ditirambe dhe zhurmë atë çka mundem për dimensionin e Grekut, për kulturën tonë, duke përfaqësuar ngjyrat tona kombëtare, vlerat edhe jashtë murëve, duke nderuar veten tonë, bashkëkombasit tanë në mes të Shqipërisë dhe nuk e fshehem kurrë se jemi Grekë, por u deklaruar me krenari si Grekë».⁷⁴

Nga njera anë hymnizon tokat kombëtare, qiellin dhe detin, ndërsa nga ana tjetër vajton me tone elegjake vuajtjet dhe dhimbjen e bashkëkombasve të tij.

⁷⁴Revista «Ταχυδρόμος», 4 Shkurt 2004, faqe 14

5.4 Poet i vëllazërimit të popujve

Sot, në epokën e integritit, vizioni i vëllazërimit të popujve dhe i kapërcimit të nacionalizmave përbën një aktualitet të ri. Nikos Kacalidhas, duke kapur mesazhet e kohës, po punon për bashkpunimin paqësor evropian dhe për unitetin shpirtëror të Grekëve me Shqiptarët.

Me kordat e lirës se vet ëndërron një vëllazërim të vertetë dhe thurr këngë me ndjenjë njerëzore, sepse poezia, mbi të gjitha, është urë komunikimi midis njerëzve dhe popujve. Poezitë e tij përshkruhen nga një ndjenjë e thellë afërie vëllazërore me Shqiptarët dhe është e natyrshme, pasi përforcohet nga shekujt e bashkëkzistencës. Shumë studjues dhe njerëz të njohur të letrave e theksojnë këtë rol të Kacalidhës. Konkretisht, shkrimtari i madh shqiptar Ismail Kadare në prologun e librit “Pagëzimi i zogjve” me temë “Niko Kacalidhas, poet në dy gjuhë” do të shkruajë:

“Niko Kacalidha, i çmuar në Shqipëri e, ma sa duket , edhe më tepër në Greqi. Është një nga të rrallët poetë që përdor me mjeshtëri të dy gjuhët e Ballkanit. Për të tillë poetë përdoren zakonisht metafora fisnike: ura të afrimit të kulturave, kasnecë të miqësisë midis popujve. Të tilla metafora, që janë veçanarisht të çmuara sot në Ballkan, Niko Kacalidha i meriton plotësisht”.⁷⁵

Nikos Tentas për të njejtën temë do të theksojë: «Është një bilbil dygjuhesh i dhimbjes dhe i vetmisë, por edhe i miqësisë së popujve. Është një poet i vertetë. Në poezitë e tij dallojmë një ndjenjë të thellë miqësie dhe afërie vellazërore me popullin shqiptar, një gjë mëse normale përderisa përforcohet nga shekuj bashkëzistence që përvijuan menyrë të përbashket në mendime dhe në koncepte, tej paragjytimeve, keqkuptimeve dhe vlerësimeve të gabuara»⁷⁶

S. Mato thekson: « N.Kacalidha është prerja e artë e takimit të poezive të dy popujve antikë të Ballkanit».⁷⁷

⁷⁵N.Kacalidha, “Profecitë e drurëve”, Shtëpia Botuese “Dritëro”, Tiranë 1998, f.5

⁷⁶Νίκος Τέντας, « Ο Ελληνικός λόγος του Νίκου Κατσαλίδα στην βαλκανική ποίηση».(nga arkivi i N.Kacalidhës)

⁷⁷Gazeta «Ρωμιούσνη», 20 korrik 1999

Ndërsa Novruz Shehu në artikullin me temë “Kitaristi i detit dhe profecitë e paqes” do të thotë: “ Pikërisht aty, poeti N.Kacalidha, buzë detit Jon, vendosi të ngrrejë një urë të madhe diellore ku, ilirët e helenët të shkojnë të shohin si shëtit Helena në konkavet e syve të Homerit”.⁷⁸

Poezia e tij mbart një mesazh bashkëpunimi, harmonie, vazhdimësie dhe simbioze i të dy kulturave tona. M. Zeqo thekson: “Lirika e Nikos është një biopoezi...Ky bilinguizëm është një fat, fat që nuk e kanë të shumtët, fat jo vetëm për Nikon, por unë do ta quaja fat edhe për Shqipërinë dhe shqiptarët si një strukturë antropomorfe e qytetërimit të ardhshëm, kundër përçarjeve, etnocentrizmave groteske dhe ballkanizmit mesjetar”⁷⁹

Milianov Kallupi do të thotë: «N.Kacalidha ka një dhunti që nuk e kemi ne poetët e tjerë: ekzistenca e tij është dyfishë. Dyfish edhe shpirti i tij. Grek dhe Shqiptar. Shqiptar dhe Grek».⁸⁰

N. Ifantis thekson: «Poezia e tij përbën portin ose më mirë komunikimin që ndan dhe ndërkohë bashkon. Është vizionar tej dallimeve raciale, pa pushuar ndërkohë të ndjekë, të interesohet dhe të plagoset nga fatet e kombit».⁸¹

Zyhdi Morava do të thotë: «Ky poet shumë i ëmbël që quhet Nikos Kacalidhas përbëhet nga dy pjesë të pasura. Shpirti i tij grek u materializua dhe u rrit në bukuritë e jugut shqiptar».⁸²

Se fundi, Sadik Bejko na thotë: “ Një homo balcanicus.Poezia është gjuhë. Kacalidha është i lindur në gjuhën greke, është shqiptar si shkrimtar në gjuhën shqipe, është poet biling. Një ballkanas për nga përvoja”.⁸³

⁷⁸Gazeta “Drita”, 26 Maj 2002, faqe 5

⁷⁹Moikom Zeqo, “Lirika e Niko Kacalidhës”(nga arkivi i N.Kacalidhës)

⁸⁰ Gazeta «Ρωμοσύνη, 20 korrik 1999

⁸¹Revista, «Ηπειρωτικά γράμματα», Shkurt 2006, faqe 594

⁸²Gazeta «Ρωμοσύνη, 20 korrik 1999

⁸³N.Kacalidha “Eliksiri i gurit”, Botimet “Toena”, Tiranë 2004 ,faqe17

5.5 Karakteristika të gjuhës

Në greqisht

Poeti i përdor me lehtësi si gjuhën greke ashtu edhe atë shqipe. Gjuha e tij amtare është greqishtja siç e ka dëgjuar nga buzët e nënës dhe të gjyshes së vet me ninullat dhe me përrallat dhe ashtu siç e ka mësuar më vonë nga i jati folklorist, nëpërmjet miteve dhe legjendave. Ndërkaq arsimimi i tij në gjuhën greke ishte i mangët si në rastin e të gjithë krijuesve të Minoritetit Etnik Grek në Shqipëri. Kjo lidhet me kufizimet që kishte vendosur regjimi diktatorial edhe në sektorin e arsimimit në gjuhën letrare. Niko Kacalidha me sedër dhe përpjekje ia arriti të kultivojë gjuhën greke të poezisë së vet. Përkundrazi, edukimi i tij në gjuhën shqipe ishte sistematik dhe intensiv. Vetë poeti thekson:

«Gjuha greke është gjuha jonë amtare që ma kultivoi edhe mesuesi im, babai folklorist Grigori. Ishte ky brez mesuesish i babait tim që na kultivuan gjuhën greke. Përndryshe, pas Luftës së Dytë Botërore kur u mbyllëm në Shpellën e Polifemit, do të bëheshim memecë duke ngrenë zanoret dhe bashkëtingëlloret e zërit tonë»⁸⁴

Studjon në menyrë të veçantë këngët popullore, të cilat i mbledh babai i tij dhe merr nga ato gjuhën dhe frymën e tyre. I mbeshtetur në këngën popullore do të përvijojë gjuhën e tij poetike dhe këto do të bëhen burim frymëzimi. Me kalimin e kohës dhe nga një përmbledhje në tjetren gjuha e tij greke pasurohet.

Krijon një gjuhë personale me elementë nga Homeri, antikitetin klasik, epokën kristiane dhe arrin në realitetin e sotshëm. Gjuha e tij është popullore, e gjallë, figurative, e kultivuar. Ia arrin që nga fjalët e thjeshta dhe të matura të shprehë figura sintetizuese dhe të shprehë shumë emocione duke zgjeruar leksikun e tij. Promovon nga ana tjetër elementet idiomatikë të gjuhës së krahinës së tij.

N. Ifantis thekson: «Poezitë e tij të nxjerra nga rrënjët e origjinës së vet, me një gjuhë të kalueshme, me idiomat e papërseritshme të vendlindjes së vet, krijojnë krisje dhe shpërthime shpirtërore dhe vërshohen nga ndjenjat miqesie, gëzimi dhe dhimbjeje, të cilat ndërthuren me gjurmë të realitetit të sotëm».⁸⁵

⁸⁴ Revista «Ταχυδρόμος», 4 Shkurt 2004, faqe 14

⁸⁵ Revista «Ηπειρωτικά γράμματα», Nëntor 1998, faqe 613

Në shqip

Theksuam se arsimimi i tij në gjuhën shqipe është i plotë, përderisa edhe studimet e tij të larta u bënë në gjuhën shqipe. Është njohës i shkelqyer i shqipes. Kjo duket jo vetëm nga veprat e tij poetike, por edhe nga përkthimet në shqip. Përdor një gjuhë të aftë për të krijuar bashkësi të reja objektesh, situatash, bile edhe emocionesh. Leksiku i tij është i pasur. Edhe në këtë rast përdor shumë fjalë greke, huazime të shqipes nga gjuha greke.

Fatos Gjermani do të thotë: « Në këtë veçanësi plekset leksiku i pasur që u ngjan puhizave të vendlindjes së tij dhe me ëndrrat e bukurisë në zemrat e njerëzve, me ritmet që vijnë valë – valë si përshendetja e erërave, por edhe si puhizat e bregut të detit». ⁸⁶

I. Kadare thekson: “Niko Kacalidha, i vlerësuar në Shqipëri e, më sa di, edhe më tepër në Greqi, është një nga të rrallët poetë që përdor me mjeshtëri të dy gjuhët e Ballkanit».⁸⁷

Ndërsa Sadik Bejko do të theksojë: “Kacalidha vjen si një poet që shenjtëron shqip, me një shqipe që ka amat e saj të rrënjëta, me arbërishten deradiane, me lëndën e rapsodive, me finesat dramatike lasgushiane. N.Kacalidha e ka pirë thellë qumështin e trashë të kadishtes së gjuhës shqipe. Në thithkat e gjuhës së tij qumështi vjen e mblidhet rruaza – rruaza , krua – krua... shqip”.⁸⁸

⁸⁶Nga diskutimi letrar për veprën e N. Kacalidhës «Profecitë e druve», Tiranë, 15 Janar 2000

⁸⁷N.Kacalidha, “Pagëzimi i zogjve”, Shtëpia Botuese “Onufri”, Tiranë 2004, faqe 5

⁸⁸N.Kacalidha “Eliksiri i gurit”, Botimet “Toena”, Tiranë 2004 , faqe 16-17

5.6 Stili, teknika – Mjetet shprehëse

Karakteristikat bazë të stilit të tij janë: saktësia e të shprehurit, referimet e shpejta në antikitet dhe veçanërisht në mitologjinë dhe në elemente esaj. Stili është i rrjedhshëm, figurativ, më shumë figura letrare dhe me përshkrim brilant. Mjetet e tij kryesore shprehëse janë: metaforat, figurat, krahasimet, personifikimet. Figurat dhe metaforat i përdor me forcë burimore dhe në menyrë spontane.

Zyhdi Morava thekson: “Metaforën, «mbretëreshën e të gjitha shprehjeve poetike», siç e quajti Croçe, e takojmë kudo në veprën e tij. Mjeshtër i metaforës, i paarritshëm në poezinë shqipe për nga dendësia e përdorimit, për nga eleganca e përdorimit. Dhe në qoftë se metaforën e krahasojmë me pianon, Niko Kacalidha është një Shopen».⁸⁹

D. Agolli thekson: «Poezia etij është e kahut të meditimit filozofik me metafora të nxjerra nga e kaltërta e thellë e Jonit».⁹⁰

Ndërkohë, F. Gjermani thekson: «Në të vertetë bëhet fjalë për një metaforë të madhe që nis me shpirtin e poetit si një pikturë e madhe, të na flasë për botën dhe për njerëzit e tij të adhuruar».⁹¹ Gjithashtu përdor në masë të gjerë antitezat. Epiteti, gjithashtu, i thjeshtë apo sintetik, kozmetik apo poetik ushtron një farë magjie tek emri i përshtatur. Shpesh personifikon elementet e natyrës, u jep rol njerëzor objekteve pa shpirt. Shpesh herë përdor pyetje retorike të cilat nga njëra anë kujdesen që fjala të altërnohet dhe të mos shndërrohet në monotone, domëthënë i japin gjallëri veprës, ndërsa nga ana tjetër theksojnë me emfazë mendimet e poetit në menyrë që të jenë më të drejtpërdrejta për lexuesin.

N.Ifantis pohon: «Në të gjitha poemat e tij të theksojmë metaforat e spikatura, alegoritë, gjykimet dhe simbolet të mbuluara me një nënshtresë emocionale interesante».⁹²

Duke studjuar produktin e tij poetik mundet që çdonjeri të konstatojë lehtësinë në përdorimin si të formave metrike tradicionale ashtu edhe vargun e lirë duke arritur që të krijojë gjithnjë një poezi solide.

⁸⁹ Gazeta «2000», Prill 2000

⁹⁰ Gazeta «2000», Prill 2000

⁹¹ Gazeta «2000», Prill 2000

⁹² Revista «Ηπειρωτικά γράμματα», shkurt 2006, faqe 611

Vargu i tij, në të shumtën e rasteve është i lirë, por shpesh herë inkuadrohet në modelet e vargëzimit të poezisë shqiptare dhe greke. Në veprat që ka shkruar në gjuhën greke ndikohet nga kënga popullore dhe nga jambi 15-rrokësh. Ky varg është dinamik, komunikativ, i mirëpunuar.

«Gjyshja ime, dijetarja, që dinte më qindra vargje përmendësh, më mesoi qysh femijë të degjoj 15-rrokëshin e saj dhe më detyronte të recitoja: «Moj Dropullite», «Ura e Artës», «Nënë moj, me të nentë bijtë».⁹³

Nga njëra përmbledhje në tjetren janë të dukshme novacionet në formë, liritë në vargëzim dhe guximi shprehimor. Aty ku nevojitet naracioni përdor një stil narrativ të ngrohtë, duke gjallëruar skenarin. Është i palodhur në kërkimin e përsosmërisë së formës. Vetë poeti shprehet në një intervistë të tijen: «Poeti e gdhin mbi letrat e veta,

duke kafshuar me dhëmbët e veta lapsin, duke numëruar fjalet dhe rrokjet, duke krehur vargjet e tij».⁹⁴

Për sa i përket teknikës që përdor S. Bejko do të theksojë: “Në artikulin e një ankthi ekzistencial të përjetësive, Kacalidha vjen me një varg poetik të afërt me psalmet biblike, afër me heksametrin klasik dhe me atë që strukturën më të imët, por më themelore të poezisë së tij; ka imazhin, jo strofën; është një poezi që dhe meditimin e shfren në imazhe sureale, imazhe që përshkëndrisin flakë, ngjyrë, por edhe gurë e drurë;...”⁹⁵

⁹³ Revista «Ταχυδρόμος», 04.02.02004, faqe 15

⁹⁴ Revista «Ταχυδρόμος», 04.02.02004, faqe 14

⁹⁵N.Kacalidha “Eliksiri i gurit”, Botimet “Toena”, Tiranë 2004 ,faqe9

6. KRITIKA NDAJ NIKO KACALIDHËS

Roli i kritikës shërben si një nga mozaiket që nevojitet për të plotësuar fizionominë e poetit. Duhet që përmes kritikës të gjejmë vetë Niko Kacalidhën.

Niko Kacalidha shfaqet për herë të parë në fillimet e viteve 70 dhe që atëhere vazhdon të realizojë i paepur vizionin e tij poetik. Opinioni letrar e priti ngrohtësisht dhe kritika konstatoi menjëherë karakteristikat e një poeti lirik origjinal ku vendlindja dhe origjina e vet luajnë rolin bazë. Nga të parët, Mojkom Zeqo, vuri re poetin e talentuar që premtonte shumë:

«Mbaj mend botimin e cikleve të para poetike të Nikos. Qe i befasishëm dhe tejet i ngrohtë, i singertë, ndonëse pak i ndrojtur. Kjo ndrojtje e Nikos që e ka ndjekur atë

edhe në krijimtarinë e mëparshme ka qënë një nga misteret e brishta dhe jetëdhënëse të natyrës së tij lirike. Unë shkrova shkrimin e pare estetik për librin e pare poetik të Niko Kacalidhës, të quajtur “ Fjalë të thëna në pranverë”». ⁹⁶

Edhe krijuesi i njohur D. Agolli do të shkruajë për veprat e para të Niko Kacalidhës: «Qe në vargjet e tij të para qe panë dritën e botimit në gazeta dhe sidomos pas librit të tij të parë dallohej një fat i mbarë se në kështjellën e poezisë po qasej një poet i vertetë me veshje të ndryshme nga ato të banorëve të tjerë qe gjendeshin në këtë kështjellë». ⁹⁷

Ndërkohë duhet thënë se kritikantët e para, ashtu si edhe për krijues të tjerë gjithsesi, mbeshteteshin mbi parime ideologjike se sa estetike. Duke studjuar veprën e asaj periudhe me të dhënat e sotme, u thanë shumë. Kështu psh., P. Barka në librin e tij «Letërsia në Minoritetin Etnik Grek», do të thotë për poetin: «Në atë periudhë «Uni» i tij poetik lidhet gjithnjë e më shumë me «shqetësimet e medha» që kishte marrë përsiper «udhëheqesi» dhe «partia», sidomos në arenën ndërkombëtare.

⁹⁶Moikom Zeqo, “Lirika e Niko Kacalidhës”(nga arkivi i N.Kacalidhës)

⁹⁷Gazeta «2000», Prill 2000

Ngacmimet lirike, të ndërthurura me nota dramatike i referohen patosit ideologjik partiak.” ⁹⁸

Ndërsa N.Ifantis thekson: «Ndoshta pritja që iu ofrua poezisë së N. Kacalidhës të mos i korrespondonte kontributit të tij. Mbi të rëndojnë, për fat të keq paragjykime, keqinterpretime dhe vlerësime të gabuara. Por është ama e sigurt se rruga që do të ndjekë poezia e tij në korridoret e levrimit letrar do të ndjekë oshilacionet dhe dëshirat e fshehta të një populli të shfrytëzuar dhe më në fund do të zërë vendin e nderit që i takon në Panteonin e letërsisë» ⁹⁹

⁹⁸ P. Barka. «Letërsia në Minoritetin Etnik Grek», Shblu, Tiranë, 2005, faqe 177

⁹⁹Nikos Ifantis, Fjalë e mbajtur në Universitetin e Janinës për prezantimin e vepres së N. Kacalidhës, 19.02.2000).

6.1 Të tjerët për Kacalidhën

Odiseas Elitis

“I dashur Kacalidha,

Shumë ju falëndëroj për letrën tuaj. Propozimi juaj të përkthehet “Aksin Esti” në gjuhën shqipe më gjen në një mendje dhe keni të gjitha urimet e mia për të përballuar veprën e vështirë që dëshironi të merrni përsipër”¹⁰⁰

Ismail Kadare

“Niko Kacalidha, i çmuar në Shqipëri e, ma sa duket , edhe më tepër në Greqi. Është një nga të rrallët poetë që përdor me mjeshtëri të dy gjuhët e Ballkanit. Për të tillë poetë përdoren zakonisht metafora fisnike: ura të afrimit të kulturave, kasnecë të miqësisë midis popujve. Të tilla metafora, që janë veçanarisht të çmuara sot në Ballkan, Niko Kacalidha i meriton plotësisht”¹⁰¹.

Dritëro Agolli

“Niko Kacalidha ka shkruar vjersha të mrekullueshme, me një gjuhë të lartë poetike e kulturë për admirim. Niko Kacalidha është jo vetëm poeti më i plotë i minoritetit grek, por edhe një ndër poetët e shquar në Shqipëri. Ai nuk është poet vetëm i Shqipërisë apo i Greqisë, është një poet ballkanas edhe më gjerë një poet europian, një poet modern me kuptimin e vërtetë të kësaj fjale, i dendësisë së figuracionit dhe veçanërisht të metaforave të dhëna shkallë-shkallë me një kursim prej artisti”.¹⁰²

Evangjelia Papakristu

“Shpërthyes si poet, tragjik si njeri, asket si profet, me vargje të të fuqishme dhe burrërore, me fjalë të guximshme e transparente kumton polisiminë dramatike greke, ku toni vetjak rizbulon elementin lirik autentik dhe rrezatues.”¹⁰³

Leta Kucohera

“Si poet vjen dhe bën betimin te poeti i poetëve, te stërgjyshi ynë i madh, Homeri, që të mos ndërpritet obligimi poetik”.¹⁰⁴

¹⁰⁰N.Kacalidha “Eliksiri i gurit”, Botimet “Toena”, Tiranë 2004 ,faqe 318

¹⁰¹N.Kacalidha, “Pagëzimi i zogjve”, Shtëpia Botuese “Onufri”,Tiranë 2004, faqe 5

¹⁰² N.Kacalidha, “Profecitë e drurëve”, Shtëpia Botuese “Dritëro”, Tiranë 1998

¹⁰³Revista «Σύνδεσμος», Mars 1994 faqe 8

¹⁰⁴N.Kacalidha “Eliksiri i gurit”, Botimet “Toena”, Tiranë 2004 ,faqe 320

Jorgos Vrelis

“Niko Kacalidha është poeti kombëtar i vëllezërve grekë të Shqipërisë. Në Greqi,i veçantë vendi i tij në Parnasin grek, djakon “sui generis” në tempujt apoloninë të dritës. Poezia e tij elegjiake mbushur me emocione tragjike, e frymëzuar, epike, sensibël, meditative, me denduri lakonike. Romantikja dhe fantazia lulëzojnë fjalën me krenari kombëtare”.¹⁰⁵

Moikom Zeqo

“Niko Kacalidha është një poet i dyfishtë, gjë e rrallë kjo, një karakter ballkanik liçuditshëm, rritur dhe formuar në kulturën poetike shqipe, spikatur si një lirik i shquar, i kultivuar dhe i nderuar edhe në poezinë greke, me një konceptim unik të brendshëm, metaforik, të një poezie virgjine. Është krijues i një kozmogonie ndjesish dhe figurash, hulumtues i rrallë dhe himnograf i natyrës së gjallë dhe botës njerëzore, një personalitet i kompletuar me dimensione origjinale, që ka vendin e tij të padiskutueshëm në panteonin e poezisë së vërtetë”.¹⁰⁶

Andon Pappleka

“Niko Kacalidha është poeti më i talentuar i minoritetit grek dhe një nga poetët e shquar, që lexohet dhe nderohet në vendin tonë”.¹⁰⁷

Sadik Bejko

“ Eshtë një poet madhor në letërsinë shqipe dhe në letërsinë greke. Ai është vërtet me fat që mundi të shfaqë kaq madhërisht artin e vet... Duke sjellë teknika poetike nga poezia e Ricosit, Seferit, Elitisit, duke i përkthyer ato në një gjuhë dhe sintaksë të tijën, duke e çliruar vargun ngaprangat e metrave, për jo nga ritmi, duke eksperimentuar metrat klasike, hegzametrin e çliruar, teknikën e vargjeve të psalmeve biblike, poezia e Kacalidhës sjell një kuotë të re, të lartë, në gjithë sa u shkrua në gjysmëshekullin që shkoi e që shkruhet deri më sot”.¹⁰⁸

¹⁰⁵N.Kacalidha “Eliksiri i gurit”, Botimet “Toena”, Tiranë 2004 ,faqe 319

¹⁰⁶N.Kacalidha “Eliksiri i gurit”, Botimet “Toena”, Tiranë 2004 ,faqe 322

¹⁰⁷N.Kacalidha “Eliksiri i gurit”, Botimet “Toena”, Tiranë 2004 ,faqe 322

¹⁰⁸N.Kacalidha “Eliksiri i gurit”, Botimet “Toena”, Tiranë 2004 ,faqe 18

Nikos Tendas

“Niko Kacalidha është poet me frymëzim homerik, shprehës i pulsit kontemporan grek”.¹⁰⁹

Nikos Ifandis

“Niko Kacalidha është lirik i rrallë i vetmisë, këngëtar i shquar, që ndjen tragjicitetin e kohës me befasitë, baladat dhe larminë e verbit poetik”.¹¹⁰

¹⁰⁹N.Kacalidha “Eliksiri i gurit”, Botimet “Toena”, Tiranë 2004 ,faqe 319

¹¹⁰N.Kacalidha “Eliksiri i gurit”, Botimet “Toena”, Tiranë 2004 ,faqe 321

7. KONKLUSIONE

Vepra poliedrike e Niko Kacalidhës, vlerësimi si duhet i rëndësisë së saj, ka bërë të nevojshme ndërmarjen e studimeve mbi të.

Tema ka titullin: “Nikos Kacalidha dhe vepra e tij letrare”.

Paraqitet gjithë vepra e tij poetike, proza dhe përkthimet e tij në gjuhën greke dhe shqipe.

Qëllimi i mikrotezës ishte studimi i të gjitha veprave në të dy gjuhët, analiza e tyre dhe vënia në dukje të karakteristikave kryesore. Në këtë studim u tentua të interpretohet vepra e një krijuesi të spikatur, sidomos në fushën e poezisë.

U përpoqëm të zbulonim kontributet origjinale si dhe specifike të këtij krijuesi dygjuhësh (biling), që dëshmojnë veçori të gjuhëve e kulturave përkatëse.

Në fillim u studiua literatura që i referohet poetit si dhe idetë, mendimet dhe argumentet e artikullshkruesve. Për kryerjen e studimit janë shfrytëzuar vëllimet poetike, proza, përkthimet e autorit, esset e tij letrare, tekste e studime të ndryshme në

fushën e letërsisë greke dhe shqiptare, botime në shtypin shqiptar, grek dhe në atë të Minoritetit Etnik Grek.

Për studimin sa më të mirë të saj, tema është ndarë në disa kapituj të cilët marrin përsipër të paraqesin veprën e tij poetike në shqip dhe në greqisht, prozën e tij në greqisht si dhe përkthimet në shqip dhe në greqisht. Akoma jepen disa sugjerime mbi karakteristikat e veprave, ndikimet, stilin, vendin e N.Kacalidhës në letërsinë shqipe dhe në atë greke, si dhe disa mendime kritike mbi krijimtarinë e autorit.

Konkretisht në kapitullin e parë japim disa të dhëna biografike mbi poetin.

Në kapitullin e dytë u munduam të bënim një ndarje të veprës së tij letrare.

Duke marrë parasysh kriterin e formës gjuhësore, vepra e tij ndahet në veprat e shkruara në gjuhën greke dhe ato në gjuhën shqipe. Për studimin sa më të mirë të saj ato u ndanë në dy periudha:

1. Periudha e parë 1971 – 1990

2. Periudha e dytë 1990 – vazhdim

Për çdo periudhë marrim një nga një të gjitha veprat që kanë qarkulluar në të dy gjuhët dhe me metodën e analizës u përpoqëm të nxirnim në pah disa nga karakteristikat e përgjithshme të tyre.

Niko Kacalidha i takon periudhës së tretë të pasluftës, brezit të viteve '70. Veçoritë e përgjithshme të poezisë shqipe të këtij brezi i takojmë dhe te poezia e Kacalidhës. Veçoritë kryesore të këtij brezi janë përpjekjet ripërtëritëse të poetikës estetike dhe në mënyrë të veçantë të formës përsa i përket vargut dhe veçanërisht një hapje tek vargu i lire, është një novatorizëm metaforik që ka të bëjë me botën e brendshme dhe ndjeshmërinë e poetit, me figurat, me konceptin poetik për vetë botën.

Poetët e brezit të viteve '70 sjellin një ripërtëritje autentike, duke dalë nga klishetë dhe kallëpet të brezit të parë dhe të dytë, në tematikën dhe në idetë, duke mbajtur distancë nga paraqitja e realitetit të thatë të realizmit socialist dhe përpiqen të rikrijojnë një estetikë të re, të qëndrojnë larg nga retorizmi dhe tematika konkrete në poezi, duke shprehur kështu më shumë ndjenjat e tyre, botën e tyre të brendshme, estetikën drejt së bukurës, duke shprehur më shumë ndjenjat e tyre erotike dhe duke shfrytëzuar motivet e lashta, mitet, legjendat, natyrën, vendlindjen etj.

Disavantazhet, mangësitë që takojmë në poezinë shqipe të periudhës së tretë përsa i përket pompozitetit dhe prozaizmit, shfaqen dhe në poezinë e Kacalidhës. Kemi të

bëjmë me një poezi politike të varur nga realizmi socialist. Realizmi socialist dhe politika militariste heqin shumë elemente etnike nga letërsia e Minoritetit Etnik Grek. Pas vitit 1990 tematika e poezisë shqiptare dhe e asaj të Minoritetit Etnik Grek pasurohet, zgjerohet dhe merr një karakter të ri si në brendi dhe në formë. Poeti tani zhvillon më shumë anën e brëndshme shpirtërore të temës dhe shfaq një poezi të dimensioneve të tjera. Një mentalitet i ri i pasuruar me figura dhe simbole nga e kaluara historike dhe përvojat tiranike të epokës së diktaturës, përbëjnë një nga karakteristikat bazë njohëse të poezisë shqipe të brezit të viteve '90.

Zhvillimet e viteve të fundit, kontaktet me atdheun – mëmë, me letërsinë greke, larg frikës që e torturonte për dekada të tëra, do të tregojnë vlerat e vërteta të letërsisë të krijuesve minoritarë, aspektin tjetër, që deri tani e fshihnin. Poeti i vendosur në traditën ripërtëritëse poetike, e pasuron dhe e zgjeron. Largohet nga çdo lloj kategorizimi.

Në kapitullin e katërt japim disa të dhëna mbi përkthimet e N. Kacalidhës. Ai është një përkthyes i spikatur në të dy gjuhët, në greqisht dhe në shqip. Nuk synojmë të vlerësojmë përkthimet e Niko Kacalidhës, të cilat zënë me të drejtë një vend kreu në letrat shqipe, por të japim dhe dimensionin tjetër të krijuesit. Me përkthimin e «Αξιόν Εστίν»(Aksion Esti) të Elitis më 2001 i jepet medalja «Penda e Argjendtë» nga Ministria e Kulturës e Shqipërisë për përkthimin më të mirë të vitit. Komisioni gjykoj se N. Kacalidha ia doli mbanë të zbulojë një gjuhë poetike që i përshtatet plotësisht perceptimeve mendore dhe simbolikës ëndërrimtare të Elitisit dhe e plotëson tekstin me elemente që kontribuojnë në kuptimin e tij.

Në kapitullin e pestë dhamë disa karakteristika të përgjithshme të veprës së Kacalidhës, ndikimet, tematikën e tij, karakteristikat e gjuhës, stilin, teknikën dhe mjetet e tij shprehëse.

N. Kacalidha është pa dyshim një poet modern i shquar. Kontributi i tij është i madh në poezi, në përkthim, në prozë, në esse, në kritikën letrare dhe veçohet si një nga poligrafët më të mëdhenj letrarë. Poezitë e tij janë tërheqëse dhe emocionuese. Fjala e tij poetike e zhyt lexuesin në çdo nocion dhe vlerë me të cilat operon poeti, ndërkohë hap horizonte dhe shtigje për të kërkuar bukurinë e shpirtit të vet. Shkrimtar me disponim të thellë lirik dhe me zë poetik tronditës karakterizohet nga një frymëzim origjinal që buron, pikë së pari, nga një dashuri e pakufi për vendlindjen e tij.

Një nga dimensionet e poezisë së tij është vendlindja që luan rol bazë dhe organik. Frymëzimi i tij është Leshnica. Pasionant me vendlindjen e vet, e hymnizon, e lartëson, e merakoset për fatin e saj dhe shpreh dashurinë e madhe për të. Vendlindja luan rol vendimtar në formimin e poetit. Nuk është vetëm vend dashurie dhe vend adhurimi. Është qendra e botës. I fal poetit motivet poetike. Nuk ka përmbledhje poetike ku të mos i jetë referuar tokës së vendlindjes. Bile, siç e theksuam vendlindjes së vet i kushton edhe një përmbledhje të plotë poetike, atë me titull «Loti i Ciklaminit». Sipas Niko Kacalidhës në qoftë se ndonjë e keqe do ti ndodhë Leshnicës, atëhere mandate të zeza do të kemi për botën. Kujtime dhe përjetime feminare, kujtime dhe përvoja na çojnë në epoka më të lashta dhe krijojnë emocion estetik me dashurinë e tij të pazakontë për vendlindjen. Niko Kacalidhas mund të themi se është një adhurues pasionant i atdheut dhe një hymnizues i vendit të tij.

Tema të tjera që i gjejmë në të gjitha veprat e tij janë: tema e natyrës, e mërgimit, e daturisë etj.

Në fizionominë dhe në tematikën e vet poetike padyshim kanë ndikuar rrethi fizik dhe social, studimet e tij, karjera e tij si pedagog i shkollës së mesme si edhe karjera e tij politike dhe diplomatike. E ndihmoi shumë edhe ambjenti familjar, gjyshja e tij, babai i tij, edhe ai mesues dhe folklorist i njohur.

Disponimi natyralist përbën një nga karakteristikat kryesore të poezisë së Niko Kacalidhës, të ndërthurura me epokat dhe me vende konkrete. Një shikim i shpejtë mbi titujt përmbledhjesh dhe poezish e dëshmon këtë. Hymnizon natyrën në të gjitha orët dhe epokat, por më shumë tonet e gëzueshme pranverore. Duke lexuar poezitë e Niko Kacalidhës, që nga përmbledhja e tij e parë dhe derin në atë të fundit, konstatohet se i referohet shpesh herë muajit Prill. Është muaji i triumfit të pranverës me të gjitha fuqitë e veta, është muaji i dashur i poetit. Në qoftë se do të vinim re me kujdes Letërsinë e Re Greke, shumë poetë i referohen këtij muaji, si psh., Solomos, Karioraqis, Elitis, Sigelianos etj.

Niko Kacalidha e pasuron krijimin kulturor me vepra të rëndësishme të cilat përmbledhin kujtime, bioma dhe vlera të vetë Minoritetit Etnik Grekë por edhe të vetë Shqipërisë. Përpiqet të dëshmojë etnicitetin e vet, të pëcjellë simbolikën greke jo vetëm në veprat që janë shkruar në greqisht, por edhe në ato që janë shkruar në shqip.

Përsa i përket ndikimeve në veprën e tij, vend të veçantë zë mitologjia greke. Mitologjia greke si një ndër thesaret e çmuara të universit kulturor botëror gjëndet kudo në veprën poetike të Niko Kacalidhës. Mesazhe antike të kthyer në simbole,

alegoritë dhe metaforat i japin dimensione ekumenike poezive të tij. Ato përzihen me fenomenet e njeriut modern, me përjetimet e vet poetit, me simbolet e prekshme të realitetit ku jeton.

Mbi Kacalidhën ushtron ndikim të madh edhe pasuria e këngës popullore dhe e traditës vëndase. Duke qënë njohës i mirë i historisë së vendit të vet, i miteve dhe i legjendave e shfrytëzon efektshëm këtë pasuri në krijimtarinë e vet duke iu ofruar lexuesve edhe mundesinë e kontaktit me traditën. I bollshëm është edhe elementi folklorik. Përshkrimet dhe ndjenjat e tij përbëjnë pasqyrime autentike të jetës dhe të mentalitetit të njerëzve të atdheut të vet.

Poeti i përdor me lehtësi si gjuhën greke ashtu edhe atë shqipe. Gjuha e tij amtare është greqishtja siç e ka dëgjuar nga buzët e nënës dhe të gjyshes së vet me ninullat dhe me përrallat dhe ashtu siç e ka mësuar më vonë nga i jati folklorist, nëpërmjet miteve dhe legjendave. Ndërkaq arsimimi i tij në gjuhën greke ishte i mangët si në rastin e të gjithë krijuesve të Minoritetit Etnik Grek në Shqipëri. Kjo lidhet me kufizimet që kishte vendosur regjimi diktatorial edhe në sektorin e arsimimit në gjuhën letrare. Niko Kacalidha me sedër dhe përpjekje ia arriti të kultivojë gjuhën greke të poezisë së vet.

Përkundrazi, edukimi i tij në gjuhën shqipe ishte sistematik dhe intensiv. Është njohës i shkelqyer i shqipes. Kjo duket jo vetëm nga veprat e tij poetike, por edhe nga përkthimet në shqip. Përdor një gjuhë të aftë për të krijuar bashkësi të reja objektivash, situatash, bile edhe emocionesh. Leksiku i tij është i pasur. Edhe në këtë rast përdor shumë fjalë greke, huazime të shqipes nga gjuha greke.

Karakteristikat bazë të stilit të N. Kacalidhës janë: saktësia e të shprehurit, referimet e shpejta në antikitet dhe veçanërisht në mitologjinë dhe në elemente esaj. Stili është i rrjedhshëm, figurativ, më shumë figura letrare dhe me përshkrim brilant. Mjetet e tij kryesore shprehëse janë: metaforat, figurat, krahasimet, personifikimet. Figurat dhe metaforat i përdor me forcë burimore dhe në menyrë spontane.

Duke studjuar produktin e tij poetik mundet që çdonjeri të konstatojë lehtësinë në përdorimin si të formave metrike tradicionale ashtu edhe vargun e lirë duke arritur që të krijojë gjithnjë një poezi solide. Vargu i tij, në të shumtën e rasteve është i lirë, por shpesh herë inkuadrohet në modelet e vargëzimit të poezisë shqiptare dhe greke. Në veprat që ka shkruar në gjuhën greke ndikohet nga kënga popullore dhe nga jambi 15-rrrokësh. Ky varg është dinamik, komunikativ, i mirëpunuar.

Një nënkapitull në kapitullin e pestë e titulluam “Nikos Kacalidhas poet i miqësisë së popujve”. Ai duke kapur mesazhet e kohës, po punon për bashkpunimin paqësor evropian dhe për unitetin shpirtëror të Grekëve me Shqiptarët. Me kordat e lirës se vet ëndërron një vellazërim të vertetë dhe thurr këngë me ndjenjë njerëzore, sepse poezia, mbi të gjitha, është urë komunikimi midis njerëzve dhe popujve. Poezitë e tij përshkruhen nga një ndjenjë e thellë afërie vellazërore me Shqiptarët dhe është e natyrshme, pasi përforcohet nga shekujt e bashkekzistencës.

Në kapitullin e gjashtë i referohemi rolit të kritikës mbi veprën e Kacalidhës dhe japim konkretisht disa mendime që shumë studiues dhe krijues shqiptarë e grekë kanë dhënë për poetin. Opinioni letrar e priti ngrohtësisht që në vëllimin e tij të parë poetik kritika konstatoi menjëherë karakteristikat e një poeti lirik origjinal ku vendlindja dhe origjina e vet luajnë rolin bazë. Nga të parët, Mojkom Zeqo, vuri re poetin e talentuar që premonte shumë. Kritika inkurajuese për poetin kanë bërë dhe shumë njerëz të tjerë të letrave në Shqipëri si psh I.Kadare, D. Agolli, S.Bejko etj.

Pas viteve 1990 poeti u bë i njohur dhe në Greqi. Edhe atje shumë personalitete e mirëpritën. Por kritika ka shumë akoma për të dhënë për poetin.

Së fundi ndjehem e obliguar për të falënderuar udhëheqësin shkencor prof. Dr. Ymer Cirakun, jo vetëm për ndihmën e dhënë, por edhe për gatishmërinë, për përkujdesjen dhe për vëmendjen që na ka kushtuar gjatë realizimit të punimit. Falënderim të vecantë e meritojnë dhe gjithë pedagogët e Departamentit të Gjuhëve të Huaja të Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, të Universitetit të Tiranës dhe pedagogët e Degës së Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek të Fakultetit të Shkencave Shoqërore në Universitetin e Gjirokastrës, me të cilat puna ime është e lidhur pazgjidhshmërisht.

8. LITERATURA

Niko Kacalidha:

“Fjalë të thëna në pranverë”, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1971

“Flugeri”, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1975

“Shtëpitë tona në Jug”, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1982

«Η κοίτη του ποταμού μου», Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1982

«Λιόφωτο λιανοτράγουδο», Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1985

“Anëdet”, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1989

«Ανταύγιες», Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1989

«Το μοιρολόι του βουρκωμένου βουνού», Selanik 1994

«Κι Σφίγγα μίλησε...», Selanik 1995

«Το καράβι της Κύπρου με τα πικρολέμονα», Nikosia 1995

«Τα εκατό εκατόφυλλα της πούλιας», Athinë 1997

«Η αμβροσία των βράχων», Athinë 1997

«Το δάκρυ τθυ κυκλάμινου», Athinë 1998

«Η πύλη των βοριάδων», Athinë 1998

“Profecitë e drurëve”, Shtëpia Botuese “Dritëro”, Tiranë 1998
«Χίλια κοχύλια», Athinë 1999
«Η πλώρα των άστρων», Athinë 2001
«Η μοίρα του αμάραντου», Athinë 2003
“Pagëzimi i zogjve”, Shtëpia Botuese “Onufri”, Tiranë 2004
“Eliksiri i gurit”, Botimet “Toena”, Tiranë 2004
«Το άροτρο του φεγγαριού», roman, Athinë 2004
«Νύχτας ανομήματα», tregime, Athinë 2006

Akademia e Shkencave e RPS Shqipërisë, Historia e Letërsisë Shqiptare, Tiranë, 1984

Robert Elsie, “Historia e Letërsisë Shqiptare”. Tiranë 1977

Λίνου Πολίτη, Ιστορία της Νεοελληνικής Λογοτεχνίας, Αθήνα, 1999

Jusuf Vrioni, “ Antologie de la poesie albanaise”, Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë 1983

Κώστα Νάτσιου, «Ιστορία της Βορειοηπειρωτικής Λογοτεχνίας», Gjirokastër 2005

Παναγιώτη Μπάρκα, «Η Λογοτεχνία στην Εθνική Ελληνική Μειονότητα», Shblu, Tiranë 2005

Arkiv personal i poetit N. Kacalidha:

Muço Muho, “Esse në fillim të mijëvjeçarit. Poetit Niko Kacalidhës”.

Dalan Shaplo, “Poezia si triumf njerëzor. Niko Kacalidha një nga poetët më të shquar të poezisë moderne shqiptare”.

Moikom Zeqo, “Lirika e Niko Kacalidhës”.

Romeo Çollaku, “Dy fjalë për poezinë e Niko Kacalidhës”.

Νίκος Τέντας, « Ο Ελληνικός λόγος του Νίκου Κατσαλίδα στην βαλκανική ποίηση».

Νίκος Υφαντής, «Προλογος για το έργο «Η πλώρα των άστρων»

Gazeta dhe revista

Gazeta, “Drita”, 27 Qershor 1976

Gazeta, “Drita”, 26 Janar 1988

Gazeta, “Drita”, 21 Shkurt 1988

Gazeta, “Drita”, 26 Maj 2002
Gazeta, “Ballkan”, 26 Prill, 2004
Gazeta, « Λαϊκό Βήμα», edicioni 1975- 1990
Gazeta, « Λαϊκό Βήμα», 3 Tetor 1996
Gazeta, « Λαϊκό Βήμα», 12 Maj 1998
Gazeta, « Λαϊκό Βήμα», Gusht 1999
Gazeta, « Λαϊκό Βήμα», 18 Nëntor 2001
Gazeta, «Λογοτεχνικό Λαϊκό Βήμα»
Gazeta, «Τα νέα της OMONOΙΑΣ», 11 Dhjetor 2003
Gazeta, «Ρωμιοσύνη», 20 Korrik 1999
Gazeta, «Ρωμιοσύνη», 30 Mars 2002
Gazeta, «2000», Prill 2000
Gazeta, «Πρωινά νέα», 20 Mars 1992
Gazeta, «Πρωινά νέα», 20 Korrik 1995
Gazeta, «Πρωινά νέα», 3 shtator 1998
Gazeta, «Πρωινά νέα», 10 Nëntor 2000
Gazeta, «Πρωινά νέα», 22 Janar 2004
Revista, «Σύνδεσμος», Mars 1994
Revista, «Η έρευνα», 1 Shkurt 1999
Revista, «Η έρευνα», 20 Nëntor 2000
Revista, «Ταχυδρόμος», 4 Shkurt 2004
Revista, «Νέα επικοινωνία», Shkurt- Tetor 1996
Revista, «Ηπειρωτική Στέγη Γραμμάτων Τεχνών», Dhjetor 1992
Revista, «Νέοι αγώνες της Ηπείρου», 8 Qershor 2004
Revista, «Ηπειρωτικά γράμματα», Shkurt 2006